

DR. SHEFIK KURDIQ

RAMAZANI DHE NAMAZI I TARAVIVE

SIPAS MEDH'HEBIT HANEFI





Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

RAMAZANI DHE NAMAZI I TERAVIVE NË DRITËN E MEDHHEBIT HANEFI

Doc. Dr. Shefik Kurdiq

Botuar nga: SHB SIRA

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

NË VEND TË PARATHËNIES

“(ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria).¹

Ramazani është muaji i zgjedhur e i bekuar. Ky është muaji i agjërimit, ibadetit, bekimit të All-llahut, amnistisë dhe faljes. Në këtë muaj, All-llahu xh.sh. njerëzve u ka dhuruar begatinë dhe mëshirën më të madhe. Në këtë muaj filloi shpallja e Kur’anit “*që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria).*”² Pikërisht për shkak të kësaj ngjarje të madhe, për shkak të shpalljes së Librit të fundit të All-llahut xh.sh., që shënon fillimin e një epoke të re në historinë e njerëzimit, muaji i Ramazanit për këtë ka rëndësi dhe vlerë të madhe. Në këtë muaj All-llahu xh.sh. e ndanë Mëshirën e Tij dhe ua falë njerëzve. Kuptohet, ua falë atyre që kërkojnë falje dhe i mbulon me mëshirën e Tij ata që përpiqën për të.

Një prej begative të muajit të Ramazanit është agjërimi. Agjërimi është ibadet kulminant me të cilin besimtari e shprehë imanin e tij dhe mundohet të meritojë mëshirën dhe kënaqësinë e All-llahut. Agjërimi nuk është vetëm përmbajtja e thjeshtë nga të ngrënit dhe nga pirja, por është angazhim i tërë qenies së njeriut. Sytë nuk shikojnë atë që është haram, veshët nuk dëgjojnë të folurit e përbuzur, duart nuk shtrihen drejt haramit. Mendimet janë të drejtuara në madhërimin e All-llahut xh.sh. dhe të medituarit në precizitetin dhe përkryeshmërinë e krijimeve të Tij. Gjuha i thurë falënderime të Gjithëmundshmit për të mirat e tij me anë të dhikrit, duave dhe leximit të Kur’anit... duke hequr dorë prej ushqimit dhe pijeve muslimani forcon vullnetin dhe durimin e tij në vështirësitë e jetës. Njëkohësisht ndjen keqardhje dhe solidarizohet me njerëzit të cilëve u janë cunguar ato mirësi. Shkurt, Ramazani është muaji i agjërimit dhe ibadetit, fitore e shpirtit mbi dëshirat e trupit. Ai është rast i mrekullueshëm që çdo besimtar dhe besimtare, që duke përforcuar shpirtëroren, të fitojnë elan dhe fuqi të re, dhe kështu e lehtësojnë rrugën dhe vështirësitë e tij në këtë dunja.

¹ Kur’ani: Bekare, 185

² Ndërmjet dijetarëve islam mbizotëron mendimi se Kur’ani është zbritur përnjëherë (Xhumleten vahideten) që do të thotë, i shpallur prej Levhi-Mahfudhit (Pllakës së Ruajtur Mirë), në mënyrën që i përkon vetë asaj, në qiellin tonë më të afërt (es-sema’ ed-dunja), ndërsa pastaj shkallë shkallë dhe sipas nevojës i është zbritur Muhammedit s.a.v.s., për njëzet e tri vjet të misionit të tij si i Dërguar. Nata në të cilën kjo ka ndodhur është nata e Lartësuar (Lejletu-l-kadr) dhe për të në surën Duhan thuhet se është “lejletun mubareketun”, d.m.th. natë e bekuar - mubarek. Kjo natë është në muajin e ramazanit dhe në të ka qenë paraqitja e parë e melekut Xhibril para Muhamedit s.a.v.s., në shpellën Hira, kur i janë zbritur pesë ajetet e para të sures ‘Ale. Për këtë mendim, dijetari i madh islam imam Es-Sujuti në veprën e tij kapitale *El-Itkan*, pohon se është mendimi më i drejtë dhe më i njohur, ndërsa pastaj përmend transmetimet e *selefi-salib* (posaçërisht të Ibn Abbasit) në të cilat kjo konkretizohet.

Kur'ani është Fjala dhe Shpallja e All-llahut xh.sh. me të cilin besimtari duhet të ketë lidhje të ngushtë në rrugën e tij të rëndë të dunjasë. Ai është dritë që atë rrugë e bënë të pashme dhe të qartë, dhe në të njëjtën kohë, nxehë dhe shkëlqen të gjitha pjesët e shpirtit dhe të qenies së besimtarit, duke i dhënë atij fuqi dhe hov që në atë rrugë, përplot me vështirësi, sprova dhe kurtha, trimërisht dhe me nder të qëndrojë dhe të durojë. Kur'ani për besimtarin është mësues i cili e mëson dhe e edukon, duke i treguar shenja të qarta dhe kahe në rrugën e tij. Për këtë, besimtari duhet të jetë në lidhje të afërt me Kur'anin.

Jeta me Kur'anin zgjon në shpirt një mori të ndjenjave më të mrekullueshme, të cilat i njeh vetëm ai i cili shoqërohet me Kur'anin me shpirt dhe zemër të hapur, me dëshirë të sinqertë që të udhëzohet në rrugë të drejtë. Jeta me Kur'anin është begati të cilën e njeh vetëm ai i cili e ka shijuar, begati e cila ngritë jetën, e bekon atë, e përsosë dhe e fisnikëron, duke i dhënë kuptim të plotë.

Të jetosh me Kur'anin do të thotë të jesh në afërsinë e All-llahut xh.sh. dhe nën mbrojtjen e Tij. Kur'ani është fjalë All-llahut xh.sh. drejtuar njeriut: mendimeve të tij, zemrës, shpirtit, qenies... Ai është fjalë që lajmëron njeriun për Krijuesin e tij, All-llahun xh.sh., për cilësitë dhe atributet e Tij, për Fuqinë e Tij, Mëshirën, Lartësimin, Gjithëdijen etj....

Andaj, njeriu i cili jeton me Kur'anin është në afërsi të All-llahut xh.sh., afër kënaqësisë dhe nën mbrojtjen e Tij. Le ta paramendojmë madhësinë e Mëshirës dhe të Mirës së All-llahut xh.sh. e cila manifestohet nëpërmjet shpalljes së Librit, në të cilën Ai, All-llahu i Lartësuar, i drejtohet njeriut- kësaj krijese të vogël dhe kalimtare, e cila në krahasim me gjithësinë e madhe të All-llahut xh.sh., bashkë me planetin në të cilin jeton, nuk është asgjë vetëm se një pikë e vogël...

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka porositur besimtarët që në mënyrë konstante të shoqërohen me Kur'anin, të mësojnë atë dhe të mendojnë për të, dhe në të njëjtën kohë, ua ka tërhequr vërejtjen në rrezikun e mosprezencës së Kur'anit në jetën e tyre të përditshme. Ngase, po qe se njeriu kalon pak kohë me Kur'anin dhe nuk e mëson dhe nuk mendon për ajetet dhe mësimet e tij, atëherë, me të vërtetë ekziston frikë se mund të ndërpritet ajo lidhje e gjallë e cila lidhë zemrën e besimtarit me Zotin e tij; frikë se në zemër mund të shtresohen gjëra të ndryshme të cilat janë si rezultat i nënshtrimit të njeriut ndaj dunjasë, materies dhe dëshirave të ndryshme. Me qëllim që të mos ndodhë kjo, duhet të ekzistojë vazhdimësia e shoqërimit me Kur'anin me qëllim që ajo lidhje të mbetet e fortë, e gjallë dhe stabile.

Për këtë shkak, Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “Ky Kur'an është litari i All-llahut; ai është dritë e qartë dhe ilaç i dobishëm; mbrojtje e atij i cili e pranon dhe shpëtim i atij i cili e pason. Sekretet e tij nuk shteren, dhe sa më shumë që lexohet, bëhet më i freskët dhe më interesant. Lexoni Kur'anin, sepse All-llahu për shkak të leximit të tij, do t'ju shpërblejë për çdo harf (shkronjë) dhjetë hasenate (sevabe)!! Unë nuk ju them: ELIF-LAM-MIM është harf, por ELIF është harf, LAM është harf, MIM është harf.”³

³ Hakimi në Mustedrek dhe Tirmidhiu në Sunen.

Ditët e bekuara të Ramazanit, i cili ndryshe quhet edhe muaji i Kur'anit, janë rast i vërtetë që besimtari të tentojë të thellojë lidhjen e tij me Kur'anin, duke u përpjekur që atë lidhje ta bëjë më të fortë, më të gjallë dhe më stabile. Vetëm kështu Kur'ani do të ketë efekt të plotë në eliminimin e shtresave negative të cilat mund të rrezikojnë besimtarin dhe imanin e tij, ndërsa drita e të Vërtetës pandërprerë do të shkëlqejë zemrën e besimtarit.

* * *

Libri i cili gjendet para jush është tentim i llojit të vet për të qartësuar të gjitha dyshimet lidhur me muajin e bekuar të Ramazanit. Edhe pse numri i faqeve i këtij libri nuk është i madh, libri nga përmbajtja dhe para së gjithash, për shkak të paraqitjes së tij shkencore hulumtuese dhe thelbësore, paraqet kontribut serioz dhe shumë me vlerë në literaturën e zhanrit fetar në gjuhën tonë.

Autori i tij, dijetari ynë i njohur, da'iu, vaizi, muderrisi, muhaddithi, doc. Dok. Shefik Kurdiq, pas librit për imam Ebu Hanifen dhe namazin në medh'hebin Hanefij, sërish i paraqitet lexuesve tanë, edhe këtë herë duke u dhënë një libër shumë interesant.

Libri është shkruar me një stil të lehtë dhe shumë tërheqës. Shtjellon dhe sqaron temat lidhur me Ramazanin, siç është fenomeni i shpalljes së Kur'anit të ndershëm, lufta në Bedër dhe porositë e saj nën prizmin e problemeve aktuale të ummetit, posaçërisht të vendit tonë. Këtu, gjithsesi është edhe shpjegimi frymëzues i Natës së Kadrit, në të cilën është shpallur Kur'ani dhe e cila - për gjuhën e Kur'anit- është më me vlerë dhe më e mirë se njëmijë muaj në të cilat nuk ka këso netë. Libri jep shenjat treguese se si të gjendet kjo natë dhe në çfarë mënyre të shfrytëzojmë begatitë e saj.

Pasi që autori shquhet si person i profesionalizuar në fushën e hadithit dhe të njohurive të hadithit (Kurdiqi ka kryer studimet postdiplomike, ka magjistruar dhe ka doktoruar në fushën e hadithit dhe njohurive të hadithit në njërin prej univerziteteve më të vjetra në botë, *Zejtun* në Tunis- shënim i parathënësit). Ka përzgjedhur dyzet hadithe autentike dhe të besueshme të cilat flasin për Ramazanin dhe agjërimin, që është përzgjedhje shumë interesante dhe e dobishme. Mbi të gjitha për shkak të kualifikimit të personit që citon diçka nga Muhamedi s.a.v.s., sepse për fat të keq, jetojmë në kohërat në të cilat shumë "transmetojnë" gjëra dhe opsione, duke u munduar t'i fusin nën kornizën e "islamit", mirëpo, në këtë rrugë, u mungojnë kualifikimet dhe autenticiteti i duhur. Për këtë shkak, hadithet të cilat Kurdiqi i ka zgjedhur për këtë libër, do t'u janë të mirëseardhura imamëve tanë, vaizëve, talebeve që shkojnë në praktikë të Ramazanit, si dhe të gjithë muslimanëve të cilët dëshirojnë që të kenë dobi me begatitë e muajit të bekuar të Ramazanit. Numri *dyzet* asocion në përmbledhjet e shkurta të njohura të haditheve të cilat përmbajnë nga dyzet hadithe, dhe të cilat i përshkruhen përmbledhësve të tyre, sikur *El-Erbe'ine en-Nevevije*, *El-Erbe'ine el-Axhblunije*, *El-Erbe'ine el-Gumarrije* e të ngjashme, kështu që edhe këto dyzet hadithe, të cilat Kurdiqi i ka mbledhur dhe i ka transmetuar në mënyrën që i përkon qasjes serioze hulumtuese të hadithit, dhe me

të drejtë mund ta quajmë *El-Erbe'ine el-Kurdijje*.

Vlera e posaçme e veprës së Kurdiqit është në temat të cilat i aktualizon në pjesën e dytë të librit. Bëhet fjalë për rregullat në lidhje me agjërimin, namazin e teravive dhe sadakatul fitrin (vitri). Në të gjitha këto pyetje, Kurdiqi flet nga pozita e shkollës juridike hanefite.

Përndryshe, Kurdiqi është i njohur në bazë të shumë literaturave të cilat i konsulton në hulumtimet e tij. Kështu edhe në këtë studim, duke përpunuar problemin e theksuar, me të madhe ka përdorur vepra kapitale të medh'hebit hanefij, sikur *El-Ibtijar* të Mevsiliut, *El-Hidaje* të Merginanit, *Meraki-l-felab* të Shurunbulalit, *Beda'iu-s-sana'i* të Kijasanit, *Multeka-l-ebhur* të Halebiut, *El-Lubab* të Mejdanit, *Hashije* të Tahtaviut etj. Gjithashtu, prezente është edhe literatura të cilën e kanë shkruar autorë bashkëkohorë, posaçërisht ata të cilët shquhen për ekspertë në lëminë e fikhut, siç janë shejh Vehbi Sulejman Gavoxhi, dr. Jusuf Kardavi etj. E gjithë kjo dëshmon për precizitetin e skajshëm dhe në thelbin e principeve shkencore nga të cilat Kurdiqi nuk largohet në hulumtimet e tij.

Autori, në mënyrë vëllazërore dhe elokuyente, tërheq vëmendjen në disa parregullsi me të cilat takohemi në hapësirat tona për çdo vjet kur vjen muaji i Ramazanit lidhur me namazin e teravive. Këto parregullsi i bëjnë jo vetëm njerëzit e rëndomtë, domethënë persona të cilët nuk janë bartës të ndonjë detyre fetare, por për fat të keq, edhe ata të cilët bartin detyra të tilla. Bëhet fjalë për shpejtësinë marramendëse me të cilën një numër i njohur i imamëve tanë falin namazin e teravive, duke harruar në komponentën thelbësore të këtij llojit të namazit, e cila qëndron në vetë emrin e tij. Vetë emri teravih, është marrë nga kuptimi i tij, që do të thotë pushim, pauzë. Pra, namazi me pauza dhe pushime sepse pas çdo katër reqateve është bërë pauzë, e cila- sipas medh'hebit hanefij por edhe të tjerëve- ka zgjatur aq sa janë falur katër reqate. Gjatë këtij pushimi (pauze) lexohej Kur'an, dhikër, janë dërguar salavate ose është heshtur. Për këtë flasin të gjitha burimet relevante të medh'hebit hanefij, ndërsa fakihu ynë i njohur, rahmetliu Muhammed Seid Serdareviq në veprën e tij *Fikhu-l'ibadat* këtë qartë e tregon.

Gjëja e dytë në të cilën harrojnë ata të cilët udhëheqin xhematin, ka të bëjë me të ashtuquajturin *ta'dilu-l-erkan*, që domethënë barazimi i rukneve të namazit. Ruknet e namazit janë veprime pa të cilat nuk pranohet namazi. *Ta'dilu-l-erkan* ose bërja e rukneve të namazit qetë dhe ngadalë- sipas medh'hebit hanefij dhe të tjerëve- është *ruk'n*, pra diçka të cilën duhet çuar në vend, sepse përndryshe, vie në pyetje saktësia e tërë namazit. Për këtë duhet të kihet parasysh, me theks të veçantë kjo ka të bëjë me ata të cilët dalin të udhëheqin xhematin dhe pas të cilit bota e njerëzve të rëndomtë thonë "*iktedejtu bihadhe-l-imami*." Ata duhet të jenë të vetëdijshëm në faktin se, nëse diçka i mungon namazit të tyre, atëherë ata bartin përgjegjësi për të gjithë ata që falen pas tyre!!!

Kuptohet, ata do të mundohen të arsyetohen duke thënë se, "bota kështu po e do", mirëpo hatri i All-llahut është para të gjithëve. Bota ngadalë duhet të përshtatet në atë që është e drejtë.

Kurdiqi në këtë drejtim, pas shprehjes së mendimeve nga veprat kapitale dhe nga autoritetet e medh'hebit hanefij, me të drejtë çuditet dhe pyet:

“Pra, bëhet fjalë për atë se namazi i teravive edhe në shkollën juridike hanefite është definuar si namaz i cili falet me nderë, qetë dhe ngadalë, me pauza ndërmjet dy, gjegjësisht katër reqateve. Sipas cilit medh'heb pra te ne ka filluar të praktikohet shpejtësia aq e madhe ndërmjet dhënies së selamit dhe fillimit të reqatit të ri?! Prej nga pra pauza pas dhënies së selamit, e cila përmendet në veprat hanefite, dhe e cila zgjatë sa falja e katër reqateve, është shndërruar në ngritje të shpejtë prej gjendjes ulur e drejt në reqatin tjetër, si dhe belbëzimi i pakuptueshëm i ndonjë dhikrit, të cilin as ne, nga shpejtësia nuk e kuptojmë?! Nuk është kontestuese vetëm shpejtësia e kalimit prej dhënies së selamit dhe fillimit të reqatit të ri, por më e çuditshme është praktika e shpeshtë, e leximit të shkurtër në kijam, me shpejtësi të madhe në lexim, që zhvleftëson dhe sjell në pikëpyetje saktësinë e vetë namazit.”

Në një debat shumë interesant në temën se sa reqate ka namazi i teravive, Kurdiqi në mënyrë argumentuese mbronë qëndrimin e medh'hebit hanefij (këtë qëndrim e kanë edhe medh'hebet tjera), se teravitë kanë njëzet reqate. Një prej argumenteve më kryesore është konsensusi i as'habëve, shokëve të Muhamedit s.a.v.s., të cilët gjatë kohës së halife Omerit r.a. janë pajtuar që këtë namaz ta falin njëzet reqate. Ndërsa, konsensusi i as'habëve (*ixhma'u-s-sahabe*) në shkencën e cila merret me teorinë e të drejtës shariatike (*usulu-l-fikih*) paraqet argument shumë me rëndësi dhe relevant.

Kurdiqi në fund sjell edhe rregullat në lidhje me sadakatu-l-fitrin, edhe atë në dritën e medhhebit hanefij, që kësaj veprë i jep një vlerë shtesë.

Për shkak të asaj të përmendur dhe asaj që e përmbanë ky libër, e që nuk është përmendur në përpjekje që kjo parathënie të mos jetë i gjatë, këtë libër sinqerisht ua porosis opinionit tonë musliman, posaçërisht atyre të cilët pohojnë se *të gjitha i bëjnë* sipas medh'hebit hanefij.

Dr. hfz. Safet Haliloviq

HYRJE

Ramazani ka qenë dhe ka mbetur inspirim i përhershëm i të gjitha gjeneratave të muslimanëve që prej kohërave të para e deri sot, e ashtu do të jetë deri në Ditën e Gjykimit. Subtiliteti i tij pushton çdo besimtar, ndërsa atmosfera e veçantë e papërshkrueshme dhe me anë të fjalëve e paarritshme, dendur shtrihet mbi çdo rrugë, rrugicë, shtëpi dhe sikur rrezet e diellit, papengueshëm hynë në çdo shpirt dhe në çdo qenie. Atë etje të cilën shpirti e ndjen dhe për të cilin zemra e njeriut dergjet, e merr nga ato rreze të nurit të Ramazanit, i cili me ngritjen e tij madhështore pezull depërton në pjesët më intime të qenies njerëzore.

Athua, çfarë poeti gjeni duhet të jetë ai njeri, që ta hedhë këtë ndjenjë në shkronja, çfarë oratori duhet të jetë që këtë ndjenjë ta shndërrojë në zëra dhe kuptime?! Çfarë burime të lotëve duhet të ketë, me qëllim të shprehë ndjenjën e mahnitjes, qetësisë dhe lumturisë?! Kuptohet, askush, pa marrë parasysh mendjemprehtësinë e jashtëzakonshme, inteligjencën mahnitëse dhe subtilitetin e shprehur këtë nuk mund ta shprehë dhe tërësisht ta transmetojë nga bota e tij e brendshme në atë të jashtme.

Kjo vetëm mund të ndjehet dhe përjetohet. Vetëm se mund të kënaqet në magjitë e atij që ofron nur të Ramazanit me një spektër të ngjyrave të cilat krijojnë imazhe të mrekullueshme në pjesët e qenies tonë dhe përgjithmonë gdhendin shenja të pashlyeshme në drunjte e zemrave tona, të cilët dridhen në ato rreze mu ashtu sikur që lëkundën degët në erë të fortë.

E di, pa marrë parasysh se sa do të mundohem, se nuk do të mund të shprehë as një pjesë të asaj ndjenje e ta hedhi në këtë letër. Do t'ia lë këtë kënaqjes së shpirtit tim dhe freskisë së zemrës time.

Në faqet vijuese dëshiroj vetëm të paraqes guacën ndërsa margaritarin do t'ua lë zhytësve, të dashuruarve në thellësitë, ata le ta kërkojnë thellë në veten e tyre dhe rreth tyre. Pa dyshim se Ramazani do të na tërheqë në pjesët më të thella të qenieve tona dhe të përbërjes tonë të brendshme, dhe se në vetvete do të zbulojmë horizonte të papara të njohurive të reja dhe tërësisht të ndriçojmë shtigjet e lëvizjeve tona.

Kjo pra, është vetëm njohje më muret e jashtme të Ramazanit dhe të asaj që ai bart me vete. Dëshira jonë është që ato mure formale të jenë faktor i forcimit të ndjenjave subtile brenda asaj kalaje. Sepse, me përdorimin e drejtë të mekanizmave formale arrihet deri te elementet thelbësore, që është edhe qëllimi përfundimtar.

Në të vërtetë, me trajtimin e Ramazanit, do të bëjmë aktualizimin e disa tërësive të patjetërsueshme të cilat janë pjesë të pandashme të këtij muaji.

Këto janë:

1. *Shpallja e Kur'anit*, si ngjarje më revolucionare dhe më humane në historinë e njerëzimit, me shpalljen e të cilit, njerëzimi i vuajtur ka fituar udhërrëfyesin për dalje nga labirinthi i kësaj jete dhe bote.

2. *Bedri*: Bashkësisë së vuajtur dhe të maltretuar kjo betejë e fituar (më 17 të Ramazanit), do t'i japë fuqi, do t'i japë vullnet dhe do të shpërndajë aspiratat në rrugën e së vërtetës. Kjo betejë do të jetë kthesë e ndryshimeve dhe inspirim i përhershëm në të cilën do të kthehen të gjitha gjeneratat e mëvonshme të muslimanëve.

3. *Lejletu-l-kadr*: Nata e arritjeve fascinuese dhe ndjenja se asnjë popull i tokës nuk mund të arrijë atë që u caktuar muslimanëve. Çfarë lehtësimi dhe çfarë shkarkimi?!

4. *Agjërimi*: Me heqjen dorë prej dëshirave fizike, do të ngritemi në lartësitë shpirtërore të përsosurisë dhe frikërespektit (besimit).

5. *Sadakatu-l-fitr*: programi i jashtëzakonshëm social në Tokë i cili me praktikimin e tij rrëzon barrierat ndërmjet të pasurve dhe të varfërve dhe distancën, e shprehur me atë barometër, do ta neutralizojë me të madhe, me ç'rast i afron besimtarët njërin afër tjetrit dhe shpërndanë dashurinë vëllazërore në mesin e anëtarëve të Ummetit.

6. *I'tikaf*: me meditimin në dhjetë netët e fundit të Ramazanit do të zbulojmë atë që na ndanë dhe që na distancojnë nga bota e kafshëve dhe ajo materiale.

7. *Namazi i teravive*: Ngritja shpirtërore nga kjo baltë dhe mjerim i kësaj toke, drejt mbretërisë së All-llahut ku mendja e njeriut dhe intelekti i tij bëhen pluhur! Ky është tentim i largimit tonë nga përqaqimi i fuqishëm i dëshirave të kësaj dunjasë dhe i epsheve, si dhe përpjekja e zhytjes në bukurinë dhe ekstazën e lartësive qiellore.

Dëshira ime e rëndomtë është që me këtë libër, sadopak të kontribuoj në kuptimin më të mirë të Ramazanit, në raportin e drejtë ndaj agjërimin dhe ndaj raportit thelbësor ndaj namazit të teravive. Burimet të cilat i kam shfrytëzuar në këtë libër, do të jenë bazament i mirë për arritjen e shqyrtimit thelbësor në elementet e theksuara.

Zenicë, 27.9.2002

Dr. Shefik Kurdiq

SHPALLJA E KUR'ANIT

Shpallja e Kur'anit është akti më revolucionar në historinë e njerëzimit. Është kontakti i qiellit me tokën; të Lartësuarit me të përlulur, të Gjithfuqishmit me të dobëtin, i të Përhershmit me kalimtarin. Vetëm pas shpalljes, njeriu bëhet i rëndësishëm. Ai vlerësohet, sepse lidhet me të Gjithdiqshmin, të Plotëfuqishmin dhe Mbizotëruesin.

Njeriu, pa marrë parasysh kualitetet e tija fizike dhe shpirtërore, nuk është në gjendje ta njoh qëllimin final të ekzistimit të tij në këtë botë, ndërsa këtë ia zbulon All-llahu xh.sh. nëpërmjet ajeteve të Tij në Shpallje. Njeriu duhet ta lexoj atë, të meditoj për të dhe çdo ditë për të, të mendojë. Pa këto elemente, nuk mund ta njoh. Prandaj edhe ajetet e para të shpalljes ishin:

“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi(çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte.”⁴

Këto fjalë mbushën shpellën Hira afër Mekes, në vitin 610, pikërisht në muajin e Ramazanit. Ato fjalë ishin kthesë në jetën e njerëzimit. Pas kësaj, njerëzimi nuk ishte më si para Shpalljes. Pas shpalljes, beduinët të cilët ishin simbol i prapambetjes, ngecjes dhe analfabetizmit, bëhen bartës të diturisë dhe kulturës, ndërtues të një kulture dhe civilizimi mahnitës.

E vetmja përgjigje në pyetjen: Si ndodhi kjo?, qëndron posaçërisht në kontaktin e qiellit me tokën, porosive universale dhe realizatorit tokësor në jetën praktike. Andaj, të gjithë ata që analizojnë jetën e gjeneratës së parë të muslimanëve, të cilët ishin bartës të kësaj kulture dhe të këtij civilizimi brilant, njëzëri do të pajtohen se burimi i parë dhe i vetmi nga i cili janë furnizuar ajo gjeneratë ka qenë dhe ka mbetur Kur'ani, shpallje dhe fjalë e All-llahut. Hadithi dhe praktika e Muhamedit s.a.v.s. janë vetëm manifestim i atij burimi. Andaj, Aisheja r.a. gruaja e ndershme e Muhamedit s.a.v.s., kur është pyetur për jetën dhe moralin e të Dërguarit të All-llahut, është përgjigjur shumë thjeshtë: *“A nuk ke lexuar Kur'anin: morali i tij ka qenë Kur'ani!”*⁵

Kur'ani pra ishte burimi i vetëm prej të cilit ka pirë gjenerata e parë e muslimanëve. Ata iu kanë përshtatur dispozitave të tij, prej tij kanë thithur këshillat dhe prej tij janë rritur. Kjo kurrësi nuk do të thotë se njerëzimi në atë kohë nuk ka pasur literaturë tjetër, vepra dhe studime tjera të shkruara. Përkundrazi! Të gjithë e dinë se në atë kohë ka ekzistuar kultura, literatura dhe legjislacioni i fuqishëm romak, në themelet e të cilave sot mbështeten në shumë çështje Evropa dhe arritjet e saj.

Në atë kohë ka ekzistuar edhe civilizimi grek, logjika, filozofia dhe arti i tij, burimet e të cilit edhe sot i shfrytëzon mendimi perëndimor.

⁴ Kur'ani: 'Ale, 1-5

⁵ Muslimi, Sahih: 6-Kitabu salati-l-musafirin, 18-Babu xhami'i salati-l-lejli ve men name 'anhu ev merida, hadithi nr. 746. Kjo është në të vërtetë, vetëm pjesë e një hadithi më të gjatë.

Ka qenë i njohur edhe civilizimi persian. Arti, poezia, legjendat dhe besimet e këtij civilizimi kanë ekzistuar që atëherë. Pra, mund të thuhet se gadishulli arab ka qenë i rrethuar prej shumë kulturave të afërta dhe të largëta.

Gjithsesi, nuk është bërë fjalë për varfërinë e kulturave dhe civilizimeve botërore, nga pasuritë dhe rezultatet e të cilëve kanë qenë të cunguar gjenerata e parë e muslimanëve, por është bërë fjalë për një projekt tashmë të kryer, për një model konkret të cilin All-llahu xh.sh. ka dashur që ta vendosë në mesin e njerëzve. Në këtë që e thamë, udhëzon Muhamedi s.a.v.s. kur e ka parë në dorën e Omerit r.a. një faqe të Teuratit, duke i thënë atij: *“Omer, lëre atë! Pasha All-llahun, po të ishte Musa në mesin tonë, edhe ai do të më pasonte!”*⁶

Pra, bëhej fjalë për çlirimin nga ndikimet e huaja në fillim të formimit të shoqërisë islame. Gjeneratat të cilat kanë ardhur më vonë, kanë përzier shumë burime. Kështu, pa kritere precize, tefsirin e Kur’anit, hadithet, fikhun dhe disiplinat thera islame i kanë përzier me filozofinë dhe logjikën greke, me mitet dhe legjendat persiane, me israilijatet çifute, me teologjinë krishtere si dhe me elementet tjera të kulturave dhe civilizimeve të ndryshme.

Furnizimi i gjeneratave të mëvonshme me këto burime të përziera dhe të turbullta, ka rezultuar me këtë gjendje të muslimanëve. Për këtë, është e obligueshme që të kthehemi në burimin e pastër dhe jo të përzier për të formuar personalitetin islam. Kjo nuk do të thotë të hedhim poshtë burimet tjera. Burimi i parë- Kur’ani- duhet të jetë kriteri kryesor dhe pikënisja për pranimin e burimeve tjera. Udhëtreguesi në këtë rrugëtim është shembulli i gjeneratës së parë të muslimanëve.

Duke analizuar jetën e gjeneratës së parë të muslimanëve, do të konkludojmë se përfaqësuesit e saj nuk e kanë lexuar Kur’anin me qëllim që të edukohen dhe të arrijnë deri te njohuritë e reja, e as që të kënaqen në këndimin dhe në leximin e ajeteve të tij. As’habët nuk kanë dashur që me leximin e Kur’anit të ngrisin vetëm nivelin e tyre kulturor, por përkundrazi, nxitja e tyre kryesore ishte që të dinë se çfarë kërkon Kur’ani prej tyre- si ta praktikojnë atë në jetën epërditshme.

Ibn Kethiri në hyrjen e tij të Tefsirit, transmeton një thënie të Abdullah ibn Mes’udit r.a. në të cilën thuhet se muslimanët e parë kanë qenë të kënaqur me dhjetë ajetet e mësuara dhe nuk mësonin mëtej, deri sa ato dhjetë ajete nuk i praktikonin në jetë.⁷

Është e pakontestueshme se ndjenja e pranimin për shkak të praktikimit, gjeneratës së parë të muslimanëve u ka hapur horizonte deri atëherë të panjohura të kënaqësive dhe njohurive, të cilat nuk do t’u ishin zbuluar në qoftë se Kur’anit do t’i ishin afruar vetëm me ndjenjën e hulumtimit, studimit dhe leximit intelektual.

Prandaj Sejjid Kutubi rahmetullahi alejhi, tregon se Kur’ani pasurinë e tij ia dhuron vetëm atij i cili i afrohet në këtë mënyrë - me ndjenjën e njohjes i cili nxitë në veprimin praktik. Kur’ani, ashtu siç thekson Kutubi, nuk është shpallur që të jetë libër dhe burim i kënaqësisë intelektuale, i letërsisë dhe i artit, i tregimeve dhe i ngjarjeve historike- edhe pse e gjithë kjo gjendet në ajetet e tij të ndershme- por,

⁶ Transmeton Hafidh Ebu Ja’la El-Mevsili nga Xhabir ibn Abdullahu r.a.

⁷ Tefsir Ibn Kethir, 1/20.

është shpallur që të jetë mënyrë dhe program jetel!⁸ Ata në mënyrën më të mirë kanë kuptuar fjalët e All-llahut xh.sh.: *“Dhe (ta shpallëm) Kur’anin që Ne e ndamë pjesë-pjesë për t’ua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një.”*⁹

Në këtë ajet në mënyrë shumë të qartë shihet se islami nuk është teori e cila merret vetëm me supozime, por është kodeks i sjelljeve i cili merret me me realitetin konkret dhe me praktikimin në jetën e përditshme. Gjenerata e parë e muslimanëve kështu e kanë kuptuar Kur’anin dhe kanë nxjerrë mësim nga ai. Mirëpo, të gjitha gjeneratat e mëpasme Kur’anit, për fat të keq, iu kanë afruar vetëm ashtu, ose vetëm për kënaqësinë dhe ëmbëlsinë intelektuale, të njohjes dhe asaj shpirtërore. Nga këtu burojnë edhe anomalitë në gjeneratat e mëvonshme nga ndjenja se Kur’ani i shpallet tjetërkujt, e jo- personalisht atij, duke u kënaqur në melodinë e këndimit të Kur’anit nga lexues të mrekullueshëm të tij, e deri te leximi i ajeteve kur’anore për të vdekurit! Kështu, Kur’ani për shkak të moskujdesit dhe marrisë tonë, nga fuqia lëvizëse është bërë në jetën tonë shkronjë e vdekur dhe libër i vdekur.

Ramazani është rast i mrekullueshëm që të analizojmë raportin tonë ndaj Kur’anit. Gjithsesi me ndryshimin e raportit tonë ndaj Kur’anit, do të vijë edhe deri te ndryshimi në vetveten tonë.

BEDRI- SIMBOLI I FITORES NDAJ VETVETES DHE TË TJERËVE

Lufta në Bedër simbolizon luftën ndërmjet besimit dhe kufrit, të vërtetës dhe humbjes, kualitetit dhe kuantitetit, fuqisë së vërtetë dhe fuqisë fiktive. Kjo bejetë ka treguar se me besim të fortë në All-llahun xh.sh. si Dhënës i vetëm i fitores, mund të arrihen rezultate të papritura dhe të mundësh armikun shumë më të fuqishëm, më të përgatitur dhe me numër më të madh.

Ramazani nuk është muaj vetëm i agjërimit dhe i ibadetit. Ai është muaj i fitores. Para së gjithash, i fitores ndaj vetvetes e pastaj ndaj të tjerëve. Për këtë, All-llahu xh.sh. thotë: *“All-llahu u ndihmoi juve në Bedër kur ju ishit pak në numër, e për të qenë mirënjohës, keni frikë nga Zoti.”*¹⁰

Pas luftës trembëdhjetë vjeçare me vetveten, pas tejkalimit të shumë pengesave dhe sprovave të rënda, përjetimit të torturave dhe nënçmimeve të egra, kalitjes në Meken e nxhtë, vjen ëmbëlsira e Ramazanit. Mirëpo, me të vjen edhe ëmbëlsira e parë e fitores.

Mirëpo, deri te ajo fitore nuk do të mund të vinte deri sa nuk vinte deri te fitorja në shpirtin e njeriut dhe në planin e jetës reale. Kur të çlirohet nefs nga vetvetja, nga dëshirat dhe epshet e tij, nga ndytësitat dhe urrejtjet e tij, nga prangat dhe zinxhirët e

⁸ Shih: Sejjid Kutub, Me’alimu fi-t-tarik, fq. 17-18 (në gjuhën arabe). Krahaso gjithashtu: Shenjat në rrugë (botimi në shqip).

⁹ Kur’ani: Israë, 106.

¹⁰ Kur’ani: Ali Imran, 123.

tij, kur të ngutet në prehërin e mëshirës dhe faljes së All-llahut dhe gjithçka ia lë në dorë Atij, atëherë ai do të çlirohet nga të gjitha ngarkesat dhe mundimet, dhe siç thotë Sejjid Kutubi, vjen deri te fitorja: fitorja e vërtetë!¹¹

Kjo fitore nuk ka mundur të përjetohet në fillim të islamit. Kjo ka ndodhur në ditën e 17 të muajit të Ramazanit, në vitin e dytë të Hixhrit, gjejësisht në vitin 624 sipas Isaut a.s. Kjo edhe ka mundur të ndodhë pas një mudi aq të madh, pune dhe edukimi të vetvetes, shpirtit dhe trupit të vetvetes, edhe atë në muajin e faljes, mëshirës dhe bamirësisë, në muajin në të cilin shpirti çlirohet nga të gjitha prangat të cilat nuk i lejojnë një fluturim aq madhështor dhe aq hov dhe goditje të fortë.

FAKTET HISTORIKE TË LUFTËS

Sahabët kanë takuar karvanin e kurejshëve i cili kthehej në Meke prej Shamit. Me këtë rast, nuk ishte planifikuar përleshje e përmasave të mëdha. Duke ditur për këtë plan, Ebu Sufjani, i cili udhëhiqte karvanin, dërgoi për ndihmë në Meke, në kërkesën e të cilit iu përgjigjën afër njëmijë luftëtarë. Prej njëmijë luftëtarëve, pesëqind ishin me mburoja gjoksi, njëqind kalorës dhe shtatëqind deve, ndërsa me të gjithë ata, ishin edhe robërshat dhe këngëtarët, të cilat me këngë dhe defa, nxitnin luftëtarët dhe këndonin këngë thumbuese me të cilat nënçmonin islamin dhe muslimanët.

Nga ana tjetër, muslimanët kishin luftëtarë shumë më pak të armatosur. Veç kësaj, ata ishin tri herë më pak. Historianët theksojnë numrin prej 313 ose 314 muxhahidë. Kishin shtatëdhjetë deve dhe vetëm dy apo tre kuaj.¹²

Diçka më shumë se tetëdhjetë muxhahidë ishin nga radhët e muhaxhirëve dhe me ta komandonte Ali ibn Ebi Talibi r.a. ndërsa të tjerët, si pjesë më e madhe, e përbënin ensarijtë, 61 nga fisi Evi dhe 170 nga fisi Hazrexi, të cilët i udhëhiqte Sa'd ibn Mu'adhi r.a.¹³ Këtu, duhet theksuar veprimin mjaft trimëror të Sa'd ibn Mu'adhit r.a. udhëheqësi i ensarijve, i cili në atë vllug, deklaroi: *"O i Dërguari i All-llahut, tu kemi betuar se do të dëgjojmë dhe do të nënshtrohemi ty! Kudo që të shkosh, ti vetëm nisi, ne do të jemi me ty! Pasha Atë i cili të dërgoi me të Vërtetën, sikur të na çojë përtej detit, ne do të nisemi pas teje dhe askush prej nesh nuk do të mungonte... Udhëhiqna me bekimin e All-llahut!!!"*¹⁴

Pas kësaj deklarate vendimtare të udhëheqësve të ensarijve, Muhammedi s.a.v.s. propozon vendin se ku do të priten armiqtë. Mirëpo, Muhammedi s.a.v.s. ndërron planin pas propozimit më të mirë të Habbab ibn Mundhirit r.a. dhe atëherë muslimanët marrin pozitë që do t'u mundësonte atyre që t'ua ndërprejnë kalimin deri te pusët e Bedrit.¹⁵

¹¹ Shih: Nën hijen e Kur'anit (U okrilju Kur'ana), 4/56

¹² Krahaso: Ibn Hisham, Es-Siretu-n-nebevije, 2/249-262, Muhammed Ahmed Hashimi, Gazvetu Bedr el- kubra, fq. 118-121 dhe dr. Mustafa Es Siba'i, Rruga e jetës së të Dërguarit (Poslanikov životni put), fq. 42-43.

¹³ Safijjurr Rahman El-Mubarekfuri, Er-Rehiku-l-mahtum, fq. 204-205.

¹⁴ Ibn Hisham: Es-Sire en-nebevije, 2/257-258. Krahaso, gjithashtu: El-Mubarekfuri, Nektari i vulosur i Xhennetit.

¹⁵ Shih: dr. M. Es-Sibai, vep. cit., fq. 42-44.

Së shpejti filloi lufta e ashpër, bilanci i të cilës ishte: shtatëdhjetë idhujtarë të vrarë, në mesin e tyre edhe armiku më i madh i islamit, Ebu Xhehli, por edhe prijësit tjerë kurejshitë, dhe shtatëdhjetë të tjerë të zënë rob. Në mesin e muslimanëve kishte katërmëdhjetë shëhidë, edhe atë gjashtë muhaxhirë dhe tetë ensarijë.¹⁶

MËSIMET DHE POROSITË E BEDRIT

Kjo ngjarje nuk do të ishte posaçërisht me rëndësi nëse përmendet vetëm si një fakt historik, nëse në këtë ngjarje historike apo në ndonjë ngjarje tjetër, nuk zbulojmë porosinë dhe nëse nuk marrim mësim e cila del prej asaj.

Qëllimi ynë këtu nuk është që të shprehim kronologjinë e ngjarjeve të kësaj lufte në detaje, por të theksojmë mësimet kryesore të cilat mund t'i zbulojmë pas një analize të thukhtë të kësaj lufte, në dobi të muslimanëve dhe të islamit. Pra, kemi vërejtur se:

1. Lufta në Bedër ka ngjarë si pasojë e urrejtjes patologjike ndaj islamit dhe ndaj muslimanëve, pra ndaj idesë së kundërt. A nuk po ndodhë kjo, me shkaqe të njëjta edhe në Bosnjë, Afganistan, Çeçeni, Kosovë, Palestinë, Irak etj...?!¹⁷
2. Mushrikët dhe hebrenjtë kanë dashur që Medinen ta pastrojnë nga muslimanët. A nuk kanë dashur ta bëjnë të njëjtën armiqtë edhe në Bosnjë, Afganistan, Palestinë, Çeçeni?!
3. Shkaku i sulmeve dhe armiqësive të tyre ka qenë feja dhe vetëm feja! All-llahu xh.sh. këtë qartë e tregon në Kur'anin e Ndershëm: *"E nuk patën pse t'i urrejnë, përveç që e besuan All-llahun, ngadhënjyesin, të lavdëruarin,"*¹⁸
4. Muslimanët ishin shumë dobët të armatosur! Sot a nuk janë?!
5. Makinaria propagandistike e idhujtarëve ka qenë shumë e fuqishme. Makinaria e sotme propagandistike e perëndimit, me infiltrim të haptë të lajmeve për islamit dhe me falsifikimin e qartë, posaçërisht të lajmeve për muxhahidët, është shumë më e fuqishme dhe më perfide!
6. Në atë betejë, kanë qenë dy qasje të kundërta taktike. Deri sa mushrikët para betejës, për tre ditë me radhë kanë pirë verë dhe kanë dëgjuar këngëtarët, muslimanët në anën tjetër kanë kaluar kohën në namaz, në dua dhe lutje që sa më frikë të thithin aromën e Xhennetit!
7. Vendosmëria e të gjithë luftëtarëve në luftë. Muhammedi s.a.v.s. të gjithë i pyet dhe kërkon pajtimin e tyre. E pas kësaj mund të pritet vendosmëria dhe fitorja!
8. Brenga e sahabëve për jetën e Muhammedit s.a.v.s., qartazi është shprehur në ndërtimin e një vend fsheheje për të. Kjo ka qenë fryt i dëshirës së tyre që misioni

¹⁶ Shih: Muhammed El-Hudari Beg, Nuru-l-jekin, fq. 73, shejh Muhammed el-Gazali, Fikhu-s-sire, fq. 230- 231, dr. Muhammed Se'id Ramadan el-Buti, Fikhu-s-sireti-n-nebevije, fq. 158. Krahaso Nektari i vulosur i Xhennetit.

¹⁷ Krahaso: dr. Shefik Kurdiq, Udhërrëfyesit e islamit (Putokazi islama), fq. 10.

¹⁸ Kur'ani: Buruxh, 8.

dhe beteja të kenë sukses, sepse jeta e udhëheqësit, do të thotë jeta e misionit, ndërsa vdekja e tij- humbje e betejës.

9. All-llahu është aleati i robërve të singertë. Kjo qartë u pa në këtë luftë. All-llahu thotë: “*All-llahu largon dëmet e idhujtarëve ndaj atyre që besuan.*”¹⁹

10. Në natyrën e daiut/misionarit të vërtetë është të ketë kujdes edhe për armiq të tij dhe të përdorë gjithçka që t'i afrojë ata drejt të vërtetës. Veprimi i tij me robërit e luftës në Bedër qartë tregon në këtë!

11. Pranimi i propozimit të Habbabit r.a. nga ana e Muhamedit s.a.v.s. flet për tolerancën e tij, pranimin e mendimit dhe të kuptuarit e luftëtarit dhe largon çdo lloj të moskujdesit të udhëheqësit.

12. Institucioni i shurasë/këshillit konsultativ dhe marrëveshja me të gjithë anëtarët në këtë luftë vjen parasysht, sipas fjalëve të All-llahut: “... *e konsultohu me ta në të gjitha çështjet.*”²⁰

13. Trimërinë të cilën daiu dhe komandanti e tregon gjatë luftës, te bashkëluftëtarët dhe pasuesit e tij e nxitë shumë shpirtin luftarak dhe vendosmërinë të cilën nuk mund ta nxisin as mijëra fjalime politike!

14. Përdorimi i vëzhgimit gjithashtu është shkak i fitores. Para kësaj lufte, kanë vëzhguar Muhammedi s.a.v.s. dhe Ebu Bekri r.a.

15. Vendosmëria e përdorimit të taktikës dhe mashtimeve luftarake. Në të vërtetë, muslimanët kanë mbuluar pushtet me qëllim që t'i mashtrojnë kundërshtarët.

16. Për suksesin përfundimtar nuk duhet vetëm përgatitja fizike, numri i luftëtarëve dhe mbështetja materiale. Përveç këtyre, si faktor i pandashëm janë edhe namazi, dua ja dhe lutja drejtuar Atij i cili jep ndihmën dhe fitoren. Muhammedi s.a.v.s. përveç vendosmërisë së fuqishme që të ballafaqohet me armikun, në vendin Ureish, një natë para betejës, është falur gjatë kohës dhe i është lutur All-llahut xh.sh. për sukses. Ai e ka ditur se fitorja vjen vetëm prej All-llahut, ndërsa Atij më së shumti i afrohet me ubudijet/ ibadet.

17. Pas të gjitha këtyre parakushteve të cilat janë të nevojshme për të merituar ndihmën e All-llahut, ajo edhe do të vijë. Në atë luftë kanë ndihmuar edhe melaiket, të cilët para se muslimani të qëllonte armikun në qafë, kishin hequr kokën e armikut. Se pse muslimanët në betejat e tyre nuk kanë këtë lloj të ndihmës sot, shkaqet duhet kërkuar në mosplotësimin e kushteve për dërgimin e ndihmës së All-llahut.

18. Kjo betejë gjithashtu ka vërtetuar jetën e berzahut (varrit) dhe dënimin dhe sprovat e varrit. Këtë e shohim nga reagimi i Omer ibn Hattabit r.a. kur pasi që Muhamedi s.a.v.s. i thërriste idhujtarët e mbytur.

19. Ashtu siç ishte beteja e Bedrit për muslimanët një provë e madhe, në të njëjtën kohë, kishte sjellë papritur edhe plaçkë të madhe të luftës dhe pasurim material.

20. Muhamedi s.a.v.s. ka treguar ixhtihadin e tij me rastin e të zënëve rob në këtë luftë. Mirëpo, ixhtihadi i tij që të zënit rob t'i lirojë e jo t'i vrasë (për të cilën është munduar Omeri r.a.) nuk ka dëmtuar pagabueshmërinë (ismet) e tij.

¹⁹ Kur'ani: Haxhxh, 38

²⁰ Kur'ani: Ali Imran, 159.

LIGJSHMËRITË QË DUHET T'I KEMI NËSE DËSHIROJMË FITOREN

All-llahu xh.sh. për gjithçka në gjithësi ka përcaktuar ligjshmëri, ashtu siç ka dashur Ai. Kur është fjala për luftën, edhe këtu ka përcaktuar ligjshmëri, të cilat nëse përdoren, rezultati do të jetë fitorja e vërtetë. Këto ligjshmëri muslimanët në Bedër i kanë pranuar dhe praktikuar, që më pas rezultoi me një fitore aq brilante. Është me rëndësi të përmendim edhe faktorët të cilët janë të patjetërsueshëm për sukses, siç ishte sukcesi i Bedrit:

1. Të jemi të vetëdijshëm se ndihma dhe fitorja vijnë vetëm prej All-llahut. Ai thotë: *“Nëse All-llahu dëshiron t’ju ndihmojë, s’ka kush që mund t’ju mposhtë, e nëse Ai ju lë pa ndihmë, atëherë kush është ai pas Tij, që do t’ju ndihmojë? Pra, vetëm All-llahut le t’i mbështeten besimtarët.”*²¹

2. Të jemi të vetëdijshëm se All-llahu ndihmon vetëm atë i cili e ndihmon Atë, domethënë, fenë e Tij. Më pas All-llahu forcon pozitat e besimtarëve. Ai është betuar se do të ndihmojë robërit e tij të sinqertë: *“Obligim yni ishte të ndihmojmë besimtarët.”*²² Nëse i bashkëngjitemi ushtrisë së tij, me të vërtetë do të fitojmë: *“Dhe se ushtria jonë do të jenë ata ngadhënjësit.”*²³

3. Që të jemi të vetëdijshëm se fitorja nuk u vjen vetëm vet besimtarëve; ajo gjithashtu vjen vetëm me besimtarët, edhe pse All-llahu xh.sh. nganjëherë këtë fe e ndihmon me mëkatarin. All-llahu xh.sh. thotë: *“Ai është që të fuqizojë ty me ndihmën e vet dhe me besimtarët.”*²⁴

Vetëm me pranimin e këtyre faktorëve mund të vijë deri te raporti më i ndryshëm i fuqive sot në botë.²⁵ Pse të mos shfrytëzojmë të mirat dhe mëshirën e All-llahut?! Pse këta faktorë të mos i marrim në realitetin tonë dhe të mos arrijmë triumf madhështor siç kanë arritur gjenerata e parë e muslimanëve në betejën e Bedrit?!

²¹ Kur’ani: Ali Imran, 160.

²² Kur’ani: Rrum, 47

²³ Kur’ani: Safatë, 173.

²⁴ Kur’ani: Enfal, 62.

²⁵ Më gjërësisht shih: dr. Jusuf Kardavi, Xhilu-n-nasri-l-menshud, fq. 18-25. Krahaso: dr. Shefik Kurdiq, vep. cit., fq. 12-14.

VLERA E LEJLETU-L-KADRIT

Kjo është nata më e vlefshme dhe më e zgjedhur në përgjithësi. Kjo është nata e kontaktit të Qiellit me Tokën. Kjo është ndodhi të cilën Toka nuk e ka përjetuar deri më atëherë. Asgjë nuk mund të krahasohet me këtë natë në aspektin e madhësisë, rëndësisë dhe ndikimit në jetën e njerëzimit.

Nata e Kadrut do të thotë Nata e *përcaktimit dhe planifikimit*, ndërsa mund të ketë kuptimin edhe të *vlerës dhe pozitës*. Të dy kuptimet janë në pajtim me ngjarjen e madhe kosmike e cila do të ndryshojë botën, vlerat dhe kriteret, përpjekjet dhe aspiratat e saj. Kjo është nata madhështore të cilën e zgjodhi All-llahu që të jetë fillimi i shpalljes së Kur'anit i cili dritën e tij do ta shpërndajë fuqishëm në vetëdijen njerëzore dhe në jetën e përgjithshme të njeriut.

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “Kush agjëron Ramazanin, duke besuar se e ka obligim dhe duke llogaritur se për këtë do të shpërblehet, do t’i falen mëkatet e kaluara, ndërsa kush e kalon Natën e Kadrut në ibadet, duke besuar se e ka obligim dhe duke shpresuar vetëm në shpërblimin e All-llahut, do t’i falen mëkatet të cilat i ka bërë më parë!”²⁶

Hadithi i cituar mjaft flet për vlerën e kësaj nate. Po të mos kishte nëpërmjet Kur'anit dhe sunnetit, nxitje tjera në shtimin e ibadetit, do të mjaftonte vetëm ky hadith. Në të vërtetë, shtimi i ibadetit në këtë natë duhet të jetë rigjallërim i kuptimit të rëndësisë të cilën bartë kjo natë. Programi islam në edukim, siç thotë Sejjid Kutubi, e lidhë ibadetin dhe fenë në vetëdije dhe ai këtë ibadet e bënë si mekanizëm për rigjallërim të këtyre të vërtetave, për sqarimin dhe forcimin e tyre në një pamje të gjallë e cila përfshkon ndjenjat duke mos u ndalur vetëm në kornizat e të menduarit.²⁷

KUR'ANI PËR NATËN E KADRIT

Kur'ani në dy vende në mënyrë konkrete përmend këtë natë, duke i dhënë dy emra: *Lejletun mubareketun* / Nata e bekuar, dhe *Lejletu-l-Kadr*/ Nata e Vlefshme. Në kaptinën *Duhan*, All-llahu xh.sh. thotë: “Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar (në natën e begatshme të kadrut).”²⁸

Kaptina Kadr e ka marrë emrin në bazë të kësaj nate madhështore: “Ne e zbritëm atë(Kur'anin) në natën e Kadrut. E ç’të bëri ty të dijshe se ç’është nata e Kadrut? Nata e Kadrut është më e rëndësishme se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre në(atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti(Xhibrili) për secilën çështje. Ajo(që përcakton Zoti) është paqë deri në agim të mëngjesit.”²⁹

²⁶ Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Tirmidhiu (këtu mendohet në mëkatet për të cilat nuk duhet tevbeja me kushtet e saj).

²⁷ Shih për këtë: Sejjid Kutb, Nën hijen e Kur'anit (U okrilju Kur'ana), 30/265-266.

²⁸ Kur'ani: Duhan, 3

²⁹ Kur'ani: Kadr, 1-5.

Në kaptinën Bekare All-llahu xh.sh. përmend se Kur'ani është shpallur në muajin e bekuar të Ramazanit: “(ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit që në të(filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues(i të vërtetës nga gënjeshtër).”³⁰ Pra, këtu në mënyrë implicite përmendet se kjo natë është në Ramazan.

PSE KJO NATË E KA MARRË KËTË EMËR?

Muxhahidi thotë se kjo natë e ka marrë emrin për shkak se është Natë e vendimit.³¹ Të tjerët thonë se është quajtur ashtu për shkak se All-llahu në atë natë përcakton jetën, vdekjen, nafakën dhe të tjera për tërë vitin.³² Disa thonë se është quajtur ashtu për shkak të vlerës dhe nderit të saj.³³ Shumë autorë theksojnë se është quajtur ashtu për shkak se me nënshttrim në këtë natë, fitohen shumë nderime dhe shumë shpërblime.³⁴ El-Halili thotë se është quajtur kështu për shkak të prezencës së madhe të melaikëve në Tokë gjatë kësaj nate.³⁵

PËRCAKTIMI I NATËS SË KADRIT

Dijetarët islam rreth përcaktimit të Natës së Kadrin, kanë më shumë se 40 mendime.³⁶ Disa thonë se kjo natë ka qenë vetëm në kohën e Muhamedit s.a.v.s. e pastaj është ngritur. Mirëpo, shumica e sahabëve dhe e dijetarëve islam, mendojnë se ajo është aktuale deri në Ditën e Gjykimit. Kjo qartë shihet nga transmetimi në të cilën Ebu Hurejre r.a. ka qenë i pyetur lidhur me këtë se, a është ngritur kjo natë apo jo, dhe është përgjigjur se kjo natë është prezente në çdo Ramazan.³⁷ Pra, askush nuk dyshon se kjo natë është në Ramazan. Dyshimi i vetëm është: cila është ajo natë e Ramazanit? Veçohen Abdullah ibn Mes'udi r.a., Ebu Hanife dhe disa të tjerë të cilët mendojnë se kjo është një natë gjatë vitit, duke mos dashur që ta definojnë në mënyrë precize, me qëllim që njerëzit gjatë tërë vitit të jenë të angazhuar në ibadet!³⁸

Ebu Rezin El-'Ukajli pohon se kjo është nata e parë e Ramazanit.³⁹ Ibn Mulekkini

³⁰ Kur'ani: Bekare, 185.

³¹ Shih për këtë: Ez-Zexhaxh, Me'ani-l-Kur'ani ve e'arabuhu, 5/347; Ebu Hajjan, Tefsir El-Bahru-l-muhit, 8/492; El-Kutubi, El-Xhami'u li ahkami-l-Kur'an, 20/131 dhe Es-Sujutiu, Ed-Durru-l-mensur, fi-t-tefsiri-l- me'sur, 6/628.

³² Krahaso: Tefsiru-l-begavi, 4/509; Ibn Haxheri, Fet'hu-l-bari, 4/301; Esh-Shevkani, Fet'hu-l-kadir, 5/471 dhe El-Kinnuxhi el-Buhari, Fet'hu-l-bejan, fi mekasidi-l-Kur'an, 15/321.

³³ Shih: Tefsir Ibn Atijje, 15/520-521; El-Kutubi, vep. cit., 20/130 dhe Esh-Shevkani, vep. cit., 5/472.

³⁴ Shih: Ebu Hajjan, vep. cit., 8/492; El-Kutubi vep. cit., 20/131 dhe Esh-Shevkani vep. cit., 5/472.

³⁵ Tefsiru-l-Kutubi, 20/131; Ibn Haxheri, vep. cit., 4/301 dhe El-Kinnuxhi, vep. cit., 15/322.

³⁶ Shih: Esh-Shevkani, vep. cit., 5/472.

³⁷ Tefsiru-l-Begavi, 4/509 dhe Fet'hu-l-Bari, 4/309.

³⁸ Shih: E.M., Nata më e zgjedhur dhe më e vlefshme (Najvrednija i najodabraniya noç), në Novi Horizonti, viti 1, nr.4 dhjetor 1999, fq. 32.

³⁹ Krahaso: Fet'hu-l-Bari, 4/310.

mendon se kjo mund të jetë nata e 15,⁴⁰ ndërsa Hasan El-Basriu mendon se është nata e 17.⁴¹ Disa mendojnë se kjo është nata e 18, gjegjësisht e 19.⁴² Ebu Se'îd El-Hudri r.a., dhe Imam Shafi'u mendojnë se kjo është nata e 21, disa e 23 ndërsa ka prej atyre të cilët mendojnë se kjo është nata e 24, 25, 26 apo nata e 29 e Ramazanit.⁴³

Shumica e dijetarëve islam preferojnë natën e 27 për dallim nga netët tjera për shkak të disa transmetimeve të Muhamedit s.a.v.s. në të cilat precizohet pikërisht kjo natë.⁴⁴ Nga ana tjetër, disa dijetarë islam theksojnë se në kaptinën *Kadr* gjenden 30 fjalë, dhe se fjala e 27 është HIJE/ ajo, dhe për këtë, disi tregohet se bëhet fjalë për natën e 27. Gjithashtu, duhet theksuar se *Lejletu-l-Kadr* në këtë sure përmendet tri herë, e cila kur të shumohet me nëntë, sa ka ajo shprehje harfe, rap del numri 27.⁴⁵

Ubejj ibn Ka'b r.a. është betuar se bëhet fjalë për natën e 27. Mirëpo, shumica e dijetarëve islam këtë e marrin përgjithësisht dhe mendojnë se kjo ka të bëjë vetëm në një vit të caktuar.⁴⁶

Mirëpo, është e qartë se më e drejtë është ajo që e mendojnë shumica, domethënë se kjo natë është në dhjetë netët e fundit të Ramazanit, në bazë të hadithit të Muhamedit s.a.v.s. të cilën e transmeton Aishja r.a. në të cilën ka thënë: *"Kërkone natën e Kadrit në dhjetë ditët e Ramazanit!"*⁴⁷ Në një transmetim tjetër, gjithashtu prej Aishes r.a., Muhamedi s.a.v.s. thotë: *"Kërkoni natën e Kadrit në netët tek të dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit!"*⁴⁸

Mendimi më i përhapur edhe te ne, edhe në botë, është se bëhet fjalë për natën e 27 të Ramazanit të bekuar. Mirëpo, kjo nuk është plotësisht e sigurtë. Ekzistojnë argumente se kjo natë gjendet në dhjetë ditët e Ramazanit, dhe prej këtu Muhamedi s.a.v.s. në dhjetë ditët e Ramazanit, e ka shtrënguar rroben e tij, është larguar nga shtrati, e ngjallte natën me ibadet dhe ka nxitur edhe familjen e tij në ibadet të shtuar në këtë periudhë.⁴⁹

Kështu, Muhamedi s.a.v.s. dhjetë ditët e fundit të Ramazanit i ka kaluar në itikaf. Këtë e ka bërë deri në vdekjen e tij, e pas vdekjes së tij, kjo ka qenë praktikë e grave të tij të ndershme.⁵⁰

Parashtrohet pyetja: Cili është caku i përcaktimit jo preciz të kësaj nate në islam?

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Tefsiru-l-Begavi, 4/510 dhe Fet'hu-l- Bari, 4/310.

⁴² Fet'hu-l-Bari, 4/310.

⁴³ Shih për këtë: Fet'hu-l-bari, 4/311 dhe Shefik Kurdiq, vep.cit., fq. 123.

⁴⁴ Muslimi në Sahih thekson transmetimin e Ubejj b. Ka'bit r.a. në të cilën Muhamedi s.a.v.s. thekson: "Ajo është nata e 27!"

⁴⁵ Krahaso: Tefsir Ibn kethir, fq. 1515, Botimi i VSK për ndihmë BIH, Sarajevë 2000 dhe E.M. artikulli i theksuar në Novi Horizonti, fq. 32.

⁴⁶ Shih: dr. Shefik Kurdiq, vep. cit., fq. 123.

⁴⁷ Buhariu dhe Muslimi.

⁴⁸ Buhariu.

⁴⁹ Transmeton Buhariu. Për këtë më gjerësisht shih: Ibn Haxheri, Fethu-l-bari. Kaptina për vlerën e natës së Kadrit, 4/316-317.

⁵⁰ Transmeton Buhariu dhe shumë autorë të tjerë të përmbledhjeve të haditheve. Më gjerësisht për itikafin, shih: Fethu-l-bari, 4/318-335.

Qëllimi përfundimtar është pa dyshim, angazhimi i shtuar gjatë tërë Ramazanit, e posaçërisht në dhjetë ditët e fundit. Fahrud-din Er-Raziu në tefsirin e tij të njohur thotë se fshehja e kësaj nate gjatë Ramazanit, në të vërtetë, është rigjallërimi i të gjitha netëve të Ramazanit, sepse- siç thotë ai- ai i cili me të vërtetë nuk është i bindur se nata e Kadrit nuk është vërtetuar në mënyrë precize, ai do të mundohet që të jetë në ibadet edhe në netët tjera të Ramazanit, duke shpresuar se ajo natë do të jetë- Nata e Kadrit.⁵¹

VLERA E KËSAJ NATE

All-llahu xh.sh. me vetë pyetjen: *“E ç’të bëri ty të dijshe se ç’është nata e Kadrit?”*⁵² në mënyrë më të mirë ka vërtetuar vlerën e saj, sepse kur All-llahu fillon ndonjë ajet me *ve ma edrake/* çka mendon ti?, ai me këtë ia tërheq vëmendjen atij të cilit i drejtohet për diçka që është me rëndësi të veçantë.

Sikur që All-llahu me këto fjalë dëshiron të thotë, siç përmendin disa komentues të kësaj kaptine, se njerëzimi nuk mund ta kuptojë këtë dhe se këtë vetëm All-llahu e di.⁵³

Në ajetin e ardhshëm të kësaj kaptine, All-llahu xh.sh. thotë: *“Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!”*⁵⁴ të gjithë mufesirët përmendin transmetimin e Muxhahidit në të cilën thuhet se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë se si një pjesëtar i benu Israilëve ka luftuar në rrugë të All-llahut një mijë muaj- e ato janë 83 vjet e 4 muaj- dhe sahabët kanë qenë të fascinuar me këtë qëndrueshmëri, duke vuajtur për këtë shpërblim, dhe pastaj All-llahu e ka shpallur këtë ajet, duke proklamuar se angazhimi në këtë natë është më i mirë se një mijë muaj në të cilën nuk ka netë të tilla.⁵⁵

Imam Sujutiu përmend se Muxhahidi, duke komentuan këtë ajet, ka thënë se kjo natë është më e vlefshme se 1000 muaj punë, veprim, agjërim dhe kijam, muaj në të cilët nuk gjendet kjo natë.⁵⁶ Mendim të njëjtë kanë shprehur edhe El-Fera’ dhe Ez-Zexhaxhi.⁵⁷ Zamahsheri në *Keshshaf*, duke komentuar këtë ajet, thotë se shkas për ngritjen e kësaj nate është rezultat i asaj që gjendet në të nga dobitë fetare.⁵⁸

Gjithashtu ekzistojnë edhe versione në të cilën thuhet se Muhamedi s.a.v.s. ka konsideruar se afati i jetës së ummetit të tij është i shkurtë, dhe ka pasur frikë se ata nuk do të mund të mbërrijnë veprat e gjeneratave të mëparshme, dhe pastaj, All-llahu xh.sh. ia ka dhënë natën e Kadrit dhe e ka bërë më të mirë se 1000 muaj të cilat

⁵¹ Shih: Shefik Kurdiq, vep. cit., fq. 123-124.

⁵² Kur’ani: Kadr, 2.

⁵³ Shih çka thotë për këtë: Ebu Hajjani, vep.cit., 8/493; Shevkani, vep.cit., 5/472 dhe El-Kinnuxhi, vep.cit., 15/322.

⁵⁴ Kur’ani: Kadr, 3.

⁵⁵ Shih për këtë: Tefsir Ebu Hajjan, 8/492; Tefsiru-l-Begavi, 4/512; Tefsiru-l-Kurtubi, 20/131; Es-Sujutiu, vep.cit., 6/629; Shevkani, vep.cit., 5/472 dhe El-Kinnuxhi, vep.cit., 15/322.

⁵⁶ Imam Sujutiu, vep.cit., 6/629.

⁵⁷ Krahaso: Fet’hu-l-kadri, 5/472.

⁵⁸ Dr. Shefik Kurdiq, vep.cit., fq. 122.

i kanë pasur gjeneratat e mëparshme.⁵⁹ Disa thonë se me fjalët *njëmijë muaj* dëshirohet të tregohet e tërë koha, sepse, kur arabët e përdorin shprehjen *njëmijë* atëherë mendohet në diçka të madhe!⁶⁰

Vlera e kësaj nate është absolutisht e pamasë dhe e paçmueshme. Në të vërtetë, *më e rëndësishme se një mijë muaj* nuk do të thotë - siç mendon Sejjid Kutb - kufizimi dhe përcaktimi preciz i asaj nate, por tregon vetëm shumësinë dhe vlerën e madhe.⁶¹

Rëndësinë dhe vlerën e kësaj nate e tregon Zoti i gjithësisë dhe i gjithçkaje të krijuar, në vazhdim të kësaj kaptine: “Me lejen e Zotit të tyre në(atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti(Xhibrili) për secilën çështje. Ajo(që përcakton Zoti) është paqë deri në agim të mëngjesit.”⁶² Në të vërtetë, për shkak të bekimit të kësaj nate, melaiket në të zbresin lëshohen në Tokë më shumë se zakonisht. Përndryshe, melaiket në numër më të madh zbresin- ashtu siç thotë Ibn Kethiri- kur të lëshohet bekimi dhe mëshira.⁶³ Shumica e komentuesve, shprehjen Er- Ruh e konsiderojnë si sinonim i Xhibrilit a.s.⁶⁴ Disa me këtë nënkuptojnë llojin e melaikeve më të zgjedhura dhe më të ndershme.⁶⁵ Disa, prap thonë se Er-Ruh është ushtria, por jo e përbërë prej melaikeve.⁶⁶ Është interesant mendimi i atyre të cilët thonë se kjo shprehje do të thotë, mëshirë.⁶⁷

Fjalët: “*zbresin engjëjt dhe shpirti(Xhibrili) për secilën çështje*, dojnë të thonë, ashtu siç kuptojnë mufessirët, zbresin për çdo gjë të cilën All-llahu e ka përcaktuar atë vit. El-Kelbi pohon se melaiket zbresin dhe u japin selam çdo njeriu në atë natë.”⁶⁸

Në ajetin e fundit të kësaj kaptine: “*Ajo(që përcakton Zoti) është paqë deri në agim të mëngjesit*,” mendohet në sigurinë prej shejtanit dhe nga ngacmimet e tij.⁶⁹ Muxhahidi thotë se kjo është nata shpëtimtare në të cilën shejtani nuk posedon mundësi për veprim të keq dhe për shqetësim të besimtarit.⁷⁰ Esh-Shabiu thotë: “*Kjo është dërgimi i selamit nga ana e melaikeve deri te besimtarët nëpër xhamia, prej perëndimit të diellit e deri në lindjen e agimit, të cilët duke kaluar përsëj çdo besimtar, thonë: O besimtar, selami qoftë mbi ty!*”⁷¹ Disa pohojnë se atë natë melaiket dërgojnë njëri tjetrit selame.⁷² Ata’iu mendon se me këtë nënkuptohet në selamin i cili u është dërguar evlijave dhe atyre

⁵⁹ Shih këtë version te: Tefsir Ibn Atijje, 15/519; Tefsiru-l-Kurtubi, 20/132; Fethu-l-bari, 4/309; Imam Sujuti, vep.cit., 6/629; Fet’hu-l-kadir, 5/472 dhe El-Kinnuxhi, vep.cit., 15/323.

⁶⁰ Shih: Fet’hu-l-kadir, 5/472.

⁶¹ Sejjid Kutub, vep.cit., 30/264.

⁶² Kur’ani: Kadr, 4-5.

⁶³ Tefsir Ibn Kethir, fq. 1515.

⁶⁴ Shih: Tefsiru-l-Begavi, 4/512; Ez-Zexhaxh, vep.cit., 5/348 dhe Fet’hu-l-kadir, 5/472.

⁶⁵ Kurtubiu thekson se ata janë roje të melaikeve, të cilat melaiket nuk i shohin, ashtu siç nuk i shohim ne melaiket. (Shih: Tefsiru-l-Kurtubi, 20/133).

⁶⁶ Shih: Fet’hu-l-kadir, 5/472.

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Tefsir Ibn Kethir, fq. 1515.

⁷⁰ Shih: Ez-Zexhaxh, vep.cit., 5/348; Tefsiru-l-Begavi, 4/512; Tefsiru-l-Kurtubi, 20/134 dhe Imam Sujuti, vep.cit., 6/630.

⁷¹ Shih: Tefsiru-l-Begavi, 4/512; Tefsiru-l-Kurtubi, 20/134 dhe Imam Sujuti, vep.cit., 6/630.

⁷² Shih: El-Kinnuxhi, vep.cit., 15/324 dhe Fet’hu-l-kadir, 5/472.

të cilët janë në nënshtrim të vërtetë ndaj All-llahut të Mëshirshëm.⁷³

SI TA SHFRYTËZOJMË MË SË MIRI KËTË NATË?

Pasi që kjo natë lajmërohet vetëm një herë në vit, dhe se është më e vlefshme se një mijë muaj në të cilat nuk ka këso nate, e cila ofron rastin e vetëm për fitimin e mirësive të All-llahut, duhet patjetër ta shfrytëzojmë në mënyrën më të mirë. Muhamedi s.a.v.s. nëpërmjet këshillave qartë ka treguar se këtë natë duhet ta kalojmë në ibadet. Për këtë Muhamedi s.a.v.s, në pyetjen e Aishes r.a. se çka të lexojë në këtë natë, i ka propozuar një dua, të cilën duhet edhe ne ta mësojmë dhe ta lexojmë shumë herë në këtë natë. Duaja është kështu:

“All-llahumme inneke Afuvvun, tuhibbu-l-‘afve, fa’fu ‘anni

O All-llah, Ti me të vërtetë je Ai që falë, e do faljen, pra, falmë mua.”⁷⁴

Pasi që në këtë natë ka filluar zbritja e fjalëve të All-llahut, vendosja e kodeksit të sjelljes së njeriut në Tokë dhe vendosja e ligjeve të All-llahut, sipas të cilave krijesat e Tij duhet të veprojnë, atëherë, bile në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit duhet më fort të përjetojmë zërin e Kur’anit, më shumë ta lexojmë, të mendojmë për të dhe të përpiqemi që në vetëdijen tonë ta fusim faktin se Kur’ani neve është duke na u shpallur.

Dhe pas leximit të Kur’anit dhe gjetjes së metodave të ndruarnduarshme që leximin e Kur’anit ta thithim në jetën e përditshme, do të përjetojmë plotësinë, vlerën dhe kuptimin e vërtetë të kësaj nate, dhe në fund, do të kuptojmë se Kur’ani edhe neve po na shpallet.

AGJËRIMI

Rëndësinë dhe vlerën e institucionit të agjërit njeriu nuk është në gjendje që plotësisht ta kuptojë. Rëndësia dhe vlera e këtij ibadeti qëndron në atë se All-llahu xh.sh. për agjëruetin ka përgatitur shpërblim të veçantë. Ebu Hurejre r.a. transmeton një hadith të Muhamedit s.a.v.s. në të cilin thuhet: *“All-llahu i Lartësuar ka thënë: Çdo vepër e njeriut i takon atij – përveç agjërit, ai më takon Mua dhe Unë për të shpërblej (posaçërisht)!”*⁷⁵

⁷³ Tefsiru-l-Begavi, 4/512, El-Kinnuxhi, vep.cit., 15/324 dhe Fet’hu-l-kadir, 5/472.

⁷⁴ Tirmidhiu, Nesaiu, Ibn Maxhe, Ahmedi dhe të tjerë.

⁷⁵ Buhariu, Sahih: 30-Kitabu-s-savmi, 9-Babu ma jekulu: Inni saimun idha shutime, hadithi nr. 1904; Muslimi, Sahih: 13-Kitabu-s-sijami, 30-Babu fadli-s-sijami, hadithi nr. 1151.

KATEGORITË E AGJËRIMIT

Disa dijetarë islamë agjërimin e ndajnë në tre kategori:

1. Agjërimi i zakonshëm i cili përbëhet nga përmbajtja nga ushqimi, pija dhe marrëdhëniet seksuale.
2. Agjërimi i veçantë i cili përbëhet nga përmbajtja e të dëgjuarit, të pamurit, të folurit, lëvizjes së duarve, këmbëve dhe pjesëve tjera prej mëkateve.
3. Agjërim specifik e ky është agjërimi i zemrës, i liruar nga të gjitha epshet e ulëta dhe mendimet e dunjasë, duke hedhur gjithçka poshtë përveç All-llahut xh.sh. Kjo është shkalla e Pejgamberëve, të devotshmëve dhe njerëzve të afërt tek All-llahu.⁷⁶

Kur është fjala për agjërimin e veçantë, i cili përbëhet nga të larguarit e të gjitha organeve nga mëkatet, ai mund të quhet agjërim i njerëzve të mirë dhe besimtarë. Agjërimi i njerëzve të mirë dhe besimtarë arrihet me:

a). Me uljen e shikimit nga ajo që është e keqe dhe urrejtur, nga gjithçka që preokupon zemrën dhe që të largon nga të kujtuarit e All-llahut xh.sh. ashtu siç thotë Muhammedi s.a.v.s. në një transmetim të cilën e përcjell Hudhejfe ibn Jemani r.a.: *“Shikimi është shigjetë helmuese e Iblisit, All-llahu e mallkoi! Kush e lë nga frikërespekti ndaj All-llahut, Ai do t'i japë atë lloj imani, ëmbëlsinë e të cilit do ta ndjejë në zemrën e tij!”*⁷⁷

b). Ruajtjen e gjuhës prej rrenës, përgojimeve, shpifjeve, sulmeve dhe grindjeve, me heshtje të obligueshme dhe përdorimin e gjuhës në dhikër të All-llahut xh.sh. dhe në mësimin e Kur'anit të ndershëm. Ky është agjërimi i gjuhës.

Sufjan Eth-Thevri ka thënë: “Përgojimi e prishë agjërimin!”, ndërsa Muxhahidi thotë: “Dy veti e shkatërrojnë dhe zhvleftësojnë agjërimin janë: përgojimi dhe rrena!”⁷⁸

c). Largimi prej të urrejturës, ngase gjithçka që është e ndaluar të thuhet, është e ndaluar edhe të dëgjohet. Ngase All-llahu xh.sh. e krahason dëgjuesin e të urrejturës me atë që ushqehet me haram: *“Janë ata që i përgjigjen të pavërtës dhe hanë shumë haramin.”*⁷⁹

Mos reagimi dhe heshtja kur dikush përgojohet në prezencën tuaj, është gjithashtu haram, siç thotë All-llahu xh.sh.: *“Përndyshe, ju do të jeni si ata.”*⁸⁰

ç). Të përmbajturit e pjesëve tjera të trupit: duarve dhe këmbëve nga mëkatet, si dhe ruajtja e barkut nga ushqimi i dyshimtë në iftarë. Në të vërtetë, qëllimi i agjëritimit nuk është të përmbajturit nga ushqimi i lejuar e pastaj iftari të bëhet me ushqim të ndaluar (haram), sepse hallalli nuk dëmton me llojin e tij por me të tepruarit. Qëllimi

⁷⁶ Për këto kategori të agjëritimit shih: Gazaliu, Ihjau ‘Ulumi-d-din, 1/428-432; El-Makdisi, Muhtesaru minhaxhi-l-kasidin, fq. 44; Xhemaluddin El-Kasimi, Tehdhibu mev'idhati-l-mu'minin, fq. 43-44.

⁷⁷ Hakimi, Mustedrek dhe zinxhirin e këtij hadithi e konsideron të besueshëm. (Shiko: Tahrirx Hafidh El- Iraki, i botuar së bashku me Ihja ‘ulumi-d-din, të Imam El-Gazaliut, 1/428).

⁷⁸ Ihjau ‘ulumi-d-din, 1/429.

⁷⁹ Kur’ani: Maide, 42

⁸⁰ Kur’ani: Nisa, 140

i agjërimit është përdorimi minimal i ushqimit, sepse edhe ilaçi hallall bën dobi, nëse përdoret në sasi të nevojshme, ndërsa bën dëm në sasi të tepruara.

Ebu Hurejre r.a. transmeton një hadith në të cilin Muhamedi s.a.v.s. thotë: “Sa janë prej tyre që agjërojnë, ndërsa nga agjërimi i tyre kanë vetëm urinë dhe etjen!”⁸¹

Disa dijetarë islam mendojnë se kjo ka të bëjë me iftarin haram, të tjerët se ajo ka të bëjë me të bërit iftar me mishin e njerëzve, domethënë me përgojime, derisa të tjerët mendojnë se kjo është pengimi i organeve që të bëjnë mëkate.

d). Pakësimin e ushqimit me rastin e iftarit, sepse tek All-llahu ena më e urryer, që mund të mbushet me hallall, është barku i fryrë. Athua, çfarë është dobia e agjërimit nëse gjatë natës plotësojmë gjithë çka na ka ikur (munguar) gjatë ditës?!

Qëllimi i agjërimit është ndalimi i shpërthimit të epsheve, forcimin e frikërespektit (besimit), dhe nëse kjo në mbrëmje kompensohet me anë të ushqimit, sërish do të forcojë nefsën dhe do të shpërthejë epshtet, të cilat gjatë ditës duke iu falënderuar agjërimit, kanë qenë të qetësuar. Dobësimi i fuqive, që janë mjet i shejtanit për kthim në të keqe, arrihet me zvogëlimin e ushqimit.

Madje, nuk preferohet as shumë gjumë gjatë ditës, me qëllim që të ndjehet uria, etja dhe dobësimi i fuqisë - faktorë këta të cilët ndezin zjarrin e epsheve dhe dëshirave.

Dh). Agjëruesi pas iftarit të jetë i brengosur dhe të jetojë ndërmjet frikës dhe shpresës, ngase nuk e din se a i është pranuar agjërimi apo i është refuzuar?! Imam El-Gazali citon disa dijetarë islamë të cilët thonë: *“Sa agjërues ka që hanë, ndërsa sa ka që hanë- por janë agjërues! Ai i cili hanë, ndërsa është agjërues, është ai i cili ruan organet e tij prej mëkateve, por han edhe pin, derisa ai i cili është agjërues- ndërsa hanë, është ai i cili mbetet i uritur dhe duron etjen, por që nuk ruan organet e tij prej mëkateve!”*⁸²

DISA ASPEKTE TË AGJËRIMIT

Nëse analizohet agjërimi islam, vërehen disa aspekte të tij:

1. ASPEKTI SHPIRTËROR:

Në agjërim, para dhe pas së gjithash, vërehet dorëzimi i plotë te All-llahu dhe robërimi i plotë vetëm Atij. Agjërimi, të cilin All-llahu xh.sh. ua ka bërë muslimanëve detyrë obligative, çliron njeriun nga kthetrat e epsheve dhe nga burgu i trupit, duke e afruar atë drejt botës së melaikeve dhe të lartësive shpirtërore.

⁸¹ Ibn Maxhe, Sunen: 7-Kitabu-s-sijam, 21-Babu ma xhae fi-l-gibeti ve-r-refesi li-s-saimi, hadithi nr. 1690. Hadithin gjithashtu nëpërmjet Ebu Hurejres r.a. e përmendin Ahmedi, Hakimi dhe Bejhekiu, derisa Taberaniu e transmeton nga Abdullah ibn Omeri r.a. Hadithi është vlerësuar autentik. (Shih: Albani, Sahihu-l-Xhami'-s-saghir, hadithi nr. 3488 dhe 3490, 1/656.

⁸² Ihjau 'ulumi-d-din, 1/432.

Njeriut kur t'i shtohen begatitë, më pak i ndjenë ato, dhe pasi që i humb ato, ai fillon t'i vlerësojë dhe t'i kuptojë drejtë. Nëpërmjet agjërimit njihet vlera e të mirave të Allahut të cilat na janë dhënë nëpërmjet ushqimit dhe pijes.

Agjërimi posaçërisht forcon vullnetin dhe edukon agjëruesin në durueshmëri. Agjëruesi qëndron i uritur, ndërsa para tij qëndron ushqimi i cili e provokon, duron etjen ndërsa afër duarve të tij qëndron uji i ftohtë, duron t'i afrohet gruas së tij, ndërsa atë e ka afër... Në këto gjëra nuk ka kontrollues më të mirë se All-llahu xh.sh., e as që ka dëshmi kundër vetëdijes së tij, derisa atë asgjë nuk e përkrahë, përveç vullnetit të tij të vetëdijes.

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: "Për çdo gjë jepet zeqati. Zeqati i trupit është agjërimi, ndërsa agjërimi është gjysma e durimit!"⁸³

Dihet se në njeriun ekzistojnë tri fuqi: fuqia e epshit sikur te kafshët, fuqia e zemërimit, sikur te egërsirat dhe fuqia shpirtërore sikur te melaiket. Pas dominimit të fuqisë shpirtërore mbi dy të tjerat, arrihet gjysma e durimit.

Me agjërime besimtari i mund epshet e barkut dhe të organeve gjenitale, kështu që me të vërtetë agjërime bëhet gjysma e durimit.

Islami nuk është fe e dobësisë dhe e nënshtrimit, por përkundrazi, fe e luftës së pandërprerë. Së pari ku shihet gatishmëria në luftë është durimi dhe vullneti i fortë, dhe nëse njeriu nuk lufton me vetveten, atëherë ai është larg luftës me armikun. Kush nuk është në gjendje që të durojë urinë e një dite, atëherë si mundet që ai, të përjetojë ndarjen nga familja ose atdheu me qëllim të arritjes së ndonjë qëllimi të lartë, i cili nënkupton mundime dhe sakrifica të mëdha?!

2. ASPEKTI SHËNDETËSOR:

Agjërime nuk është rast vetëm për forcimin e shpirtit, vullnetit dhe durimit, por në agjërime është shansi për forcimin e trupit. Ka shumë njerëz të cilët janë sëmurë për shkak të konsumimit të tepruar të ushqimit dhe pijeve, duke i kaluar kufijtë e të lejuarës.

Muhamedi s.a.v.s. në këtë rast në një transmetim Mikdam ibn Ma'dikeribit r.a. thotë: "Njeriu nuk gjenë ndonjë enë për të mbushur më e keqe se barku i tij. I mjaftojnë atij disa kafshata për të plotësuar nevojat e tij, e nëse duhet të hajë më shumë, atëherë një të tretën e barkut ta mbushë me ushqim, të dytën me ujë ndërsa të tretën le ta lërë që të marrë frymë pandërprerë!"⁸⁴

⁸³ Ibn Maxhe, Sunen: 7-Kitabu-s-sijam, 44-Babu fi-s-savmi zekatu-l-xhesedi, hadithi nr. 1745 dhe El-Kuda- i, Musnedu-sh-shihab, 158- Es-Sijamu nisfu-s-sabri, hadithi nr. 229.

⁸⁴ Tirmidhiu, Sunen: 37- Kitabu-z-zuhd, 47- Babu ma xhae fi kerahijeti kesreti-l-ekli, hadithi nr. 2380 dhe e vlerëson si hasen-sahih, ndërsa këtë e përmend edhe Ahmedi në Musnedin e tij, 4/132.

Nëse lukthi është shtëpia e sëmundjes, atëherë të përmbajturit nga ushqimi është ilaçi më efikas.⁸⁵ Një revistë e njohur publikoi lajmin se 300 persona janë shëruar nga sëmundja e sheqerit me anë të agjërimit.⁸⁶

Madje edhe jomuslimanët kanë zbuluar fuqinë e çuditshme të agjërimit. Këtë posaçërisht kanë mundur ta zbulojnë mjekët dhe ekspertët mjekësor. Ja disa vlerësime të tyre:

Dr. W. Spengler thotë: "...Muhamedi ka agjëruar dhe ka lutur Zotin në vetmi. Kush dëshiron të përgatitet për vepra të mëdha, duhet që të thellohet në lutje dhe në agjërim. Agjërimi është mjet për pastrimin e shpirtit dhe trupit, ndoshta ilaçi më me vlerë të cilin e njohim në natyrë. Agjërimi forcon mendjen dhe kryen ringjalljen shpirtërore dhe trupore të njeriut. Njerëzit të cilët lehtë trashen, janë me reumë, me sëmundje të barkut, zorrëve, veshkëve, me sëmundje të lëkurës dhe me sëmundje të tjera kronike, mund të shërohen me agjërim, atëherë kur të dështojnë të gjitha mjetet tjera."⁸⁷

Dr. O. Buchinger thotë: "...Ushqimet pa yndyrë dhe agjërimi vjetor janë forma efikase kundër infarktut të zemrës. Agjërimi përmirëson qarkullimin e gjakut dhe punën e organeve të tretjes, ndërsa kjo shëron sëmundjet e lëkurës, presionin e gjakut, arteriosklerozën dhe procesin e mplaqjes. Agjërimi vjetor përtërinë harmoninë shpirtërore dhe pamjen e jashtme të njeriut."⁸⁸

Posaçërisht është interesant konstatimi i dr. Riedleinit, i cili me një fjalë mrekullueshëm ka definuar aspektin shëndetësor të agjërimit. Ai thotë: "Agjërimi është operacion pa thikë!"⁸⁹

Prej këtu kuptohen fjalët plot urti të Muhamedit s.a.v.s. i cili në transmetimin e Ebu Hurejres r.a. propozon që të agjërohet për shkak të shëndetit: "*Agjëroni- do të jeni të shëndetshëm!*"⁹⁰

3. ASPEKTI SOCIAL:

Fshehtësitë shoqërore të agjërimit nxisin në përkujtimin e të uriturve dhe të rrezikuarve, pa fjalë të mëdha apo tekste të shumta, përkujtimin të cilin e bën agjëruesi me zërin e lukthit të tij dhe ushtimën e barkut të zbrazur. Ai i cili nuk ka përjetuar mundimet e të uriturit ose idhëtinë e të eturit, ai mendon se të gjithë njerëzit janë sikur ai. Prej këtu edhe nuk është çudi që All-llahu xh.sh. e ka bërë

⁸⁵ Për shumë aspekte të agjërimit si ilaç efikas, lexo: dr. Dželal Imamović: Zdravstveni aspekti islamskog posta, në Novi Horizonti, nr. 16; dhjetor 2000, fq. 16-17 dhe dr. Haris Husremović, Post je preventiva e liječenju brojnih bolesti, në Novi Horizonti, nr. 27; nëntor 2001, fq. 15-16.

⁸⁶ Shih: dr. Jusuf Kardavi, Ibadeti në Islam, fq. 257.

⁸⁷ Hasan Škapur, Buharijina zbirka hadisa, 3/166-167.

⁸⁸ Po aty, 3/167.

⁸⁹ Po aty.

⁹⁰ Taberaniu, Ibnu-s-Sunni dhe Ebu Nu'ajmi. Këtë transmetim shejh Albani e ka vlerësuar të dobët. (Shih: Da'ifu-l-Xhami'i-s-sagîr, hadithi nr. 3504, fq. 512).

agjërimin plotësisht të njëjtë si për pasanikun ashtu edhe për fukaranë.

Transmetohet se Jusufi a.s. ka agjëruar shumë, ndërsa në dorën e tij kishte depotë e ushqimit dhe pasuri të madhe, dhe kur është pyetur lidhur me këtë, ai ka thënë: *“Kam frikë se nëse ngopem, harroj urinë e fukarasë!”*⁹¹

LLOJET E AGJËRIMIT

Agjërimi mund të jetë farz, vaxhib, sunnet, mendub, nafile dhe mekruh, ndërsa sipas disave edhe haram.

Farz është agjërimi i Ramazanit *edaen* dhe *kadaen*, që domethënë se kur të agjërojmë në kohën e duhur dhe kur të plotësojmë, si dhe agjërimi i të gjitha keffareteve.

Vaxhib është agjërimi i betimit.

Sunnet është të agjëruarit i Jevmi Ashures, mirëpo së bashku me një ditë para.

Mendub është të agjërohen nga tri ditë të çdo muaji; të hënën dhe të enjten gjatë javës; gjashtë ditët e muajit Shevval dhe çdo e dyta ditë e vitit, i ashtuquajtur *agjërimi i Davudit a.s.*

Nafile është çdo agjërim i cili nuk është mekruh por i cili nuk është përmendur më herët.

Mekruh është agjërimi i Jevmi Shekk, domethënë i ditës së dyshimtë, e kjo është dita pas 29 të muajit Shaban (për të cilin me siguri nuk dihet a është dita e 30 e Shabanit ose dita e parë e Ramazanit). Është mekruh të agjërohet gjithashtu edhe dita e 10 e muajit Muharrem, pa ditën e nëntë dhe të njëmbëdhjetë. Disa këtë e quajnë *mekruhi-tenzihen*, që do të thotë se lënia e këtij akti është më mirë se praktikimi i tij.

Haram është agjërimi i ditës së parë të Bajramit të Ramazanit, katër ditët e Kurban Bajramit, agjërimi i tërë vitit pa ndërprerë dhe agjërimi vullnetar i gruas pa lejen e burrit të saj.⁹² Disa këtë e quajnë *mekruhi- tabrimen*, që domethënë se është e urrejtur dhe gjithsesi duhet t'i ikim . Përndryshe, kur juristët islam e përdorin termin *mekruh* atëherë nënkuptohet ky lloj.⁹³

Thelbësisht ekzistojnë dy lloje të agjërimit: agjërimi i obligueshëm në muajin e Ramazanit dhe agjërimi vullnetar, në të cilin bie çdo lloj, përveç agjërimit të Ramazanit.

⁹¹ Dr. Jusuf Kardavi, Ibadeti në Islam, fq. 259.

⁹² Më gjëresisht shih: Ibrahim El-Halebi, Multeka-l-ebhur, 1/196-197; El-Mevsili El-Hanefi, El-Ihtijar li ta'li-l-muhtar, 1/161-162; El-Mejdani, El-Lubab fi sherhi-l-kitab, 1/154-155; Ahmed Et-Tahtavi, Hashijetu- t-Tahtavi, 2/296-300; dr. Vehbe Ez-Zuhajli, El-Fikhu-l-islami ve edil-letuhu, 2/578; Muhammed Seid Serdarević, Fikhu-l-ibadat, fq. 89; Abdullah Zeqeviç, Fikh, fq. 71-72.

⁹³ Krahaso: Vehbi Sulejman Gavoxhi, Es-Sijamu ve ahkamuhu, fq. 36.

A). AGJËRIMI I RAMAZANIT

Ky lloj i agjërimit i është bërë obligim muslimanëve në vitin e dytë të Hixhretit. Kështu, Muhamedi s.a.v.s. ka agjëruar nëntë Ramazane. Imam Shafiu dhe disa dijetarë të tjerë mendojnë se agjërimi i Ramazanit është agjërimi i parë i obligueshëm për muslimanët. Mirëpo, Imam Ebu Hanife mendon se dita e 10 e muajit Muharrem është agjërimi i parë i obligueshëm i cili iu përcaktua muslimanëve, mirëpo ai është deroguar me urdhërin e agjërimit të Ramazanit.⁹⁴

Është e qartë se Ebu Hanifja këtë qëndrim e ka bazuar në transmetimin e Abdullah ibn Omerit r.a. i cili thotë: “Muhamedi s.a.v.s. ka agjëruar ditën e 10 të Muharremit dhe ka urdhëruar që ajo ditë të agjërohet. Kur erdhi urdhëri për agjërimin e Ramazanit, atëherë ky lloj i agjërimit (dita e 10 Muharrem) është lënë, kështu që Abdullahu më nuk e ka agjëruar, vetëm se kur ajo ka rastisur me agjërimin e zakonshëm.”⁹⁵

Në transmetimin e Aishes r.a. thuhet se dita e 10 e muajit Muharrem është praktikuar në kohën paraislame, dhe ashtu siç përmend Aisheja r.a., Muhamedi s.a.v.s. ka urdhëruar që edhe muslimanët të agjërojnë atë ditë, deri sa nuk është shpallur agjërimi i Ramazanit, kur Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “*Kush dëshiron le ta agjërojë edhe mëtej, e kush nuk dëshiron mos ta agjërojë (ditën e 10 të Muharremit)!.*”⁹⁶

Ramazani është muaj i veçantë. Ai është muaj i durimit ndërsa shpërblimi për të është Xhenneti. Kush i afrohet All-llahut të Lartësuar në këtë muaj me çfarë do bamirësie, do të llogaritet sikur ta kishte bërë obligimin e domosdoshëm në ndonjë muaj tjetër. Kush bënë ndonjë farz në të, do të llogaritet sikur t’i kishte kryer shtatëdhjetë farze në ndonjë muaj tjetër.

Ky është muaj fillimi i të cilit është mëshirë, mesi falje ndërsa fundi shpëtimi prej zjarrit. Kush ia lehtëson këtë muaj atij të cilin e ka nën kontroll, All-llahu i Mëshirshëm do t’ia falë mëkatet dhe do ta shpëtojë nga zjarri.⁹⁷

Ka shumë hadithe të cilët trajtojnë Ramazanin dhe agjërimin e tij. Pasi që kopshti i Muhamedit s.a.v.s. është përplot me trëndafilë të bukur, do të hyjmë në atë kopsht dhe do të mbledhin dyzet hadithe të cilët arrijnë shkallën e transmetimit sahih ose hasen. Pra, nuk do të përmenden ato hadithe të cilat sipas kritereve të ekspertëve më eminentë të hadithit janë vlerësuar si të dobët/*da’if*. Kjo me të madhe do të kontribuojë te lexuesit tanë, që pa kurrfarë dyshimi të lexojnë dhe praktikojnë ato hadithe në jetën e tyre të përditshme.

⁹⁴ Shih: Hasan Škapur, Buharijina zbirka hadisa, 3/91.

⁹⁵ Buhariu, Sahih: 30-Kitabu-s-savmi, 1-Babu vuxhubi savmi ramadane, hadithi nr. 1892.

⁹⁶ Po aty, nr. 1893.

⁹⁷ Shih për këtë elaborimin e gjërë të: mr. Muharem Štulanović, Ramazanski post, fq. 9-11.

B). AGJËRIMI VULLNETAR (NAFILE)

Agjërimi është faktor jashtëzakonisht me rëndësi në formimin e personalitetit islam. Me praktikimin e tij përplotësohet frikërespekti dhe forcohet kjo substancë subtile e besimtarit. All-llahu xh.sh. duke theksuar se agjërimin ua ka caktuar edhe popujve tjerë, shumë thukhtë udhëzon në faktin se nuk ka formim thelbësor të një personaliteti pa këtë institucion dhe përfundon se detyrë kryesore e këtij obligimi është arritja dhe kapja e besimit (frikërespektit). Ai thotë: *“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”*⁹⁸

Përndryshe, në fillim të islamit, siç thekson Ibn Kethiri, agjërimi ka zgjatur nga tri ditë për çdo muaj, pastaj që All-llahu të zëvendësojë me agjërimin e muajit të Ramazanit. Ibn Kethiri thekson transmetimin e Mu’adhit, Abdullah ibn Mes’udit, Abdullah ibn Abbasit, Katades dhe Dahhakut r.a., në të cilën thuhet se ai agjërim ka qenë aktual që prej kohës së Nuhit a.s. deri sa All-llahu xh.sh. nuk e ka deroguar me agjërimin e Ramazanit.⁹⁹

Pra, me shpalljen e agjërimit të Ramazanit si agjërim i obligueshëm, të gjitha agjërimet tjera, duke veçuar agjërimin e betimit, bëhen vullnetare dhe nuk bien në të obligueshme. Duke pasë parasysh se agjërimi ishte dhe mbeti faktor i pakrahasueshëm i pastrimit të shpirtit, shërimin e trupit dhe profilimin e drejtë të çdo personi, All-llahu xh.sh. ka lënë mundësinë e përgatitjes për këtë lloj të agjërimit. Ashtu sikurse sportistët që nuk mund të arrijnë rezultate të mira në ditën e përgatitjes, pa përgatitje të mëhershme, pa përforsim të kondicionit dhe kthimin e formës së duhur, kështu edhe para agjërimit të Ramazanit duhet të përgatitemi, me qëllim që në atë agjërim të arrijmë rezultate mjaft të mira, posaçërisht në aspektin e frikërespektit, të cilin All-llahu xh.sh. e ka përmend në Kur’an.

Duke analizuar jetën e Muhamedit s.a.v.s. pa dyshim vijmë deri në konstatimin se ai disa lloje të agjërimit i ka nxitur dhe i ka praktikuar, dhe në këtë mënyrë, neve na ka treguar se si duhet shpesh të përkujtohemi dhe të përgatitemi për muajin e obligueshëm të agjërimit në Ramazan.

Do të përmendim ato lloje të agjërimit të cilat Muhamedi s.a.v.s. i ka praktikuar, me qëllim që neve të na bëhen udhëtregues në jetë.

AGJËRIMI NË MUAJIN MUHARREM

Muaji Muharrem hynë në të ashtuquajturit muajt e *shenjtë* të kalendarit të Hixhretit, në të cilat, përveç tij hynë edhe muajtë Rexheb, Dhul Ka’de dhe Dhul Hixhxhe. Përveç kësaj, në këtë muaj (Muharrem) gjendet *jevmu ashura*, kështu që agjërimi në muajin Muharrem është më i mirë se agjërimi në çdo muaj tjetër, përveç Ramazanit.

⁹⁸ Kur’ani: Bekare, 183.

⁹⁹ Ibn Kethir, Tefsiru-l-Kur’ani-l-adhim, 1/290.

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “Agjërimi më i mirë pas Ramazanit, në muajin e All-llahut, Muharrem, ndërsa namazi më i mirë, pas atij të obligueshëm është namazi i natës!”¹⁰⁰

Ali ibn Ebi Talibi r.a. thotë se një njeri e kishte pyetur: “Cilin muaj ma preferon ta agjëroj pas muajit të Ramazanit?” Ai ishte përgjigjur: “Vetëm një njeri e kam dëgjuar duke e pyetur Muhamedin s.a.v.s. lidhur me këtë, deri sa isha te ai. E pyeti: “O i Dërguari i All-llahut, në cilin muaj pas muajit të Ramazanit, më preferon të agjëroj? Ai u përgjigj: “Nëse dëshiron të agjërosh pas Ramazanit, atëherë agjëro në Muharrem, sepse ai është muaji i All-llahut. Në atë muaj është dita në të cilin All-llahu u ka falë njerëzve dhe ditë në të cilin do të falë!”¹⁰¹

AGJËRIMI I DITËS SË DHJETË TË MUHARREMIT/ JEV MU ASHURA

Dihet se Muhamedi s.a.v.s. ka agjëruar ditën e *ashures* edhe para shpalljes së tij peygamber nga ana e All-llahut xh.sh., kështu duke e pasuar popullin e tij, sepse edhe ata këtë ditë e kanë agjëruar, ndërsa pas Hixhretit ka urdhëruar që të agjërohet ajo ditë, deri sa nuk i është caktuar Ramazani, kur iu dha mundësi të zgjedhin.¹⁰²

Imam Tirmidhiu thekson se shumë sahabë, në mesin e të cilëve Ali ibn Ebi Talibi, Muhammed ibn Sajfi, Seleme ibn El-Ekve, Abdullah ibn Abbas, Abdullah ibn Ez-Zubejri r.a. e të tjerë, kanë pohuar se Muhamedi s.a.v.s. ka nxitur në agjërimin e ditës së *ashures*.¹⁰³

Aisheja r.a. thotë: “Ashura ka qenë ditë të cilën kurejshët e kanë agjëruar gjatë xhahilijetit, por këtë ditë e ka agjëruar edhe Muhamedi s.a.v.s. Kur është shpërngulur në Medine ai ka vazhduar ta agjërojë dhe ka urdhëruar që edhe të tjerët ta agjërojnë. Kur u caktua Ramazani, atëherë agjërimi i Ramazanit u bë obligativ ndërsa agjërimi i ashures është lënë sipas dëshirës së njeriut, dhe kush ka dashur e ka agjëruar, e kush nuk ka dashur ta agjërojë, e ka lënë!”¹⁰⁴

Imam Tirmidhiu thotë se dijetarët islam veprojnë në bazë të transmetimit të Aishes r.a. dhe mendojnë se agjërimi i ditës së *ashures* nuk është i obligueshëm, mirëpo kush dëshiron mund ta agjërojë, për shkak të vlerës që janë përmendur për të.¹⁰⁵

Sa është vlera e agjëritit të kësaj dite, mjafton të përmendim transmetimin e Muslimit nga Ebu Katade El-Ensariu r.a. në të cilën thuhet se Muhamedi s.a.v.s.

¹⁰⁰ Muslimi, Sahih: 13-Kitabu-s-sijam, 38-Babu fadli savmi-l-muharrem, hadithi nr. 1163, Tirmidhiu, Nesaiu, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe.

¹⁰¹ Tirmidhiu, Sunen: 6-Kitabu-s-savmi, 40-Babu ma xhae fi savmi-l-muharrem, hadithi nr. 741 dhe e vlerëson si hasen-garib.

¹⁰² Shih për këtë: Mensur ‘Ali Nafis, Et-Taxhu-l-xhami’u li-l-usuli fi ahadithi-r-resuli, 2/89.

¹⁰³ Tirmidhiu, Sunen, 3/126, (botimi: Daru-l-kutubi-l-‘ilmije, Beirut, 1987).

¹⁰⁴ Tirmidhiu, Sunen: 6-Kitabu-s-savmi, 49-Babu ma xhae fi-r-ruhsati fi terki savmi jevmi ‘ashura, hadithi nr. 753 dhe e vlerëson si sahih.

¹⁰⁵ Tirmidhiu, Sunen, 3/127.

është pyetur për agjërimin e ditës së dhjetë të Muharremit, dhe është përgjigjur: “*Me këtë ditë All-llahu i Lartësuar fshinë vitin e kaluar (mëkatet)*!”¹⁰⁶

Shumica e dijetarëve islam mendojnë se ‘ashura është dita e dhjetë e muajit Muharrem. Ibn Abbasi mendon se ajo është dita e nëntë dhe se Muhamedi s.a.v.s. ka agjëruar vetëm ditën e nëntë, gjejësisht vetëm ditën e dhjetë të Muharremit. Muhamedi s.a.v.s. duke agjëruar ditën e dhjetë të Muharremit, dhe pasi që dëgjoi se çifutët agjërojnë këtë ditë, ka thënë se nëse jeton edhe vitin e ardhshëm, do të agjërojë edhe ditën e nëntë. Për këtë, Ibn Abbasi r.a. ka thënë: “*Agjëroni ditën e nëntë dhe të dhjetë, dhe kështu dallohuni prej çifutëve!*”¹⁰⁷

Disa agjërojnë ditën e nëntë, të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë të muajit Muharrem, që sipas ‘Ali Nasifit, është më e pranueshme dhe më e sigurtë.¹⁰⁸

AGJËRIMI I DITËS SË ARAFATIT

Vlera e këtij agjërimi është e veçantë, të cilën e vërteton Muhamedi s.a.v.s. në transmetimin e Ebu Katade El-Ensariut r.a. në të cilën thuhet: “*Ai shpague mēkatet e vitit të kaluar, dhe për vitin e ardhshëm.*”¹⁰⁹ Pra, për këtë agjërim është paraparë shpërblim më i madh se sa për agjërimin e ditës së *ashures*. Duhet theksuar se në ditën e Arafatit haxhinjtë nuk duhet të agjërojnë, por këtë e bëjnë ata të cilët atë vit nuk gjenden në Arafat.

AGJËRIMI I GJASHTË DITËVE TË SHEVVALIT

Ky agjërim vjen menjëherë pas Ramazanit. Pasi që All-llahu xh.sh. shpërblenë për çdo vepër të mirë dhjetëfish, kështu agjërimi për Ramazan arrinë gjithsejt dhjetë muaj ndërsa gjashtë ditët e Shevvalit- dy muaj, që është e barabartë me një vit të plotë. Kush i agjëron pandalë gjashtë ditët e Shevvalit pas Ramazanit, është sikur të kishte agjëruar tërë jetën.

Ebu Ejjub El-Ensariu r.a. transmeton nga Muhamedi s.a.v.s. se ka thënë: “Kush agjëron Ramazanin dhe pas tij gjashtë ditë të Shevvalit, sikur të ketë agjëruar tërë vitin!”¹¹⁰

Ibn El-Mubareku preferon agjërimin e këtyre ditëve që në fillim të muajit Shevval.

¹⁰⁶ Muslimi në Sahih: 13-Kitabu-s-sijam, 36-Babu istihbabi sijami thelatheti ejjamin min kul-li shehrin, ve savmi jevmi ‘arefe ve ‘ashura ve-l-ithnejni ve-l-hamisi, hadithi nr. 1162; Tirmidhiu në Sunen: 6-Kitabu-s-savmi, 48-Babu ma xhae fi-l-hassi ‘ala savmi jevmi ‘ashura, hadithi nr. 752 (mendohet në mëkatet e vogla për të cilat nuk ka nevojë pendimi me kushtet e tij).

¹⁰⁷ Tirmidhiu, Sunen, 6-Kitabu-s-savmi, 50-Babu ma xhae ‘ashura eju jevmin huve?, transmetimi nr. 755.

¹⁰⁸ Et-Taxh, 2/89.

¹⁰⁹ Muslimi, Sahih: 13-Kitabu-s-sijam, 36-Babu istihbabi sijami thelatheti ejjami..., hadithi nr. 1162.

¹¹⁰ Muslimi, Sahih: 13-Kitabu-s-sijam, 39-Babu istihbabi savmi ejjami min shevvalin ittiba’an liramadane, hadithi nr. 1164.

Mirëpo, ky agjërim është lejuar të agjërohet edhe në fund të muajit ose ndaraz.¹¹¹

AGJËRIMI I DITËS SË HËNË DHE TË ENJTE

Muhamedi s.a.v.s. ka agjëruar ditë të caktuara gjatë javës. Këtë më së shumti e ka bërë ditën e hënë dhe të enjte. Ka transmetime për agjërimin e ditës së mërkurë dhe të enjte, por edhe transmetime se një muaj agjëronte të shtunën, të dielën dhe të hënën ndërsa muajin tjetër, të martën, të mërkurën dhe të enjten ndërsa sipas disa transmetimeve edhe të premten. Kështu dijetari i njohur islam, Et-Tibi thekson se Muhamedi s.a.v.s. ka agjëruar të gjitha ditët e javës, me atë që nuk i ka agjëruar pandërprerë, por një muaj ka agjëruar disa ditë ndërsa muajin tjetër disa ditë tjera.¹¹²

Muhamedi s.a.v.s. sipas transmetimit të gruas së tij Aishes r.a., është përpjekur “*të agjërojë të hënën dhe të enjten.*”¹¹³

Pasi që veprat tona ngriten te All-llahu xh.sh. të hënën dhe të enjten, Muhamedi s.a.v.s. ka pasur dëshirë që të agjërojë këto ditë, duke thënë në një transmetim të cilët e përcjell Ebu Hurejre r.a.:

*“Veprat prezentohen të hënën dhe të enjten, për këtë dëshiroj që veprat e mia të prezentohen duke qenë agjërueshëm!”*¹¹⁴

Shumë ngjarje me rëndësi në historinë e islamit kanë ndodhur të hënën. Prej këtui, Muhamedi nënvizon në një transmetim të cilën e përcjell Ebu Katade r.a. kur është pyetur për agjërimin në këtë ditë: “*Në këtë ditë jam lindur, në këtë ditë jam bërë i dërguar dhe në të ka filluar të më vijë Shpallja!*”¹¹⁵

Muhamedi s.a.v.s. ka porositur në agjërimin e tre ditëve të çdo muaji. Ebu Hurejre r.a. thotë: “Shoku im më ka porositur tri gjëra: të agjëroj tri ditë të çdo muaji, të falë dy reqate duha namaz dhe të fal vitër namazin para se të bie të fle.”¹¹⁶

Këto ditë në të vërtetë janë dita e trembëdhjetë, katërmëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë të muajit të hixhretit, ashtu siç ka sqaruar Muhamedi s.a.v.s. Ebu Dherrit r.a.: “*Nëse agjëron në muaj nga tre ditë, atëherë agjëro ditën e trembëdhjetë, katërmëdhjetë dhe të ditën e pesëmbëdhjetë!*”¹¹⁷

¹¹¹ Shih: Tirmidhiu, Sunen, 3/132-133.

¹¹² Për këtë shih: Tirmidhiu, Sunen, 6- Kitabu-s-savmi, bab 41-45, hadithi nr. 742-748.

Gjithashtu: Tirmizijina zbirkat hadisa (në gjuhën boshnjake), 3/142.

¹¹³ Tirmidhiu, Sunen: 6-Kitabu-s-savmi, 44-Babu ma xhae fi savmi jevmi-l-ithnejni ve-l-hamisi, hadithi nr. 745 dhe e vlerëson si hasen-garib; Nesaiu, Sunen: 22-Kitabu-s-sijami, 70-Babu savmi-n-Nebijji, s.a.v.s. dhe Ibn Maxhe, Sunen: 7-Kitabu-s-sijami, 42-Babu sijami-l-ithnejni ve-l-hamisi, hadithi nr. 739.

¹¹⁴ Tirmidhiu, Sunen: 6-Kitabu-s-savmi, 44-Babu ma xhae fi savmi jevmi-l-ithnejni ve-l-hamisi, hadithi nr. 747 dhe e vlerëson si hasen garib.

¹¹⁵ Muslimi, Sahih: 13-Kitabu-s-sijami, 36-Babu istihbabi sijami thelathete ejjamin min kul-li shehrin, ve savmi jevmi ‘arefe ve ‘ashura ve-l-ithnejni ve-l-hamisi, hadithi nr. 1162.

¹¹⁶ Buhariu, Sahih: 30-Kitabu-s-savmi, 60-Babu sijami-l-bidi, hadithi nr. 1981.

¹¹⁷ Tirmidhiu, Sunen: 6-Kitabu-s-savmi, 54-Babu ma xhae fi savmi thelatheti ejjamin min kul-li shehrin, hadithi nr. 761 dhe e vlerëson si hasen; Nesaiu, Sunen: 22-Kitabu-s-sijami, 84-Babu dhikri-l-ihtilafi ‘ala Musa ibn Talha fi-l-haberi fi sijami thelatheti ejjamin mine-sh-shehri.

Sa është vlera e atyre ditëve të agjërimit më së miri e vërtetohet ky hadith. Ebu Dherri r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Kush agjëron tre ditë të çdo muaji, sikur të kishte agjëruar tërë vitin!”*¹¹⁸

Siç u theksua më herët, çdo ditë shpërblehet dhjetëfish, dhe duke agjëruar tre ditë, marrin shpërblimin për tridhjetë, që domethënë sikur të kishim agjëruar tërë muajin!

AGJËRIMI I DAVUDIT A.S.

Në shumë transmetime theksohet se agjërimi i Davudit a.s. është agjërimi më i mirë vullnetar. Muhamedi s.a.v.s. në insistimin e Abdullah Ibn Amr El Asit r.a. që t'i lejojë të agjërojë tërë vitin, ka thënë se së pari të agjërojë tre ditë të çdo muaji, e pastaj edhe më shumë, deri sa nuk erdhi te gjysma e kohës, me ç'rast Abdullahu r.a. ka kërkuar edhe më shumë, por Muhamedi s.a.v.s. i është përgjigjur: *“Nuk ka agjërim mbi agjërimin e Davudit a.s. e ajo është gjysma e kohës. Agjëro pra njëren ditë ndërsa të tjetrën mos e agjëro!”*¹¹⁹ Në një transmetim tjetër, të cilën e gjejmë te imam Buhariu, e të cilën gjithashtu e transmeton Abdullah Ibn Amr r.a. Muhamedi s.a.v.s. këtë agjërim e ka quajtur si më të vlefshëm. Në të vërtetë, me insistimin e Abdullahut r.a. që pandërprerë të agjërojë, Muhamedi s.a.v.s. i ka thënë: *“Një ditë agjëro, ndërsa një tjetër mos. Ky është agjërimi i Davudit a.s. dhe ky është agjërimi më i vlefshëm.”*¹²⁰

AGJËRIMI NË MUAJIN SHABAN

Muhamedi s.a.v.s. në asnjë muaj tjetër jashta Ramazanit, nuk ka agjëruar më shumë se në muajin Shaban. Kjo është shumë e qartë sepse mu ky muaj na çon në dyert e Ramazanit dhe ky është rasti më i mirë që të përgatitemi për agjërimin e obligueshëm.

Aisheja r.a. transmeton: “Muhamedi s.a.v.s. aq shumë agjëronte sa që ne mendonim se ai kurrë nuk do të ndërpriste, mirëpo aq shumë përmbahej nga agjërimi sa që ne mendonim se ai kurrë nuk do të agjërojë. Nuk kam vërejtur që ka agjëruar një muaj të tërë përveç Ramazanit. Më së shumti që ka agjëruar nga muajt tjerë ka qenë muaji Shaban.”¹²¹

Në disa transmetime tjera (Buhariu dhe Muslim) që kanë të bëjnë më Aishen r.a. shihet fleksibiliteti lidhur me këtë agjërim. Në një prej atyre transmetimeve thuhet: *“Në asnjë muaj nuk e kam parë që agjëron më shumë se sa në Shaban. Ka ditur të agjërojë edhe*

¹¹⁸ Tirmidhiu, Sunen: 6-Kitabu-s-savmi, 54-Babu ma xhae fi savmi thelatheti min kul-li shehrin, hadithi nr. 762 dhe e vlerëson si hasen-sahih; Ibn Maxhe, Sunen: 7-Kitabu-s-sijami, 29-Babu ma xhae fi sijami thelatheti ejjamin min kul-li shehrin, hadithi nr. 1708.

¹¹⁹ Buhariu, Sahih: 30-Kitabu-s-savmi, 59-Babu savmi Davude a.s., hadithi nr. 1980.

¹²⁰ Buhariu, Sahih: 30-Kitabu-s-savmi, 56- Babu savmi-d-dehri, hadithi nr. 1976.

¹²¹ Buhariu, Sahih: 30-Kitabu-s-savmi, 52-Babu savmi sha'bane, hadithi nr. 1969; Muslimi, Sahih: 13-Kitabu-s-sijam, 34-Babu sijami-n-Nebijji fi gajri ramadane, hadithi nr. 1156.

*tërë Shabanin. Ka ditur të agjërojë shumicën, ndërsa një pjesë nuk e agjëronte.”*¹²²

Pra me këtë transmetim të besueshëm u jepet e drejta edhe atyre të cilët agjërojnë tërë muajin Shaban, si dhe atyre të cilët agjërojnë një pjesë të këtij muaji ndërsa pjesën tjetër nuk e agjërojnë.

Duhet theksuar se njeriu i cili agjëron muajin Shaban duhet të ndërprejë një apo dy ditë para Ramazanit, me qëllim që të ndajë agjërimin vullnetar prej atij obligativ, ashtu siç e ka theksuar Muhamedi s.a.v.s. i cili në një transmetim të Ebu Hurejres r.a. thotë: *“Asnjëri prej jush të mos agjërojë një ose dy ditë para Ramazanit, vetëm nëse njeriu nuk agjëron agjërimin e tij të zakonshëm, atëherë ai le të agjërojë atë ditë.”*¹²³

Shpresojmë se do të përgatitemi si duhet për agjërimin e obligueshëm të muajit të Ramazanit, duke praktikuar ndonjë prej agjëtimeve vullnetare. Në këtë mënyrë do të përgatisim organizmin tonë për agjërimin e Ramazanit, por edhe të fitojmë shpërblime të mëdha dhe falje të mëkateve të cilat, në transmetimet e përmendura, na ka premtuar Muhamedi s.a.v.s.

KUSHTET E AGJËRIMIT

Nëse plotësohen këto kushte në vijim, atëherë muslimani është i obliguar të agjërojë:

1. Islami: Pra, për të agjëruar dikush, duhet para kësaj të pranojë islamin.
2. Mendja: Personi mendërisht jo i shëndoshë nuk do të ketë përgjegjësi për asnjë obligim fetar.
3. Pjekuria në moshë: Ky kusht më parë duhet të definohet si pjekuri dhe aftësi seksuale. Ibn Sirini thotë: “Fëmijën duhet ta urdhërojmë që të falë namaz prej se të dallojë dorën e djathtë nga e majta, ndërsa të agjërojë, kur të mund të agjërojë.” Hisham ibn Urve ka thënë: “Babai im i urdhëronte fëmijët për namaz pasi që filluan t’i njohin gjërat ndërsa agjërimin prej kur kanë mundur ta kryejnë.”¹²⁴
4. Shëndeti: Nëse personi është aq shumë i sëmurë saqë nuk mund të agjërojë, atëherë ky obligim nuk ka të bëjë me të. Kjo gjithashtu vlenë edhe për gruan shtatzënë dhe gjdhënësen nëse konstatohet se agjërimi i pengon atyre ose shëndetit të fëmijëve (nëse nuk agjërojnë, e kanë të obligueshme që ndonjëherë të kompensojnë e nganjëherë edhe fidje).
5. Dituria: Nëse themi për shembull, se dikush ka pranuar islamin dhe ka jetuar në një mjedis joislam, e me këtë rast askush nuk e ka informuar për këtë obligim (për agjërim), ky obligim nga ai person bie.¹²⁵

¹²² Buhariu, Sahih: 30-Kitabu-s-savmi, 52-Babu savmi sha’bane, hadithi nr. 1970; Muslimi, Sahih: 13-Kitabu-s-sijam, 34-Babu sijami-n-Nebijji fi gajri ramadane, hadithi nr. 1156.

¹²³ Buhariu, Sahih: 30-Kitabu-s-savmi, 14-Babu la jetekaddemu ramadanu bisavmi jevmin ve la jevmejni, hadithi nr. 1914; Muslimi, Sahih: 13-Kitabu-s-sijami, 3-Babu la tekaddimu ramadane bisavmi jevmin ve la jevmejni, hadithi nr. 1082.

¹²⁴ Vehbi Sulejman Gavoxhi, Es-Sijamu ve ahkamuhu, fq. 27.

¹²⁵ Shih për këtë: Esh-Shurunbulali, Meraki-l-felah, fq. 577-578 dhe Ahmed Et-Tahtavi, Hashijetu-t-Tahtavi ‘ala Meraki-l-felah, 2/292.

KUSH NUK ËSHTË I OBLIGUAR TË AGJËROJË

Nuk janë të obliguar të agjërojnë këto kategori të njerëzve:

1. Jomuslimani. Ai madje nuk është i obliguar të kompensojë ditët e kaluara në mosbesim (nëse e pranon islamin). Detyrë e tij është të agjërojë prej ditës së kalimit të tij në islam.
2. Fëmija deri sa nuk bëhet i pjekur në aspektin sheriatik. E vetmja gjë e cila porositet këtu është t'i bëhet shprehi agjërimi prej fëmijërisë, kështu që pasi që ai të bëhet i pjekur të mos ketë vështirësi në agjërim.
3. Personi mendërisht jo i shëndoshë. Kjo gjithashtu vlenë edhe për personin senil.
4. Personi i moshuar i cili nuk është në gjendje të mbajë agjërimin. Ai është i obliguar të japë fidje që domethënë për çdo ditë të ushqejë nga një të varfër.
5. Personi i sëmurë. I sëmuri do të kompensojë agjërimin pas shërimit. Nëse sëmundja është e përhershme ose e pashërueshme, atëherë do të ndajë fidje.
6. Shtatzëna dhe gjdhënësja. Ato do të kompensojnë ditët e lëshuara kur të kenë mundësi.
7. Gruaja e cila ka *hajzin*/ ciklin menstrual ose *nifasin*/ gjendjen pas lindjes. Ato gjithashtu do të agjërojnë ditët e lëshuara kur të kenë mundësi.
8. Udhëtari. Ai do të agjërojë ditën për ditë kur të kthehet në shtëpi.
9. Punëtorët në kushte shumë të rënda. Këtu mendohet në punëtorët të cilët punojnë aq punë të rënda fizike, të cilat nëse agjërojnë mund t'i dëmtojnë në shëndet. Ata do të kompensojnë ditët e humbura ditën për ditë kur të kanë mundësi. Në të kundërtën do të japin fidje.
10. Të burgosurit. Këtu mendohet në ata të burgosur të cilën bëjnë punë të rënda. Nëse bëhet fjalë për burg të përgjeshëm, në të cilin bëhen punë të rënda, do të ndahet fidja.
11. Personi i cili është i obliguar të prish. Këtu mendohet për personat të cilët shpëtojnë dikë nga zjarri, mbytja në ujë e të ngjashme. Nëse është e patjetërsueshme që të prish agjërimin, ai këtë do ta bëjë dhe atë ditë do ta kompensojë më vonë.¹²⁶

¹²⁶ Shih: Multeku-l-ebhur, 1/202-204; El-Ihtijar, 1/163-164; dr. Š. Ramić vep.cit. fq. 19-20 dhe mr. M. Štulanović, vep.cit. fq. 14-15.

ÇKA E PRISHË AGJËRIMIN

Janë shumë veprime që e prishin agjërimin. Ato ndahen në dy kategori:

1. Veprimet të cilat prishin agjërimin dhe për to është e mjaftueshme të agjërohet dita e prishur.
2. Veprimet të cilat prishin agjërimin, për të cilat nuk është e mjaftueshme të agjërohet vetëm dita e prishur, por është i obligueshëm edhe keffareti/ dënimi. Keffareti është dënimi e cila nënkupton lirimin e robit. Nëse për këtë njeriu nuk ka kushte, atëherë pandërprerë do të agjërojë 60 ditë, me kompensimin e patjetërsueshëm të asaj dite të pa agjëruar. Mirëpo, nëse këtë nuk mundet ta bëjë, atëherë mund të ushqejë 60 të varfër.

1. Veprimet të cilat prishin agjërimin dhe për të cilat mjafton të kompensohet dita e prishur: Nëse personi i cili agjëron kryen njërin prej këtyre veprimeve, është i obliguar të kompensojë:

- nëse hanë diçka ose pi në mënyrë të natyrshme nga ato gjëra të cilat nuk i hanë në jetën e përditshme, pa marrë parasysh se a është ushqim ose pije e cila i bënë mirë organizmit, apo i bënë dëm, siç janë p.sh.: kripa, mielli, pambuku, letra, dhe etj.
- Nëse i jipet injeksion ushqimor e cila kompenson ushqimin, sepse ky lloj i injeksioneve konsiderohen ushqim dhe pije,
- Nëse injekton në veshë vaj, ujë e të ngjashme,
- Nëse në fyt i depërton shiu, bora ose uji duke marrë abdest dhe ai e përbinë,
- Nëse prishë agjërimin, madje edhe pa vullnetin e tij, shembull burri detyron gruan e tij në marrëdhënie seksuale,
- Nëse ndërprejnë agjërimin, duke u frikësuar për veten ose për shëndetin e tij,
- Nëse hanë me qëllim, pasi që ka ngrënë diçka pa qëllim,
- Nëse nga harresa kryen marrëdhënie seksuale me gruan e tij,
- Nëse agjëruesi hanë, pinë ose kryen marrëdhënie seksuale duke menduar se ka hyrë koha e iftarit, ose ende nuk ka hyrë agimi, ndërsa ndodhë e kundërta,
- Nëse zgjohet si udhëtar e pastaj vendosë të qëndrojë në shtëpi dhe hanë,
- Nëse udhëton pasi që është zgjuar/ *mukim* te shtëpia dhe hanë,
- Nëse ka vendosur të ndërprejë agjërimin, duke mos ngrënë gjatë ditës ose duke mos bërë iftar, edhe pse ka vazhduar të agjërojë, qoftë edhe nëse nuk ka ngrënë ose pirë asgjë,
- Nëse bënë iftar duke menduar se ka hyrë koha e iftarit e pastaj e sheh se dielli ende nuk ka perënduar,

- Nëse i ndodhë polucioni gjatë agjërimit,
 - Nëse hanë diçka gjatë agjërimit nga ushqimi i mbetur në dhëmbë,
 - Nëse gjatë agjërimit vjell qëllimisht.¹²⁷
2. Veprimet të cilat prishin agjërimin dhe për kompensimin e ditëve të pa agjëruara pason patjetër keffareti

Duhet theksuar se qëndrimi i medh'hebit hanefij është që çdo prishje e qëllimshme e agjërimit, qoftë me marrëdhënie seksuale, ushqim, pije ose në mënyra tjera, pas vetes bart kompensimin e patjetërsueshëm, me dënim keffareti.¹²⁸

ÇKA NUK E PRISHË AGJËRIMIN?

Agjërimin nuk e prishin veprimet në vijim:

- Larja dhe freskimi, vetem duhet të kihet kujdes që uji të mos shkojë në fyt dhe të gëlltëtet.
- Larja e gojës dhe hundës, si dhe larja e dhëmbëve me furçë ose misvak. Ebu Hanife tërheq vërejtjen se agjëruesi i cili lanë gojën dhe hundën mundet t'i prishet agjërimi nëse edhe pa dashjen e tij uji i shkon nëpër fyt. Për këtë duhet të kihet kujdes me rastin e larjes së trupit, larjes së gojës dhe hundës si dhe larjes së dhëmbëve.
- Lëshimi i gjakut. Gjithashtu kjo ka të bëjë edhe me dhënien e gjakut për analiza laboratorike e të ngjashme.
- Pranimi i injeksioneve, pa marrë parasysh se a jepen nën lëkurë ose në venë, sepse nuk hynë në brendinë e agjëruesit në mënyrë të natyrshme.
- Nxjerrja e dhëmbit, por duhet të kihet kujdes që gjaku apo diçka tjetër të mos shkojë në fyt. Gjithashtu, pranimi i injeksionit me rastin e nxjerrjes së dhëmbit nuk e prishë agjërimin, sepse injeksioni nuk është ushqyese dhe nuk ka depërtuar në organizëm në mënyrë natyrore sikurse ushqimi dhe pija.
- Puthja, mirëpo me kusht që mos të shkaktojë ejakulimin ose marrëdhëniet seksuale. Në shkollën juridike hanefite puthja është mekruh vetëm nëse nxitë epshin, mirëpo më e preferuar është që gjatë agjërimit t'i ikim kësaj. Ngjashëm është edhe me preken dhe për- qafimin.
- Vendosja e surmes dhe përdorimi i pikave për sy, veshë e të ngjashme, madje edhe nëse agjëruesi e shijon shijen në fyt, sepse këtë mënyrë nuk e bënë sikurse

¹²⁷ Krahaso: Esh-Shurunbulali, Meraki-l-felah, fq. 616-623, Et-Tahtavi, Hashijetu-t- Tahtavi, 2/337-344; dr. Šukri Ramić, Šerijatski propisi u yezi sa ramazanom i ramazanskim postom, në Novi Horizonti, nr. 4, dhjetor, 1999, fq. 20 dhe Muharem Štulanović, Ramazanski post, fq. 21-22.

¹²⁸ Më gjërësisht shih: El-Merginani, El-Hidaje, 1/120-122; El-Mevsili, El-Ihtijar, 1/169-171; El-Mejdani, El-Lubab, 1/157-158; Es-Sagirxhi, El-Fikhu-l-hanefi ve edul-letuhu, 1/368-370.

me marrjen natyrore të ushqimit.

- Xhunubllëku. Është e lejuar që agjëruesi të agjërojë pasi është ngritur xhunub dhe të lahet (pastrohet) pas paraqitjes së agimit.
- Nëse gruas i ndërpritet hajzi dhe nifasi, ajo do të agjërojë qoftë edhe nëse nuk arrijnë që të lahet para agimit sepse kjo nuk do t'ia anulojë agjërimin.
- Përdorimi i inhalatorëve, sprejeve për lehtësimin e frymëmarrjes të sëmurëve nga astma.¹²⁹

DYZET HADITHE PËR RAMAZANIN DHE AGJËRIMIN

Ka shumë hadithe të cilët trajtojnë muajin e Ramazanit dhe agjërimin e tij. Në këtë tekst do të prezentohen vetëm ato hadithe të cilët arrijnë shkallën e sahih ose hasen. Pra, nuk do të përmenden hadithet të cilat sipas kritereve të ekspertëve të hadithit, janë vlerësuar si daif/ të dobët. Kjo me të madhe do të kontribuojë që lexuesit tanë pa kurrasfë dyshimi të lexojnë dhe praktikojnë ato hadithe në jetën e tyre të përditshme.

1. Ebu Hurejre r.a. transmeton nga Muhamedi s.a.v.s. se ka thënë: *“Kush agjëron Ramazanin, duke besuar dhe shpresuar në shpërblim, do t'i falen mëkatet”*¹³⁰ të cilat i ka bërë më herët!”¹³¹

2. Ebu Hurejre r.a. gjithashtu transmeton nga Muhamedi s.a.v.s.: *“Kur të vijë Ramazani, hapen dyert e Xhennetit, mbyllen dyert e Xhebennemit ndërsa shejtanët lidhen!”*¹³² Duke komentuar këtë hadith, Kadi Ijadi tregon se këtu bëhet fjalë për një lloj të marrëdhënies së vetëdijshme të besimtarit ndaj veprave të tij, kështu që në këtë muaj bëjnë vepra të mira, që automatikisht kontribuojnë në zvogëlimin e së keqes, ndërsa me zvogëlimin e dëshirave, pasioneve dhe epsheve të ndryshme, shejtanit i pamundësohet afrimi, dhe në këtë mënyrë ata duken të lidhur!¹³³

3. Ebu Se'id El-Hudriu r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“All-llahu për shtatëdhjetë vjet do të largojë zjarrin nga personi i cili agjëron një ditë në rrugë të All-llabut!”*¹³⁴

4. Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“All-llahu i Lartësuar ka thënë: “Çdo vepër e njeriut i takon atij, përveç agjërimit! Ai më takon Mua dhe Unë posaçërisht për të shpërblej.”*¹³⁵

¹²⁹ Shih: El-Hidaje, 1/120-121; Meraki-l-felah, fq. 626-628; El-Lubab, 1/156-157; Hashijetu-t-Tahtavi, 2/349- 352; Muhammed Mahmud es-Savvaf, Es-Sijamu fi-l-islam, fq. 118-121; El-Fikru-l-hanefi ve edil-letuhu, 1/371-373; dr. Šukri Ramić, vep. cit. fq. 21 dhe mr. Muharem Štulanović, vep.cit. fq. 19-20.

¹³⁰ Mendohet në mëkatet e vogla. Për mëkatet e mëdha duhet tevbeja (pendimi).

¹³¹ Buhariu dhe Muslimi.

¹³² Buhariu dhe Muslimi.

¹³³ Shih: Ibn Haxheri, Fet'hu-l-bari, 4/137.

¹³⁴ Buhariu dhe Muslimi, version të njëjtë përmendin edhe Tirmidhiu, Taberaniu dhe Ebu Hazm El-Hanbeli.

¹³⁵ Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu.

5. Ebu Hurejre r.a. gjithashtu transmeton nga Muhamedi s.a.v.s.: “*Agjërimi është mburojë, dhe kur ndonjëri prej jush agjëron mos të thotë fjalë të turpshme dhe të mos bërtasë, e kur dikush e shanë ose e sulmon, le t’i thotë: Unë agjëroj!*”¹³⁶

6. Ai gjithashtu thotë se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “*Pasha Atë në duart e të cilit është shpirti i Muhammedit, era e gojës së agjëruarit të All-llahu është më e mirë se aroma (era) e miskut!*”¹³⁷

7. Ai gjithashtu transmeton nga Muhamedi s.a.v.s. hadithin në vijim: “*Agjëruesi ka dy gëzime: gjatë iftarit dhe gjatë takimit të tij me Zotin e vet!*”¹³⁸

8. Gjithashtu ai transmeton edhe këtë hadith: “*Çdo vepër e njeriut shpërblehet shumëfish. Vepër e mirë shpërblehet prej dhjetë deri në shtatëqind herë, përveç agjërit, sepse All-llahu i Lartësuar ka thënë: “Ai (agjërimi) është i Imi dhe Unë për të shpërblej. Ai i lë epshet dhe ushqimin për Mua!”*”¹³⁹

9. Selh ibn Sa’d r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “*Në Xhennet është një derë e cila quhet Rejan. Nëpër ato dyer, përveç agjëruarit, nuk do të hyjë askush tjetër! Do të pyesin: Ku janë agjëruarit?! Ata do të ngriten dhe askush përveç tyre, askush përveç tyre nuk do të hyjë! Kur ata të hyjnë, dyert do të mbyllen dhe nëpër to askush nuk do të hyjë më!*”¹⁴⁰

10. Talha ibn Ubejdullahu r.a. transmeton se Muhamedit s.a.v.s. i ka ardhur një beduin dhe mes tjerash, ai e ka pyetur: “*Më lajmëro me atë që më ka obliguar All-llahu nga agjërimi?! Ai është përgjigjur: “Muaji Ramazanit, përveç nëse ti dëshiron diçka vullnetare!”*”¹⁴¹

11. Hudhejfe ibn El Jemani r.a. transmeton se e ka dëgjuar Muhamedin s.a.v.s. se si thotë: “*Pengesat për njeriun mund të jetë në shtëpinë e tij, në pasurinë dhe te fqiu i tij, ndërsa këtë e largon falja e namazit, agjërimi dhe ndarja e zekatit!*”¹⁴²

12. Ebu Hurejre r.a. transmeton nga Muhamedi s.a.v.s. se ka thënë: “*Agjëroni kur të shihni hënën e re dhe ndërpreni atë kur ta shihni atë! Nëse ajo është e mbuluar me vranësira, atëherë përplotësoni Shabanin me ditën e tridhjetë!*”¹⁴³

13. Abdullah ibn Omeri r.a. transmeton nga Muhamedi s.a.v.s.: “*Mos agjëroni një ditë apo dy ditë para Ramazanit, përveç nëse dikush veçmë agjëron ndonjë agjërim, atëherë le ta kryejë!*”¹⁴⁴ Këtu siç pohojnë dijetarët islam, mendohet se nuk agjërohet një apo dy ditë para Ramazanit dhe kështu të presë këtë muaj. Me këtë dëshirohet të ndahet nafilja nga agjërimi farz!¹⁴⁵

¹³⁶ Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu

¹³⁷ Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu

¹³⁸ Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu

¹³⁹ Muslimi. Version i njëjtë gjendet edhe te Buhariu.

¹⁴⁰ Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Nesaiu

¹⁴¹ Buhariu.

¹⁴² Buhariu.

¹⁴³ Buhariu.

¹⁴⁴ Buhariu.

¹⁴⁵ Shih për këtë: Fet’hu-l-bari, 4/153.

14. Ebu Hurejre r.a. transmeton nga Muhamedi s.a.v.s. se ka thënë: *“Mos agjëroni kur të vijë pjesa e dytë e muajit Shaban.”*¹⁴⁶ Disa dijetarë islam mendojnë se kjo është porosia e Muhamedit

s.a.v.s. me qëllim që besimtari të jetë më i fortë dhe më i përgatitur të presë Ramazanin.¹⁴⁷

15. Abdullah ibn Amr El-Asi r.a. transmeton nga Muhamedi s.a.v.s.: *“Në agjërim është shkatërrimi i epsheve të ummetit tim.”*¹⁴⁸

16. Abdullah ibn Mes’udi r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Kush ka mundësi për martesë, le të martohet, sepse kjo ndikon më mirë në uljen e shikimit dhe më së sigurti mbronë organin gjenital, ndërsa ai i cili nuk ka mundësi të martohet, le të agjërojë, sepse agjërimi është mbrojtje!”*¹⁴⁹

17. Thevbani r.a. transmeton nga Muhamedi s.a.v.s. se ka thënë: *“Agjërimi i muajit të Ramazanit i përgjigjet agjërimit të dhjetë muajve, ndërsa agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit pas tij, i përgjigjet agjërimit të dy muajve, dhe kjo tregon agjërimin e tërë vitit!”*¹⁵⁰

18. Ebu Ejjub r.a. transmeton nga Muhamedi s.a.v.s. një hadith të njëjtë: *“Kush agjëron Ramazanin e pastaj atë e përyjell me gjashtë ditë të Shevalit, sikur me pasë agjëruar tërë kohën!”*¹⁵¹

19. Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Kush nuk i len gënjeshtat dhe veprimet sipas tyre, All-llabut nuk i dubet që ai njeri të lë ushqimin dhe pijen e tij!”*¹⁵²

20. Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Pesë kohët e namazit, xhumaja në xhuma dhe Ramazani në Ramazan, fshijnë mëkatet, nëse ndërmjet tyre nuk bëhen mëkate të mëdha!”*¹⁵³

21. Abdullah ibn Abbasi r.a. ka thënë: *“I Dërguari i All-llabut s.a.v.s. ishte njeriu më dorëdhënës në mesin e njerëzve, ndërsa më dorëdhënës ka qenë në Ramazan, kur Xhibrili është takuar me të. Xhibrili është takuar me të çdo natë gjatë Ramazanit kur bashkë me të ka lexuar Kur’anin. Muhamedi s.a.v.s. kur takohet me të, ishte më dorëdhënës se era e cila sjell shiun e plleshëm!”*¹⁵⁴

22. Enes ibn Maliku r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Ngrituni në syfy,*

¹⁴⁶ Tirmidhiu, dhe e vlerëson si hasen-sahih; Ebu Davudi me sened autentik dhe Ibn Hibbani i cili e vlerëson të besueshëm.

¹⁴⁷ Shih: Fet’hu-l-bari, 4/153.

¹⁴⁸ Ahmedi, Ibn Adijji dhe El-Begavi në veprën Sherhu-s-sunne, hadithi është autentik.

¹⁴⁹ Buhariu.

¹⁵⁰ Nesaiu, Ahmedi dhe Ibn Hibbani. Transmetim i njëjtë gjendet edhe te Ibn Maxhe, Ibn Huzejme, Darimiu, Tahaviu dhe Ibn Asakiri. Hadithi është vlerësuar si sahih.

¹⁵¹ Muslimi, Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe.

¹⁵² Buhariu, Tirmidhiu dhe Ebu Davudi.

¹⁵³ Muslimi

¹⁵⁴ Buhariu dhe Muslimi.

*sepse me të vërtetë në të është bereqeti!”*¹⁵⁵

23. Prej Amr ibn El-Asit r.a. transmetohet se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Dallimi mes agjërimit tonë dhe agjërimit të çifutëve dhe të krishterëve është ngritja në syfyr.”*¹⁵⁶

24. Nga Sehl ibn Sa’di r.a. transmetohet se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Njerëzit do të jenë në të mirë derisa të nguten me iftarin!”*¹⁵⁷

25. Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“All-llahu i Lartësuar ka thënë: robërit e Mi më të dashur janë ata të cilët më së shumti nguten me iftarin!”*¹⁵⁸

26. Prej Selman ibn Amir Ed-Dabbijut r.a. transmetohet se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Kur ndonjëri prej jush bënë iftar, le të bëjë iftar me hurma, e nëse nuk i ka, atëherë le të bëjë iftar me ujë, sepse ajo është e pastër!”*¹⁵⁹

27. Enes b. Maliku r.a. thotë: *“I Dërguari i All-llabut bënte iftar me hurma të njoma para se të falej. Nëse nuk gjente hurma të njoma, bënte iftar me hurme të thata. Nëse nuk gjente as hurme të thata, bënte iftar me një gllënjë ujë.”*¹⁶⁰

28. Prej Ebu Hurejre r.a. transmetohet se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Kur ndonjëri prej jush harron dhe hanë diçka, ose pinë, le të përfundojë agjërimitin e tij, sepse All-llahu e ka ushqyer dhe i ka shuar etjen.”*¹⁶¹

29. Aisheja r.a. thotë: *“Muhamedin s.a.v.s. e gjente agimi, e ai pas marrëdhënieve me gratë e tij ishte xhunub, e pastaj atëherë lahej dhe agjëronte!”*¹⁶²

30. Zejd ibn Halid El-Xhuheni r.a. transmeton nga Muhamedi s.a.v.s. se ka thënë: *“Kush ia përgatitë iftarin agjëruesit, do të ketë shpërblim sikurse ai, ndërsa agjëruesit sevabet e tij nuk i pakësoben!”*¹⁶³

31. Enes ibn Maliku r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka ardhur te Sa’d ibn Ubade r.a., i cili i shtroi bukë dhe vaj ulliri, të cilat Muhamedi s.a.v.s. i ngrëni e pas kësaj, e tha duanë: *“Le të bëjnë iftar tek ju agjëruesit, le ta hajjnë ushqimin tuaj njerëzit besimtarë dhe le të bëjnë për ju istigfar melaiket!”*¹⁶⁴

32. Prej Aishes r.a. transmetohet se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Kush ka vdekur*

¹⁵⁵ Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Nesaiu.

¹⁵⁶ Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu

¹⁵⁷ Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Maliku.

¹⁵⁸ Tirmidhiu, dhe thotë: Hadithi është hasen; Ibn Hibbani, dhe e vlerëson si sahih.

¹⁵⁹ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu dhe thonë: Hadithi është hasen-sahih dhe Ibn Maxhe, senedi i të cilit është sahih.

¹⁶⁰ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu senedi i të cilit është vlerësuar si i mirë/hasen.

¹⁶¹ Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Ebu Davudi.

¹⁶² Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi dhe Maliki.

¹⁶³ Tirmidhiu dhe thotë: Hadithi është hasen-sahih; Ibn Maxhe, Ahmedi, senedi i të cilit është autentik dhe Ibn Hibbani, i cili e konsideron autentik.

¹⁶⁴ Ebu Davudi me zinxhirin autentik të transmetuesve. Gjithashtu përmend edhe Ibn Hibbani prej Abdullah ibn Zubejrit r.a. dhe e konsideron autentik.

*ndërsa borxh i ka mbetur agjërimi, le ta agjërojë për të faresti më i afërt i tij.”*¹⁶⁵

33. Abdullah ibn Abbasi r.a. ka thënë: *“Erdhi te Muhamedi s.a.v.s. një njeri dhe e pyeti: “O i Dërguari i All-llabut, nëna ime ka vdekur ndërsa ka mbetur borxh një muaj agjërim. A mundem unë për të ta kompensoj?!” Po- i tha ai- sepse përparësi është që të kryhet borxhi ndaj All-llabut”*¹⁶⁶

34. Nga ai gjithashtu transmetohet se një grua erdhi te Muhamedi s.a.v.s. dhe ia përmendi se motra e saj ka mbetur borxh të agjërojë një muaj, sepse duke udhëtuar nëpër det, ka vdekur dhe nuk e ka kryer këtë borxh. Muhamedi s.a.v.s. i tha: *“Agjëro për motrën tënde!”*¹⁶⁷

35. Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Kush e kalon Lejletu-l-kadrin në ibadet, duke besuar dhe shpresuar në shpërblim, do t’i falen mëkatet e kaluara!”*¹⁶⁸

36. Prej Aishes r.a. transmetohet se Muhamedi s.a.v.s. ka porositur: *“Kërkoni Lejletu-l-kadrin në netët tek të dhjetë ditëve të Ramazanit!”*¹⁶⁹

37. Aisheja r.a. thotë: *“E kam pyetur të Dërguarin e All-llabut s.a.v.s.: “O i Dërguari i All-llabut, çka mendon, sikur të kisha ditur se në cilën natë gjendet Lejletu-l-Kadri, çka të lexoj (them) në të?!” Ai u përgjigj: “Thuaj: All-llahumme inneke ‘afuvrun, tubibbu-l-‘afve, fa’ fu ‘anni/ All-llahu im, Ti je Ai i cili falë, Ti e do faljen, pra më fal mua!”*¹⁷⁰

38. Prej Aishes r.a. transmetohet se ka thënë: *“Kur vinte pjesa e tretë e fundit e Ramazanit, i Dërguari i All-llabut s.a.v.s. kalonte natën në ibadet, zgjonte familjen e tij dhe mendohej që ibadeti të jetë sa më i mirë!”*¹⁷¹

39. Abdullah ibn Omeri r.a. ka thënë: *“I Dërguari i All-llabut s.a.v.s. ka qëndruar në i’tikaf dhjetë ditët e fundit të Ramazanit!”*¹⁷²

40. Ebu Hurejre r.a. transmetohet se një beduin ka ardhur te Muhamedi s.a.v.s. dhe e ka pyetur: *“O i Dërguari i All-llabut, më udhëzo në vepër me të cilën nëse e bëj, do të hyj në Xhennet! Ai iu përgjigj: “Të adhurosh All-llahun, duke mos i përshkruar shok, të kryesh namazin, të japësh zekatin dhe të agjërosh Ramazanin.” Atëherë beduini tha: “Pasha Atë në duart e të cilit është shpirti im, unë kësaj nuk do t’i shtoj asgjë.” Kur ai u largua, Muhamedi s.a.v.s. tha: “Kush do të shoh në njërin prej banorëve të Xhennetit, atëherë le të shikojë këtë!!!”*¹⁷³

¹⁶⁵ Buhariu.

¹⁶⁶ Buhariu.

¹⁶⁷ Ahmedi dhe Tajalisi në Musned. Hadithi është vlerësuar si sahih. Ekzistojnë versione të ngjashme edhe te Buhariu edhe atë Mual-lek- transmetime, pastaj edhe te Muslimi, Nesaiu dhe te Tirmidhiu.

¹⁶⁸ Buhariu dhe Muslimi (mendohet në mëkatet e vogla).

¹⁶⁹ Buhariu dhe Muslimi.

¹⁷⁰ Tirmidhiu dhe e vlerëson si hasen-sahih.

¹⁷¹ Buhariu dhe Muslimi.

¹⁷² Buhariu dhe Muslimi.

¹⁷³ Buhariu dhe Muslimi.

SADAKATU-L-FITRI

Sadakatu-l-fitri ose zekatu-l-fitr apo siç quhet tene shkurt vitra, me zekat në pasuri, paraqet program ideal social në tokë. Me praktikimin e këtyre rregullave me të madhe neutralizohet dallimi mes të pasurve dhe të varfërve dhe në mënyrë efikase forcohen lidhjet vëllazërore mes muslimanëve. Duke falënderuar këtë institucion, si dhe institucionin e zekatit, është siguruar jeta e miliona njerëzve ma kulm mbi kokë në botë, ndërsa shumë fëmijëve u është mundësuar jeta normale dhe shkollimi i lumtur.

Prej këtui, në shoqërinë islame nuk ka vend për kapitalizmin ekstrem. Ai nuk është i mundshëm duke iu falënderuar sadakatu-l-fitrit, ashtu siç thotë shehidi Mustafa Busulaxhiq, pastaj zekatit dhe ndalimit të kamatës. Busulaxhiqi në mënyrë të mrekullueshme thekson: *“Që të vlerësohet roli dhe aftësia jetësore e këtij sistemi, nevojitet të shpalosim historinë islame. Deri sa zekati (dhe zekatu-l-fitri, si manifestim i saj- shën. i autorit) dhe urdhërimi për ndalimin e kamatës ishin në praktikë, vendet islame kanë lulëzuar, muslimanët kanë bartur triumfin e fitores dhe të namit, ndërsa islami ku është zgjeruar, ka shprehur mbretërinë e kënaqësive, dashurisë dhe drejtësisë sociale. Dhe jo vetëm kjo! Revolucionet sociale, levizjet komuniste dhe nihiliste për botën islame ishin krejtësisht të panjohura. Luftërat qytetare dhe rebelimet në vendet muslimane kanë qenë të natyrës politike, e jo kurrë si pasojë e mjerimit social dhe të varfërisë.”*¹⁷⁴

Shihet qartë se urtësia e sadakatu-l-fitrit qëndron mu në këtë. Këtë më së miri e ilustron transmetimi i Abdullah ibn Abbasit r.a. i cili thotë: *“I Dërguari i All-llabut s.a.v.s., ka urdhëruar agjëruesin sadakatu-l-fitrin si mekanizëm për pastrimin e të folurit të panevojshëm dhe të paturpshëm, dhe si ushqim për të vafërërit.”*¹⁷⁵

Në bazë të hadithi të përmendur pa dyshim trajtohen dy komponente:

1. Trajtohet agjëruesi gjatë Ramazanit dhe pastrimi i agjërimit të tij nga të folurit të panevojshëm dhe të paturpshëm, sepse është obligim të ruhet gjuha dhe organet tjera, ashtu siç ruhen barku dhe organi gjenital. Pa marrë parasysh në atë se sa njeriu e ruan gjuhën e tij nga të folurit e keq, syrin e tij nga të shikuarit në të ndaluarën dhe veshin nga të dëgjuarit të keq, është e pamundshme tërë këtë të ruajmë, kështu që ndarja e sadakatu-l- fitrit paraqitet si detergjent i vërtetë për pastrimin e të gjitha njollave të bëra gjatë Ramazanit. Me ndarjen e sadakatu-l-fitrit neutralizohen llojet e përmendura të mangësive, ashtu sikurse sehvi sexhdeja që neutralizon disa mangësi me rastin e kryerjes së namazit. Këtë shumë mirë e ka krahasuar dijetari i madh islam Veki’ ibn El-Xherrahu, kur ka thënë: *“Sadekatul fitri në Ramazan është ngjashëm sikur sehvi sexhdeja në namaz. Ai kompenson mangësitë në agjërime, sikur që sehvi sexhdeja*

¹⁷⁴ Mustafa Busuladžić, Muslimani u Evropi, fq. 42.

¹⁷⁵ Ebu Davudi, Sunen: Kitabu-z-zekat, 17- Babu zekati-l-fitri, hadithi nr. 1609; Ibn Maxhe, Sunen: 8- Kitabu-z-zekat, 21-Babu sadekati-l-fitri, hadithi nr. 1827; Ed-Darekutni në Sunen: Kitabu-z-zekat-l-fitri, hadithi nr. 1 dhe thotë se në sened nuk ka transmetues të dobët, dhe Hakimi në Mustedrek, 1/409 dhe thotë: Hadithi është autentik sipas kushteve të Buhariut dhe lidhur me këtë pajtohet edhe hafidh Dhehebiu.

*kompenson lëshimet në namaz.”*¹⁷⁶

2. Trajtohet shoqëria dhe përhapja e dashurisë e solidaritetit në shoqëri. Veçanërisht trajtohen të varfërit në shoqëri dhe ata të cilët patjetër duhet ndihmuar. Bajrami i cili vjen pas Ramazanit duhet të jetë ditë e gëzimit dhe haresë për të gjithë, e jo vetëm për të pasurit dhe për ata të cilët kanë. Ky është rast për gëzimin e tërë bashkësisë. Madje, në ditën e Bajramit të varfërit të mos kenë brenga për furnizimin e tyre dhe lirisht të çlirohen dhe të gëzohen në kënaqësitë dhe gëzimet e Bajramit. Abdullah ibn Omeri r.a. transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka urdhëruar ndarjen e sadakatul fitrit, duke thënë: *“Furnizoni të varfërit në ditën e Bajramit!”*¹⁷⁷

SI DUHET TË JEPET SADEKATU-L-FITRI

Sadakatul fitri i cili është përcaktuar në vitin e 2 të hixhrit, të njëjtin vit kur është përcaktuar edhe agjërimi i Ramazanit, sipas shkollës juridike hanefite llogaritet vaxhib, në pajtim me ndarjen në farz dhe vaxhib.¹⁷⁸ Ata qëndrimin e tyre e bazojnë në një transmetim të besueshëm të Abdullah ibn Omerit r.a. në të cilin thuhet se: *“I Dërguari i All-llabut s.a.v.s. ka urdhëruar dhënien e sadakatul fitrit çdo muslimanit të lirë dhe rob, mashkull dhe femër, të madhit e të voglit, në vlerë prej një sa’a burme ose sa’a elb.”*¹⁷⁹

Mirëpo, tre imamët tjerë sipas fjalëve më lart të cituara *fereda/ka urdhëruar*, mendojnë se dhënia (ndarja) e sadakatul fitrit është farz. Dr. Jusuf Kardavi pohon se nuk ka dallim në definimin e rregullave në rastin e të katër imamëve, sepse qëndrimi i Ebu Hanifes dallohet vetëm në aspektin terminologjik nga qëndrimi i imamëve tjerë, pra për të është vaxhib ajo e cila për të tjerët është farz.¹⁸⁰

Disa mendojnë se kjo detyrë është sunneti muekkede, sikurse malikijtë, të cilët këtë e transmetojnë nga Eshhebi,¹⁸¹ dhe deri te ata të cilët mendojnë se përcaktimi i zekatit dhe sadakatul fitrit është deroguar dhe është bërë mustehab.¹⁸²

KUSH JEP DHE PËR KË JEPET SADAKATUL FITRI?

Për çdo musliman të pasur, i cili përmbi nevojat e familjes së tij mbërrinë një sa’a (dy grushta- aq sa zënë dy grushta bashk) ushqim për një ditë dhe natë, duhet të japë sadakanë e Bajramit ose sadakanë për përfundimin e agjërimit, të quajtur sadakatu-l-fitr. Njeriu do të japë për vete dhe për fëmijët e tij të vegjël. Nëse fëmijët kanë pasuri

¹⁷⁶ Dr. Jusuf Kardavi, Fikhu-z-zekat, 2/922.

¹⁷⁷ Darekutni, Sunen: Kitabu sadekati-l-fitri, hadithi nr. 67.

¹⁷⁸ Neveviu: El-Minhaxh, sherh Muslim ibn El-Haxhaxhi, 7/58; El-Ihtijar, 1/158; Meraki-l-felah, fq. 663.

¹⁷⁹ Buhariu, Sahih: 24- Kitabu-z-zekat, 70- Babu fardi sadekati-l-fitri, hadithi nr. 1503.

¹⁸⁰ Shih: Nejlul-evtar, 4/213 dhe Fikhu-z-zekat, 2/919.

¹⁸¹ Ibn Rushdi, Bidajetu-l-mixhtehid, 1/278.

¹⁸² Shih për këtë: Fet’hu-l-Bari, 3/430-431 dhe Hasan Škapur, Buharijina zbirka hadisa, 2/508.

të veten, atëherë përkujdesësi i tyre do të japë nga pasuria e tyre. Ky është qëndrimi i Ebu Hanifes dhe Ebu Jusufit, derisa Muhammedi ka mendim tjetër. Me këtë të dhënë është e obliguar edhe gruaja. Burri nuk është i obligueshëm që të japë për gruan e tij, por ajo është e obliguar ta bëjë këtë nga pasuria e saj. Prindërit nuk duhet të hapin për fëmijët e tij të rritur. Gjithashtu edhe nëna nuk do të japë për fëmijët e saj, madje edhe nëse nuk e kanë babanë, por për ata, gjyshi është i obliguar të japë sadaka.¹⁸³

Mirëpo, një transmetim i Tahaviut se sadakatu-l-fitri jepet për çdo person të cilin e mbanë i zoti i shtëpisë, qofshin ata të moshës fëmijërore ose të rritur, të lirë ose rob, madje edhe nëse është i krishterë. Është shënuar se Omer ibn Abdulazizi ka dhënë sadakatu-l-fitër edhe për robërit e tij jomuslimanë.¹⁸⁴

KUJT I JEPET SADAKATUL FITRI?

Sadakatu-l-fitri i jepet atyre të cilëve i jepet zekati. Kujt nuk mundet t'i jepet zekati, nuk mund t'i jepet as sadakatu-l-fitri. Mirëpo, me rastin e dhënies, përparësi kanë të varfërit.¹⁸⁵ Në kushtet tona, më këto deceniet e fundit, sadakatu-l-fitri i është dhënë institucioneve edukativo-arsimore të cilët kanë edukuar dhe arsimuar kuadro, që bien në kategorinë *fi sebilil-lah*.

Duhet theksuar se shumica e dijetarëve islam, për dallim nga Ebu Hanifja, nuk lejojnë dhënien e sadakatul fitrit jomuslimanëve të varfër nën mbrojtjen e shtetit islam.

Dr. Jusuf Kardavi thekson se sadakatu-l-fitri nuk duhet t'u jepet armiqëve të islamit, renegatit nga islami, mëkatarit i cili s'i përfill muslimanët me mëkatet e tij dhe dembelit i cili ka mënyra të punojë dhe fitojë por nuk dëshiron. Gjithashtu, është e ndaluar t'i jepet babait, fëmijës dhe gruas, sepse kjo do të ishte në të vërtetë, t'i japësh vetvetes.¹⁸⁶

SA KA VLERË SADAKATUL FITRI?

Sadakatul fitri arrinë një gjysëm sa'a grurë, që është e barabartë me sasinë prej 1,666 kg ose një sa'a të elbit, që është e barabartë me 3,332 kg. ose hurma apo rrush të thatë. Në të vërtetë, të mirat e përmendura theksohen edhe në shumë transmetime të Muhamedit s.a.v.s. dhe shumë dijetarë i qëndrojnë në mënyrë shumë strikte këtyre transmetimeve, kështu që shumica e dijetarëve nuk lejojnë dhënien e sadakatul fitrit në diçka tjetër përveç në të mirat e përmendura.

Qëndrimi i shkollës juridike hanefite është shumë më fleksibil: mendojnë se qëllimi i

¹⁸³ El-Hidaje, 1/113; Hashijetu-t-Tahtavi, 2/402-403; Fikhu-l-ibadat, fq. 106-107 dhe A. Zečević, Fikh, fq. 70 dhe Fikhu-z-zekat, 2/924-930.

¹⁸⁴ Krahaso: Buharijina zbirka hadisa, 2/509.

¹⁸⁵ Shih: Fikhu-l-ibadat, fq. 107.

¹⁸⁶ Shih: Zekatu-l-fitr, 2/959.

sadakatul fitrit është futja e gëzimit dhe lumturisë gjatë Bajramit në zemrat e muslimanëve dhe te ata të cilët kanë nevojë për ndihmë, dhe prej këtui, lejohet dhënia e sadakatul fitrit në para, nëse këto janë më të dobishme për të varfërin. Hasan El-Basriu dhënien e parave e ka konsideruar të lejuar; Ebu Is'hak pohon se ka mbajtur mend paraardhësit e tij se kanë dhënë sadakatul fitër në para, si kundërvlerë e ushqimit, derisa transmetohet për 'Ataun se e ka pasur zakon të japë sadakatul fitrin në para të argjenta, si kundërvlerë e ushqimit të porositur në shumë transmetime.¹⁸⁷

Është e qartë se këtu bëhet fjalë për atë që është më e mirë dhe më e dobishme në një shoqëri. Në kohën e Muhamedit s.a.v.s. kanë qenë këto të mira. Po t'u kishte ardhur japonezëve ky lloj i transmetimit, siç thotë dr. Jusuf Kardavi, atyre do t'u ishte urdhëruar që ata sadakatul fitrin ta japin në oriz.¹⁸⁸

Mënyra më e lehtë dhe më e zakonshme në kohën e sotme është dhënia e parave. Posaçërisht nëse kihet parasysh se sadakatul fitri dërgohet prej vendeve të largëta, ndërsa çdo mënyrë tjetër e dhënies së tij, do të vështirësonte praktikimin e sadakatu-l-fitrit. Mendoj se përfundimi i dr. Jusuf Kardavit është shumë logjik. Ai në të vërtetë, duke u pajtuar me qëndrimin hanefit lidhur me çështjen e dhënies së sadakatul fitrit, përfundon se janë dy arsye thelbësore që Muhamedi s.a.v.s. ka urdhëruar në dhënies sadakatul fitrit në të mirat e theksuara:

1. Për shkak se një numër i vogël i njerëzve në botën arabe në atë kohë, kanë poseduar para, pra ka qenë më lehtë të ndahen të mirat se sa ushqimi, dhe
2. për shkak ndryshimit të vlerës së parasë, sepse nëse do të përcaktohej një valutë e caktuar, ajo për shkak të devalvimit të shpeshtë e të ngjashme, ndoshta ndonjëherë do të ishte e pavlerë. Për këtë, Muhamedi s.a.v.s. ka caktuar ndarjen e sadakatu-l-fitrit në të mira të cilat gjithmonë do të kenë vlerën e tyre.¹⁸⁹

KUR JEPET SADAKATUL FITRI?

Dijetarët islam janë pajtuar se obligimi i sadakatul fitrit bjen në përfundim të Ramazanit. Shumica prej tyre mendojnë se atë duhet dhënë një apo dy ditë para Bajramit, ndërsa sipas disave mund të jepet që prej fillimit të Ramazanit. Evzai'u, Ahmedi, Is'haku dhe sipas një mendimi Shafiu, mendojnë se është vaxhib dhënia e sadakatu-l-fitrit me perëndimin e diellit në ditën e fundit të Ramazanit. Ebu Hanife mendon se obligimi i dhënies së sadakatul fitrit fillon me paraqitjen e agimit të ditës së parë të Bajramit të Ramazanit e deri në fillim të faljes së namazit të Bajramit.¹⁹⁰

Kjo mbështetet në fjalët e Muhamedit s.a.v.s. se sadakatul fitri “... *jepet para daljes së*

¹⁸⁷ Po aty, 2/948-949.

¹⁸⁸ Po aty, 2/946.

¹⁸⁹ Po aty, 2/949.

¹⁹⁰ Fikhu-z-zekat, 2/952.

*njerëzve në namazin e Bajramit.”*¹⁹¹

Ikrimë r.a. gjithashtu pajtohet se këtë duhet bërë para namazit të Bajramit dhe ai mbështetet në ajetin: *“Ka shpëtuar ai që është pastruar. Që e përkuqton madhërinë e Zotit të vet dhe falet.”*¹⁹² Ai me *pastruar* nënkupton sadakatu-l-fitrin, si pastrim i agjërimit nga të gjitha mangësitë dhe lëshimet.

Dijetarët islam janë pajtuar se nëse kalon koha e dhënies së sadakatul fitrit, mbetet mboligim që ajo të kompensohet kurdo gjatë jetës.¹⁹³

I'TIKAFI

Itikafi rrjedh prej fjalës arabe i'tekefe, që domethënë: të qëndrosh në shtëpi, të mbyllesh, të tërhiqesh.¹⁹⁴ Në traditën islame kjo do të thotë qëndrimi i qëllimshëm dhe i vetëdijshëm i njeriut në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit në xhami, në të cilën ai falë pesë kohët e namazit.

Kushtet për itikaf janë: islami, mençuria, nijeti që të qëndrohet tërë kohën në xhami në të cilin ai falet me xhemat të pesë kohët e namazit, qëndrimi në xhami, agjërimi gjatë ditës, pastrimi nga xhunubllëku, hajzi dhe nifasi. Kur është fjala për moshën, ajo nuk është kusht për itikafin e vlefshëm, ashtu siç nuk është kusht që personi të jetë mashkull ose person i lirë. Pra, itikafi i pranueshëm është edhe ai të cilin e bën gruaja ose robi.¹⁹⁵

Itikafi nuk vlenë nëse kryhet në xhami ose mesxhid në të cilin nuk falen pesë kohët e namazit me xhematë, ose nëse kryhet nga personi i cili kalon një kohë të caktuar në xhami, por që nuk ka pasur për qëllim që këtë kohë ta kalojë në itikaf.

Gruaja mundet të kryejë itikafin në shtëpinë e saj, posaçërisht nëse ka ndonjë dhomë të veçantë në të cilën mund të ndajë dhe ta shfrytëzojë atë për qëllime itikafi.¹⁹⁶

LLOJET E I'TIKAFIT

Ka tre lloje të itikafit:

Vaxhib, sunneti-muekkede dhe mustehab

1. Vaxhib është itikafi i betuar (premtuar). Ky është lloj i itikafit e cila në vetë përmbanë edhe agjërimit. Ajo është p.sh. nëse dikush është i sëmurë, thotë: *“Nëse jep All-llahu që të shërohem, do të kaloj në itikaf kaq e kaq ditë!”* Ose: *“Nëse e jap këtë provim në fakultet, do të kaloj në itikaf kaq e kaq ditë!”*

¹⁹¹ Buhariu, Sahih: 24- Kitabu-z-zekat, 70- Babu fardi sadekati-l-fitr, hadithi nr. 1503.

¹⁹² Kur'ani: A'la, 14-15.

¹⁹³ Krahaso: Mr. M. Štulanović, Ramazanski post, fq.26

¹⁹⁴ Krahaso: Teufik Muftić, Arapsko-bosanski rječnik, fq. 995.

¹⁹⁵ Shih: El Hidaje, 1/129; Meraki-l-felah, fq. 645-646; dr. Vehbe Ez-Zuhajli, El Fikhu-l-islami ve edul-letuhu, 2/693 dhe Es-Sijamu ve ahkamuhu, fq. 162-163.

¹⁹⁶ El-Hidaje, 1/129; Fikhu-l-ibadat, fq. 99.

Abdullah ibn Omeri r.a. transmeton se babai i tij Omeri r.a. e ka pyetur Muhamedin s.a.v.s.: “O i Dërguari i All-llahut, jam betuar në kohën paraislame se në itikaf do të kaloj një natë në Qabe?” Muhamedi s.a.v.s. i tha: “Plotëso betimin tënd!” Omeri r.a. pastaj ka kaluar një natë në itikaf në Qabe.¹⁹⁷

2. Sunneti-muekkede, edhe atë ‘*ale-l-kifaje*, i bazuar në praksën e Muhamedit s.a.v.s. i cili ka kaluar në i’tikaf dhjetë ditët e fundit të Ramazanit dhe këtë e ka bërë deri në vdekjen e tij. Abdullah ibn Omeri r.a. transmeton: “I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka qëndruar në xhami dhjetë ditët e fundit të Ramazanit!”¹⁹⁸ Në transmetimin e Aishes r.a. thuhet: “Muhamedi s.a.v.s. ka qëndruar në xhami me frikërespekt dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, deri sa All-llahu nuk e thirri drejt Vetes, e pas tij, i’tikafin e kanë praktikuar gratë e tij.”¹⁹⁹

Duhet theksuar se ky lloj i itikafit bie prej të tjerëve nëse dikush e kryen në xhematin e tyre, gjegjësisht në xhaminë e tyre.

3. Mustehab. Ky është itikafi i cili mund të kryhet edhe pa agjërim, e mund të përbëhet prej një kohe shumë të shkurtër të kaluar në xhami. Duhet theksuar se ky i’tikaf nuk kryhet në dhjetë ditët e Ramazanit, e nuk mund të jetë itikaf i betuar.²⁰⁰

RREGULLAT LIDHUR ME ITIKAFIN

1. Ndalohet që personi deri sa është në itikaf të ketë marrëdhënie seksuale me gruan, si dhe puthja me epsh ose përkdhelja. All-llahu xh.sh. qartë tregon: “E kur jeni të izoluar (në i’tikafë) në xhamia, mos t’u afroheni atyre (për marrëdhënie intime).”²⁰¹

2. Ndalohet largimi prej xhamisë deri sa është në itikaf, përveç në rast të kryerjes së nevojave fiziologjike, marrjes së abdestit ose larjes prej xhunubllëkut.

3. Është e lejuar që të qet kokën jasht për larje, ashtu siç transmeton Aisha r.a.: “Muhamedi s.a.v.s. ka qitur kokën e tij jashta xhamisë kur ka qenë në itikaf dhe une ia kam larë, ndërsa unë kasha menstruacionet.”²⁰²

4. Mu’tekifi duke qëndruar në xhami, do të lexojë Kur’an, do të falë namaz vullnetar, do të bëjë dhikër All-llahut, istigfar, do të lexojë, hulumtojë librat dhe do të shkruajë. Nëse është në pyetje nxënës apo student, atij i lejohet edhe të përgatisë provimet për në shkollë ose fakultet.

¹⁹⁷ Buhariu, Sahih: 33- Kitabu-l-i’tikaf, 16- Babu idha nezere fi-l-xhahilijeti en ja’tekife thumme esleme, hadithi nr. 2043

¹⁹⁸ Buhariu, Sahih: 33- Kitabu-l-i’tikaf, 1- Babu-l-i’tikafi fi-l-ashri-l-evahiri, hadithi nr. 2025.

¹⁹⁹ Buhariu, Sahih: 33- Kitabu-l-i’tikaf, 1- Babu-l-i’tikafi fi-l-ashri-l-evahiri, hadithi nr. 2026.

²⁰⁰ El-Fikhu-l-islami ve edil-letuhu, 2/700.

²⁰¹ Kur’ani: Bekare, 187.

²⁰² Buhariu, Sahih: 33-Kitabu-l-i’tikaf, 4- Babu gasli-l-mu’tekifi, hadithi nr. 2030.

5. I lejohet mu'tekifit që të blejë dhe të shesë atë që është e nevojshme për të, për familjen e tij dhe për punën e tij, mirëpo rreptësisht është e ndaluar tregtia dhe shitblerja në aspektin e fitimit, sepse xhamia është vend për ibadet e jo për pasurim e biznes.

6. Mu'tekifi do të hyjë në itikaf para akshamit të ditës së 20 të Ramazanit dhe do të qëndrojë në xhami deri në aksham para Bajramit.

7. Është e preferuar që mu'tekifi zemrën e tij ta pastrojë nga dunjaja dhe mendimet për të, dhe të mundohet sa më shumë mendjen e tij ta drejtojë në Atë i cili është Zoti ynë dhe i gjithë hapësirave të gjithësisë.²⁰³

ÇKA E PRISHË ITIKAFIN?

1. Marrëdhëniet seksuale me gruan ose çfarëdo veprimi i cili do të nxiste polucionin.

2. Dalja prej xhamisë, përveç në rastet e veçanta dhe në situata të veçanta të cilat u përmendën. Nëse del prej xhamisë për shembull, të vizitojë të sëmurin, të falë namazin e xhenazës e të ngjashme, itikafi do t'i priset.²⁰⁴ Personi në itikaf është e urryer që të merret me diçka që nuk i takon atij, qoftë nëse bëhet fjalë për fjalë ose veprime të tjera, sikur ndërprerja e kontakteve dhe bisedave me botën, duke menduar se me këtë i afrohet All-llahut xh.sh.²⁰⁵

Është e qartë se ditëve të fundit të Ramazanit, sipas të gjitha shenjave, duhet të kalojmë në ibadet dhe në të menduar për veten tonë, për rrethinën në të cilën jetojmë, dhe në fund, për të gjitha shenjat e kësaj bote të cilat pa dyshim na çojnë drejt All-llahut, Zotit të botërave. Pasi që Muhamedi s.a.v.s. ka marrë Shpalljen në shpellën Hira në Natën e Kadrit, mu atëherë kur ka menduar për veten dhe esencën e ekzistimit të tij në këtë botë, kjo qartë tregon se edhe itikafi është përkujtim në atë moment madhështor i cili ka ndodhur vetëm një herë në epokën njerëzore dhe se në këtë mënyrë, fisi njerëzor i falënderohet Zotit të tij në dhuratën më të madhe të cilën ua ka lëshuar mu ato netë të Ramazanit- Kur'ani Kerimin.

I Dërguari i Islamit, Muhamedi s.a.v.s. me praksën e tij në dhjetë netët e Ramazanit, qartë e ka treguar këtë. Aisha r.a. transmeton: *"Kur vinin dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, Muhamedi s.a.v.s. i shtrëngonte rrobat e tij (tërhiqej prej grave të tij), çdo natë e kalonte në adhurim dhe zgjonte njerëzit e shtëpisë së tij (i ka nxitur ata në adhurim)."*²⁰⁶

Në të vërtetë, dhjetë ditët dhe netët e fundit të Ramazanit duhet të jenë llogaritje e vetvetes, hulumtimi ynë personal dhe me adhurim të shtuar, të menduarit intenziv, që do të na zbulonte horizontet e njohjeve të reja dhe marrëdhënieve më të përgjegjshme ndaj Zotit tonë dhe botës në të cilën jetojmë.

²⁰³ Krahaso: El-Hidaje, 1/130-131; Ibn Haxher: Bulugu-l-meram, fq. 195-196; Meraki-l-felah, fq. 649-651; Es- Sijamu ve ahkamuhu, fq. 164-166.

²⁰⁴ Shih: El-Hikaje, 1/130; Hashijeti-t-Tahtavi, 2/378; Es-Sijamu ve ahkamuhu, fq. 167.

²⁰⁵ Shih: El-Hidaje, 1/130; El-Ihtijar, 1/178; Multeka-l-ebhur, 1/206 dhe mr. M. Štulanović, vep. cit., fq. 28.

²⁰⁶ Buhariu, Sahih: 32-Kitabu fadli Lejleti-l-Kadri, 5-Babul-'ameli fi-l-ashri-l-evahiri min ramadane, hadithi nr. 2024.

NAMAZI I TERAVIVE

Namazi teravisë është sunnet i fortë (sunet muekede) edhe për meshkuj edhe për femra. Është sunnet muekede, ngase Pejgamberi s.a.v.s. këtë namaz e ka falur disa natë me sahabët, por nuk ka vazhduar të falet çdo natë me ta, nga frika se mos ky namaz do të kuptohej si i detyrueshëm.²⁰⁷

SI FALET KY NAMAZ?

Vetë emri *teravib*, është marrë nga kuptimi i tij, që do të thotë pushim, pauzë. Selami jipet në çdo dy rekate.²⁰⁸ Sejid Serdareviç, në bazë të shumë burimeve hanefite, përmend se në çdo dy rekate, të namazit të teravive, ipet selam, ashtu siq ipet edhe në çdo namaz nafile dhe namaz të natës, mirëpo habit fakti se si tek ne praktikohet që selami të ipet pas çdo katër rekateve, e disa, madje, edhe pas çdo dhjetë rekateve, që është në kundërshtim me praktikën e shkollës juridike hanefite. Madje Serdareviç qartë thekson se është mustehab që në çdo katër rekate të bëhet një pushim, aq sa zgjatë kur t'i falesh katër rekate namaz. Gjatë kësaj kohe mund të lexohet Kur'an, salavate, të bëhet dhikr ose të heshtet.²⁰⁹

Autori i veprës së njohur *El-Ihtijar* të medhhebit hanefij, në mënyrë kategorike thotë se selami jepet në çdo dy rekate, ndërsa pushimi bëhet në çdo katër rekate, duke e argumentuar atë me traditën e Ubejj ibn Ka'abit, r.a, sahabiu që lexonte Kur'anin shumë bukur dhe të cilin Omeri r.a, e caktoi si prijës në namazin e teravisë në xhaminë e Pejgamberit s.a.v.s. Ai thotë se kjo ishte traditë e faljes në të dy haremet si në Meke ashtu edhe Medine.²¹⁰

Pra, bëhet fjalë për atë se namazi i teravive edhe në shkollën juridike hanefite është definuar si namaz i cili falet me nderë, qetë dhe ngadalë, me pauza ndërmjet dy, gjegjësisht katër rekateve. Sipas cilit medh'heb pra te ne ka filluar të praktikohet shpejtësia aq e madhe ndërmjet dhënies së selamit dhe fillimit të reقاتit të ri?! Prej nga pra pauza pas dhënies së selamit, e cila përmendet në veprat hanefite, dhe e cila zgjatë sa falja e katër rekateve, është shndërruar në ngritje të shpejtë prej gjendjes ulur e drejt në reقاتin tjetër, si dhe belbëzimi i pakuptueshëm i ndonjë dhikrit, të cilin as ne, nga shpejtësia nuk e kuptojmë?!

Nuk është kontestuese vetëm shpejtësia e kalimit prej dhënies së selamit dhe fillimit të reقاتit të ri, por më e çuditshme është praktika e shpeshtë, e leximit të shkurtër në kijam, me shpejtësi të madhe në lexim, që zhvleftëson dhe sjell në pikëpyetje saktësinë e vetë namazit.

Seid Sardareviç, pas studimit të shumë veprave hanefite, thekson: Pasi që në çdo namaz është vaxhib që me Fatihanë të lexohet edhe një sure ose tre ajete të

²⁰⁷ Es-Sagirxhi, El-Fikhu-l-hanefi ve edil-letuhu 1/225.

²⁰⁸ El-Ihtijar, 1/92 dhe Multeka-l-ebhur, 1/120

²⁰⁹ Shih këtë formulim të qartë tek: Seid Serdareviç, Fikhu-l-ibadat, f.62

²¹⁰ Shih: El-Ihtijar, 1/93

shkurtëra, ose një ajet i gjatë sa tre të shkurtër, atëherë edhe në namazin e teravisë nuk lejohet leximi më pak se që është vaxhib!²¹¹

Është për t'u habitur që disa lexojnë aq ajete të shkurtëra dhe gjatë leximit lexojnë aq shpejt sa që shpesh ndodh që ata që falen nuk e din se është në pyetje sureja Fatiha, në përgjithësi nuk din që ajo që lexon ka të bëjë me sure nga Kur'ani. Nëse në namazin e teravisë nuk mund të lexohet një xhuz siç është e pëlqyer, atëherë duhet që së paku ajo që lesote, të lexohet bukur, ngadalë dhe qartë. Me atë ne do të tregojmë respektin tonë ndaj namazit, Kur'anit dhe ndaj All-llahut të cilit i drejtohem. Të jemi të singertë dhe ta pranojmë: a do të bisedonim aq shpejt me ndonjë njeri autoritativ, të cilin e nderojmë dhe e respektojmë me respekt të veçantë?! Mos të harrojmë se ne gjatë namazit të teravisë jemi në audiencën e Zotit tonë, dhe i drejtohem Atij i cili na jep çdo gjë, dhe prej të Cilit kërkojmë mëshirë dhe shpërblim?! Pranone se me çfarë thjeshtësie, qetësie dhe me çfarë dinjiteti duhet ta bëjmë atë?! Sigurisht, jo me aq shpejtësi dhe kryelartësi, sikurse veprojmë me ndonjë njeri të cilin aspak nuk e respektojmë!

SA REKATE KA NAMAZI I TERAVISË?

Duhet të theksojmë se qëllimi i namazit është afrimi dhe nënshtrimi ndaj All-llahut xh.sh., një lloj i transformimit të personalitetit, nga lakmitë, përfitimet dhe ambiciet e kësaj bote, në devotshmëri dhe subtilitet. All-llahu i Madhëruar në Kur'anin fisnik qartë e thekson atë dhe thotë: *Vërtetë namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irtuarat!*²¹²

Pra, qëllimi i tij final është kthesa e besimtarit, edukimi i tij dhe transformimi i tij i vërtetë.

Për fat të keq, edhe namazit, sikurse edhe ibadeteve tjera zakonisht i qasemi vetëm formalisht. Kështu që, në vend se të flitet për aspektin e tij thelbësor, kryesisht flitet për elementet e tij formale, mënyrës së faljes, numrit të rekateve dhe ngajshëm me to. Kjo ndodh edhe me namazin e teravisë. Dallimet themelore ndërmjet nesh, për fat të keq, janë numri i rekateve ose disa elemente formale të këtij namazi.

Këto dallime formale edhe i janë lënë njeriut që në bazë të mundësive të tij fizike dhe racionale të zgjedh atë që i përshtatet. Fleksibiliteti në ibadet është dhuratë e veçantë nga ana e Zotit të botërave për robërit e tij, që ne, për shkak zemërngushtësisë, mendjemadhësisë dhe mburrjes, na paraqet vetëm një pengesë që del para në rrugën e ngritjes.

Ajo çka është e rëndësishme për namazin e teravisë është se ai ibadet duhet të jetë pjesë përbërëse e vigjëllemi të Ramazanit, për të cilin All-llahu xh.sh. ka përgatitur shpërblim të veçantë, siç ka thënë Pejgamberi s.a.v.s. në një hadith të cilin e transmeton Ebu Hurejra r.a.: *Kush i kalon netët e Ramazanit duke bërë ibadet, duke qenë i bindur në besimin islam, dhe duke pasur qëllim të singertë, do t'i falen të gjithë gabimet e tij të*

²¹¹ Fikhu-l-ibadat, fq. 62

²¹² Kur'ani: Ankebut, 45

Pothuaj se të gjithë dijetarët islam janë të pajtimit se fjala e Pejgamberit s.a.v.s.: “*Men kame ramadane/ kush i kalon netët e ramazanit në kijam - duke u falur*, i përket namazit të teravisë. Këtë e shohim te një kapitull i Muslimit i titulluar: “*Babu-t-tergibi fi kijami ramadane ve huve-t-teravib*” që d.m.th: “*kapitulli i nxitjes për falje në ramazan e ai është namazi i teravive*”.²¹⁴ Kështu mendon edhe imam Nevevi,²¹⁵ ndërsa El-Kermani, njëri prej komentatorëve të Sahihut të Buhariut qartë thekson: “*Dijetarët islam janë të pajtimit se falja në muajt e ramazanit ka për qëllim faljen e namazit të teravisë*.”²¹⁶

Ndonëse, polemikat më të shpeshta janë rreth numrit të rekateve të teravive, na imponohet nevoja që të sjellim argumentet relevante për to.

Duhet të vëmë në pah se secila shkollë e pranuar juridike islame ka argumente valide kur janë në pyetje dallimet formale të faljes së namazeve. Problemi i vetëm qëndron në sjelljen fanatike të ithtarëve të ndonjë medhhebi, ose njëanshëmëria e disa ithtarëve të drejtimit jomedhehebik, të cilët qëndrimin e tyre e argumentojnë vetëm me argumentet e imamëve të tyre, duke mos respektuar mendimin apo argumentin e tjerëve.

Ka shumë qëndrime lidhur me numrin e rekateve të namazit të teravive. T’i numërojmë: tetë, njëmbëdhjetë (së bashku me vitrin), njëzet, njëzet e katër, njëzet e tetë, tridhjet e katër, tridhjet e gjashtë, tridhjet e nëntë dhe dyzet e një rekate.²¹⁷

Duhet të theksojmë, siç përmendin edhe shumë muhadithin, se të gjitha transmetimet autentike merfu tregojnë se numri i rekateve është tetë. Kështu përmbledhjet më autentike të haditheve na sjellin thënien e Ebu Seleme ibn Abdurrahmanit, ku thuhet se e ka pyetur Aishen r.a se si ka qenë namazi i natës i Pejgamberit s.a.v.s., ndërsa Aisheja r.a. është përgjigjur: “*I Dërguari i All-llabut, as në ramazan e as jashta tij, nuk ka falur më shumë se njëmbëdhjetë rekate. I ka falur katër rekate dhe mos pyet për bukurinë dhe gjatësinë e tyre. Pastaj prapë i ka falur katër rekate dhe mos pyet për bukurinë dhe gjatësinë e tyre. Pastaj i ka falur edhe tre rekate. E kam pyetur: “O i Dërguar i All-llabut a flenë para se ta falësh namazin e vitrit? I Dërguari i All-llabut është përgjigjur: Aishe, sytë e mi flejnë, ndërsa zemra ime jo!”*”²¹⁸

Transmerohet nga Xhabiri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka falur me të tetë rekate të namazit të teravisë, dhe pastaj ka falur namazin e vitrit. E kanë pritur edhe natën tjetër por ai nuk ka dalur.²¹⁹

²¹³ Buhariu, Sahih: 31-Kitabu salati-t-teravib, 1-Babu fadli men kame ramadane, hadithi nr. 2009; Muslimi, Sahih: 6-Kitabu salati-l-musafirineve kasruha, 25-Babu-t-tergibi fi kijame ramadane ve huve-t-teravib, hadithi nr.759; Tirmidhiu, Sunen: 6-Kitabu-s-savmi, 1-Babu ma xhae fi fadil shehri ramadane, hadithi nr. 683

²¹⁴ Shih: Sahihu Muslim 1/440 (Botuar nga Daru ibn Hazm, Bejrut, 1995).

²¹⁵ Shih: Esh-Shevkani, Nejlu-l-evtar, 3/61

²¹⁶ Ibn Haxher, Fet’hu-l-Bari, 4/295.

²¹⁷ Shih më gjërësisht tek: Buhariu, 3/619; Tirmidhiu, 3/199; Nejlu-l-evtar, 3/65-66 dhe Es-Sejid Sabik, Fikhu sunneh, 1/174-175

²¹⁸ Buhariu, Sahih: 19-Kitabu tehexhud, 16-Babu kijamin-Nebiji s.a.v.s. bi-l-lejli fi ramadane ve gajrihi, hadithi nr. 1147 edhe autor të ndryshëm të përmbledhjeve me hadithe.

²¹⁹ Ibni Huzejme dhe Ibni Hibban në Sahihët e tyre. Gjithashtu krahaso Nejlu-l-evtar, 3/66 dhe Fikhu-s-

Transmetohet nga Ubej ibn Ka'b r.a. se e kanë lutur gratë, ngase nuk dinin shumë nga Kur'ani që t'i udhëheqë në namazin e teravive, dhe ai veproi ashtu dhe fali me ta tetë rekate, dhe pastaj e fali namazin e vitrit. Ai ia përmendi këtë Pejgamberit s.a.v.s., e ai nuk tha asgjë.²²⁰

Andaj, për këtë disa mendojnë se të falësh njëzet rekate gjatë teravive është gabim, dhe është në kundërshtim me sunetin e të Dërguarit s.a.v.s. Prej nga, pra, njëzet rekate në këtë namaz në shkollën juridike hanefite?! A mos është kjo shpikje e medhhebit hanefij dhe preferim i analogjisë, për çka ajo shkollë shpesh akuzohet, apo kanë argumente në bazë të të cilave i mbështesin qëndrimet e tyre?

Shkolla huridike hanefite qëndrimin e tyre për njëzet rekate të teravive e bazon në transmetimet e vërteta se Omeri, Othmani, Aliu dhe një numër i madh i sahabeve r.a. aq i kanë falur. Askush në këtë nuk u ka kundërshtuar. Në të vërtetë, dihet se, siç transmeton Jezid ibn Hudhejfe nga Saib ibn Jezid r.a., se në kohën e hilafetit të Omerit r.a. është praktikuar falja e njëzet rekateve gjatë namazit të teravisë. Në atë transmetim besueshëm thuhet se: *Për ramazan, natën, në kohën e Omerit r.a., janë falur njëzet rekate. Në çdo rekat lexoheshin nga dyqind ajete, kështu që në kohën e Othmanit nga qëndrimi i gjatë në këmbë njerëzit mbështeteshin në shkopinj të tyre!*²²¹

Këtë transmetim shumë muhadithinjë e vlerësojnë si të besueshëm, si p.sh. Neveviu në *El-Hulas*, Ibnu-l-Iraki në *Sherhu Takribu*, Sujutiu në *El-Mesabihu*, Es-Subki në *Sherbul Minbaxh*, Bedrudin El- Ajni në *Umdetu-l-kari*, Ali Kari në *Sherhu-l-Muveta* etj.²²²

Do të përmendim edhe disa transmetime të besueshme në të cilat hanefitë i bazojnë qëndrimet e tyre në njëzet rekate të namazit të teravisë:

Ata' thotë: E mbaj mend njerëzit të falnin njëzet e tre rekate, së bashku me vitrin!²²³

Imam Maliku transmeton thënien e Jezid ibn Rumana ku thuhet: Njerëzit në netët e ramazanit, në kohën e Omerit r.a., falnin nga njëzet e tre rekate.²²⁴

Ebu Hudhejve thotë: Suvejd ibn Gafle na ka udhëhequr gjatë namazit për ramazan, dhe me atë rast ka falur njëzet rekate, duke bërë pesë tervihe/pushime.²²⁵

Nafi ibn Omeri transmeton: Na ka udhëhequr për namaz gjatë ramazanit Ibn ebi Mulejke dhe me atë rast ka falur njëzet rekate.²²⁶

Seid ibn Ubejd transmeton se gjatë muajit të ramazanit për namaz i ka udhëhequr Ali ibn Rebia dhe me atë rast ka falur njëzet rekate të namazit të teravisë, dhe tre rekate të namazit të vitrit.²²⁷

suneh, 1/174.

²²⁰ Taberaniu dhe Ebu Ja'la el-Mevsili. Transmetimi njihet i mirë. (shih: Fikhu-s-suneh, 1/174)

²²¹ Imam Bejhekiu në Es-Sunenu-l- Kubra: Kitabu Salat; Babu ma ruviye fi adedi rekatit kijame shehri ramadan, 2/496. Senedin e këtij hadithi En-Nejmevi e vlerëson si autentik. (shih: Gavoxhi, Es-Salatu ve ahkamuhu) f. 209

²²² Krahaso: Gavoxhi, Es-Sijamu ve ahkamuhu, f.63.

²²³ Ibn Ebi Shejbe. En-Nejmevi e vlerëson si të mirë. (Krahaso: Es-Sijamu ve ahkamuhu, fq. 63-64)

²²⁴ Imam Maliku, Muvetta: Babu ma xhae fi kijami ramadan, 1/138

²²⁵ Bejhekiu, Es-Sunenu-l- Kubra, Kitabu-s-salat, 2/496. Nejmeviu thotë se transmetimi është i mirë.

²²⁶ Ibn Ebi Shejbe, ndërsa Nejmeviu thotë se ky transmetim është autentik.

²²⁷ Ibn Ebi Shejbe, dhe e vlerëson të besueshëm.

Transmetohet nga Abdurrahman es-Sulemi se Ali ibn Ebi Talibi r.a., në ramazan i ka thirur talebet dhe njërin prej tyre e ka urdhëruar që t'u prijë njerëzve në namaz dhe t'i fal njëzet rekate, ndërsa pastaj Aliu r.a. i ka udhëhequr në namazin e vitrit.²²⁸

Imam Bejhekiu transmeton nga Shutejra ibn Shekel se Ali ibn ebi Talibi r.a. ua kishte falur namazin e teravisë me njëzet rekate, ndërsa pastaj kishte falur tre rekate të namazit të vitrit.²²⁹

Transmetimet e mësipërme kryesisht janë të lidhura me sahabët dhe mënyrën e tyre të faljes së teravive. Ndonëse, Imam Bejhekiu cek një transmetim të dobët ku thuhet se pejgamberi s.a.v.s. ka falur njëzet rekate. Kështu, Abdullah ibn Abbas r.a. transmeton: *Pejgamberi s.a.v.s. në muajin e ramazanit kur nuk ishte me xhemat, i falte njëzet rekate dhe namazin e vitrit.*²³⁰

Andaj, shkolla juridike hanefite numrin e rekateve të namazit të teravisë e bazon në praktikën e sahabëve, All-llahu qoftë i kënaqur me ta, duke konsideruar se ata ishin më të saktit në pasimin e Pejgamberit s.a.v.s., dhe se askush prej tyre nuk do të praktikonte një gjë po të mos ishin kishin argument të qartë. Këtu bëhet bëhet fjalë për koncenzus të sahabëve (*Ixbma'u-s-sahabe*), a ajo është argument i rëndësishëm dhe relavant i sheriatit.

Kështu Ebu Jusufi thotë: E kam pyetur Ebu Hanifen për namazin e teravisë dhe në lidhje me atë çka ka vepruar Omeri r.a., dhe më është përgjigjur: Namazi teravisë është sunnet i fortë (muekede). Omeri r.a. nuk ka qenë novator (bidatgji), nuk e ka bërë atë nga mendja e tij, porse ka pasur burim për të, nga koha e Pejgamberit s.a.v.s.²³¹

Shejh Muhamed Jusuf el Benuri, pas këtyre fjalëve, konkludon: Këto fjalë të Ebu Hanefes kulminacioni i asaj që qetëson zemrën dhe kulminacioni i precizitetit dhe burimores. Ai me këtë ka manifestuar atë që te shumë jurist ishte e megjulluar. Ato fjalë qartë tregojnë në mundësinë se Omeri r.a. ka pasur garancion për atë që e ka vepruar, kështu që numri nga njëzet rekate është e bazuar në thëniet merfuë, edhe pse ato tek ne nuk kanë ardhur me ndonjë transmetim të fortë!²³²

Duke e marrë parasysh se falja e njëzet rekateve, siç transmetohet në thënie të besueshme, ka qenë në kohën e Omerit r.a., ka vazhduar në kohën e Othmanit r.a., dhe pas tij të Aliut r.a., ndërsa asnjëri prej sahabëve fare nuk ka reaguar, qartë tregon për bazamentin e atij veprimi. Përveç kësaj, El-Irbad ibn Sarija, r.a. transmeton një hadith të Pejgamberit s.a.v.s., ku ai urdhëron ndjekjen e halifëve të drejtë që do të vijnë pas tij, duke thënë: *Kushdo që do të jetoj pas meje do të sheh shumë përçarje. Ju obligoj që të kapeni për sunetin tim dhe të halifëve të mi, të drejtë e të udhëzuar. Kapuni fort për to! Rruajuni nga risitë, sepse çdo risi është bidat ndërsa çdo bidat është humbje!*²³³

²²⁸ Bejhekiu, Es-Sunenu-l- Kubra, Kitabu-s-salat, Babu ma ruviye adede rekatin kijame shehri ramadan, 2/496-497.

²²⁹ Po aty

²³⁰ Po aty

²³¹ Es-Sijamu ve ahkamuhu, fq. 64-65

²³² Po aty, fq. 65.

²³³ Ebu Davudi, Sunen: Kitabu-s-suneti, Babu fi ludhumi suneti, hadithi nr. 4607; Tirmidhiu, Sunen: 42-Kitabu-l-ilmi, 16-Babu ma xhae fil ahdhi bi suneti vexhtinabi vida, hadithi nr. 2676 dhe hadithi është

Ahmed ibn Hambeli ka thënë: Ajo çka vjen prej katër halifëve të parë është sunnet!²³⁴

Pasimi i sunetit të katër halifëve të drejtë është këshillë e Pejgamberit s.a.v.s., dhe në atë ithtarët e medhhebit hanefij i bazojnë qëndrimet e tyre në lidhje me numrin e rekateve të namazit të teravive.

Pas sahabëve, numrin prej njëzet rekateve e kanë pranuar edhe një numër i madh i tabiinëve. Kështu që të katër imamët e mëdhenjë kur janë në pyetje numri i rekateve të këtij namazi, thonë se janë njëzet, me atë që Imam Maliku ka edhe mendim tjetër-tridhjetë e gjashtë rekate.

Imam Tirmidhiu në Sunen thekson: Dijetarët islam nuk janë të një mendimi kur është në pyetje numri i rekateve i namazit të taravisë. Disa thonë se së bashku me namazin e vitrit duhen të falen dyzet e një rekat. Ky është qëndrim i dijetarëve të Medines, ashtu sikurse e kanë praktikuar ata. Numëri më i madh i dijetarëve në përputhje me atë që është e transmetuar nga Aliu, Omeri dhe sahabëve të tjerë të Pejgamberit s.a.v.s., thonë se duhet të falen njëzet rekate. Ky është mendim edhe i Sufjan eth-Theurit, Ibni Mubarekut, dhe Shafiut. Shafiu thotë: Unë kështu i kam gjetur në qytetin tim Meke, që njerëzit falnin nga njëzet rekate. Ahmedi thotë: Në lidhje me këte janë transmetuar thënie të ndryshme. Ai për atë nuk ka dhënë asnjë gjykim. Is'haku thotë: Ne i japim përparësi atyre që thonë se duhen të falen dyzet e një rekat, duke u bazuar në atë që është transmetuar nga Ubejj ibn Ka'b.²³⁵

Ibn Rushd el-Kurtubi në veprën e tij të njohur "Bidajetu-l-muxhtehid" thotë: Imam Maliku në njërën prej dy qëndrimeve të tij, pastaj Ebu Hanifja, Shafiu, Ahmedi dhe Davudi janë të mendimit se duhen të falen njëzet rekate përveç namazit të vitrit!²³⁶

Ibni Kudame në veprën e njohur hambelite "El-Mugni" thotë: Njëzet rekate është qëndrim i Ahmed ibn Hambelit. Me atë pajtohen Sufjan eth-Theuri, Ebu Hanife dhe Shafiu.²³⁷

Nëse analizohet praktika e sahabëve, tabiinëve, imamëve të mëdhenjë, pastaj praktika e muslimanëve me qindra vjet faleshin në të tre haremet e shenjta: Mekke, Medine dhe Aksa, atëherë prej nga dyshimi në vërtetësinë e numrit të rekateve në medhhebin hanefij?

Nuk e kam qëllimin të preferoj medhhebin hanefij, por vetëm dua të tregoj se ata që falin njëzet rekate kanë argumente valide, dhe me shpirt të qetë mund të vazhdojnë me praktikimin e asaj.

Nga ana tjetër, nëse numri i rekateve i namazit të teravisë do të ishte aq i rëndësishëm, nuk do të kishte aq mendime të ndryshme, duke filluar nga tetë e deri më dyzet e një, që qartë tregon në fleksibilitetin kur është në pyetje namazi vullnetar, për të cilën Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë se falet dy nga dy rekate. Kështu ata që falin

hasen-sahih; Ibni Maxhe, Sunen: El-Mukadima, 6-Babu itiba sunetil hulefai rashidine vel mehdijine, hadithi nr.42; Ahmedi, Musned, 4/126-127. Senedi i këtij hadithi është autentik (shih Neveviu, Rijadus Salihin f.83).

²³⁴ Es-Sijamu ve ahkamuhu, fq. 68

²³⁵ Tirmizijina zbirka hadisa, 3/198-199

²³⁶ Bidajetu-l-Muxhtehid, 1/210

²³⁷ El-Mugni, 2/167

tetë rekate kanë bazë transmetimin autentik të Aishes r.a., mirëpo gjithashtu edhe ata të cilët falin njëzet rekate kanë bazë në thëniet e besueshme të mbi paksën e Omerit, Othmanit, Aliut r.a, dhe sahabëve të tjerë.

Eksperti ynë i njohur i jurispodencës të sheriatit dr. Shukrija Ramiç mendon se ky ndryshim mendimesh është rezultat i fleksibilitetit i cili ekziston kur është në pyetje namazi vullnetar. Namaz vullnetar mund të falim sa të dojmë por mos ta teprojmë.

Është e qartë se në bazë të analizave mbi numrin e ndryshëm të rekateve të teravive, që ai numër është rritur ndërsa nga ana tjetër leximi i Kur'anit gjatë qëndrimit në kijam është shkurtuar, siç thekson edhe Ibn Hibbani ku thotë se në fillim namazi i teravisë përbëhej prej njëmbëdhjetë rekateve, në të cilat lexohej gjatë në kijam, që ka qenë gjendje e rëndë për njerëzit, prandaj pastaj është shkurtuar leximi në kijam, mirëpo nga ana tjetër është rritur numri i rekateve!²³⁸

Më e rëndësishmja është se nëse dikush fal më pak apo më shumë rekate kur është në pyetje namazi vullnetar, nuk do t'i bëj dëm, andaj nuk duhet më që për këtë temë të polemizohet, dhe për të humbet kohë.²³⁹

Prandaj, në vend të brengosjes tepër të madhe për numrin e rekateve të namazit të teravisë, ju këshilloj që:

Namazin e teravive ta falim me xhemat, pa marrur parasysh se për sa rekate bëhet fjalë, ngase ka shpërblim të madh për të, sepse për dallim nga namazet e tjera nafie, ky namaz është më i vlesfshëm që ta falish me xhemat se sa vet.

3. Të përpiqemi të falemi në xhemat, ku gjatë muajit të ramazanit në namazin e teravisë bëhet leximi i tërë Kur'anit, dhe kështu gjatë qëndrimit në kijam ndëgjojmë lexim të hatmes.

4. Nëse nuk kemi mundësi që të falemi pas imamit që do të lexon në namazin e teravisë tërë Kur'anin, atëherë të falemi pas atij që në çdo rekat do të lexoj nga një sure të Kur'anit, apo tri ajete të shkurtëra ose një ajet të gjatë, dhe i cili lexon ngadalë dhe qartë.

5. Të kemi parasysh rukunë, sexhden dhe pjesët tjera të namazit, që t'i kryejmë me përlulësi dhe nderë, dhe që për shkak të shpejtësisë mos të na vjen në pikëpyetje namazi i jonë.

6. Në mënyrë të mirë dhe të bukur ta këshillojmë imamin tonë, nëse ndonjëherë lexon shumë shpejtë.

²³⁸ Shih: Fikhu-s-Suneh, 1/174.

²³⁹ Shih qëndrimin interesant të shejh Es-Sagirxhiut në veprën e tij Shuabu-l-Iman, 3/172

Tabela e përmbajtjeve

NË VEND	2
HYRJE	7
SHPALLJA E KUR'ANIT	9
BEDRI- SIMBOLI I FITORES NDAJ VETVETES DHE TË TJERËVE	11
FAKTET HISTORIKE TË LUFTËS	12
MËSIMET DHE POROSITË E BEDRIT	13
LIGJSHMËRITË QË DUHET	15
VLERA E LEJLETU-L-KADRIT	16
KUR'ANI PËR NATËN E KADRIT	16
PSE KJO NATË E KA MARRË KËTË EMËR?	17
PËRCAKTIMI I NATËS SË KADRIT	17
VLERA E KËSAJ NATE	19
SI TA SHFRYTËZOJMË MË SË MIRI KËTË NATË?	21
AGJËRIMI	21
KATEGORITË E AGJËRIMIT	22
DISA ASPEKTE TË AGJËRIMIT	23
1. ASPEKTI SHPIRTËROR:	23
2. ASPEKTI SHËNDETËSOR:	24
3. ASPEKTI SOCIAL:	25
LLOJET E AGJËRIMIT	26
A). AGJËRIMI I RAMAZANIT	27
B). AGJËRIMI VULLNETAR (NAFILE)	28
AGJËRIMI NË MUAJIN MUHARREM	28
AGJËRIMI I DITËS SË DHJETË TË MUHARREMIT/ JEV MU ASHURA	29
AGJËRIMI I DITËS SË ARAFATIT	30
AGJËRIMI I GJASHTË DITËVE TË SHEVVALIT	30
AGJËRIMI I DITËS SË HËNË DHE TË ENJTE	31
AGJËRIMI I DAVUDIT A.S.	32
AGJËRIMI NË MUAJIN SHABAN	32
KUSHTET E AGJËRIMIT	33
KUSH NUK ËSHTË I OBLIGUAR TË AGJËROJË	34
ÇKA E PRISHË AGJËRIMIN	35
ÇKA NUK E PRISHË AGJËRIMIN?	36
DYZET HADITHE PËR RAMAZANIN DHE AGJËRIMIN	37

SADAKATU-L-FITRI.....	42
SI DUHET TË JEPET SADEKATU-L-FITRI	43
KUSH JEP DHE PËR KË JEPET SADAKATUL FITRI?	43
KUJT I JEPET SADAKATUL FITRI?.....	44
SA KA VLERË SADAKATUL FITRI?.....	44
KUR JEPET SADAKATUL FITRI?.....	45
I'TIKAFI	46
LLOJET E I'TIKAFIT	46
RREGULLAT	47
ÇKA E PRISHË ITIKAFIN?	48
NAMAZI I TERAVIVE	49
SI FALET KY NAMAZ?	49
SA REKATE KA NAMAZI I TERAVISË?	50